# PROGRAMI I ZONËS FUNKSIONALE LEZHË

## Analiza ekonomike

dldp
decentralisation and local development programme

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

HELVETAS Swiss Intercooperation ALBANIA

Prill 2015

Ky dokument është përgatitur nga Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp), me mbështetjen financiare të Agjensisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Ky publikim reflekton mendimet e autorëve dhe jo detyrimisht të SDC

Zhvilluar nga:
Instituti për Studime Bashkëkohore (ISB)

Publikuar nga:
Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp)

**HELVETAS Swiss Intercooperation** | Albania
Addresa: Rruga "Ibrahim Rugova",
Pallati i PLUS, kati i 2-të / Nr. 3. Tiranë | Shqipëri
www.dldp.al | www.km.dldp.al

**Tabela e lëndës**

Hyrje ..... 8

1 Territori i Zonës Funksionale të Lezhës ..... 9

1.1 Pozita Gjeografike, Kufijtë, Përbërja e NJQV-ve ..... 9

1.2 Aksesi në Zonën Funksionale ..... 10

1.3 Klima dhe Mjedisi ..... 12

1.3.1 Klima ..... 12

1.3.2 Mjedisi ..... 13

1.4 Tendencat Demografike ..... 15

1.4.1 Popullsia, Tendenca e Lëvizjeve, Migrimi ..... 15

1.4.2 Struktura dhe lëvizja e Popullsisë ..... 16

1.5 Zhvillimi Social ..... 19

1.5.1 Arsimi ..... 19

1.5.2 Shëndetësia ..... 22

1.6 Karakteristikat dhe ndërveprimet në Zonën Funksionale ..... 22

1.6.1 Numri i personave që udhëtojnë për qëllime punësimi nga/drejt Zonës Funksionale: ..... 24

1.6.2 Punësimi/Struktura e papunësisë ..... 27

1.6.3 Tipologjia Ekonomike e Zonës Funksionale ..... 30

2. Analizë e Sektorëve të Ekonomisë ..... 31

2.1 Bujqësia, Blegtoria dhe Agro Industria ..... 31

2.1.1 Tregues të sektorit ..... 31

2.1.2 Avantazhe Konkurruese te Sektorit ..... 42

2.1.3 Problematika dhe Rekomandime ..... 42

2.2 Aktiviteti i Peshkimit ..... 45

2.2.1 Tregues Bazë ..... 45

2.2.2 Problematika dhe Rekomandime ..... 47

2.3 Industri të ndryshme përpunim dhe nxjerrëse ..... 48

2.3.1 Tregues Bazë ..... 48

2.3.2 Problematika dhe Rekomandime ..... 50

2.4 Sektori i Turizmit ..... 51

2.4.1 Tregues Bazë ..... 51

2.4.2 Avantazhe Konkurruese ..... 54

2.4.3 Problematika dhe Rekomandime ..... 55

3. Shërbimet vendore në zonën funksionale ..... 57

3.1 Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve ..... 57
3.1.1 Prodhimi i mbetjeve në Zonën Funksionale dhe kategoritë e tyre ..... 57
3.1.2 Riciklimi/Kompostimi I mbetjeve ..... 59
3.1.3 Vend-depozitimet dhe zona aktiviteti me potencial të lartë gjenerimi mbetjesh ..... 60
3.1.4 Përshkrimi i situatës aktuale të ofrimit të shërbimit ..... 62
3.1.5 Bashkëpunime ndërvendore për ofrimin e shërbimit dhe tipi I marrëveshjeve ..... 63
3.1.6 Si ofrohet shërbimi dhe rrjeti infrastrukturor i shërbimit disponueshëm në Zonë ..... 64
3.1.7 Kontratat e Shërbimit me Kompanitë Private ..... 66
3.1.8 Financimi i shërbimit dhe Sistemi i Tarifimit ..... 67
3.1.9 Problematikat kryesore të zonës lidhur me menaxhimin e integruar të mbetjeve ..... 69
3.2 Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimet ..... 69
3.3 Rrugët dhe transporti publik ..... 75
4. Struktura organizative ..... 79
5. Projektet e propozuara ..... 81
5.1 Tregu bujqësor ..... 81
5.2 Turizmi digjital ..... 84
5.3 Ndërtimi i thertores ..... 86
5.4 Mbështetja për vreshtarinë dhe verën autoktone Kallmet ..... 89
5.5 Itinerari ciklistik përgjatë Drinit të Vjetër ..... 93
5.6 Planifikimi në turizëm ..... 95
5.7 Stacioni i transferimit të mbetjeve Lezhë ..... 98
5.8 Mbështetja e sektorit të artizanatit si mudnësi për punësim dhe ekstension të turizmit ..... 100
5.9 Mbështetje për kultivimin e Ullirit dhe promovim i markës autoktone ..... 102
5.10 Ndërtimi I terminalit të transportit ndërurban në hyrje të Lezhës ..... 105
5.11 Ristrukturimi i Bashkisë Lezhë ..... 107
5.12 Rritja e aksesit në Velë ..... 109
5.13 Ngritja e qendrës rinore ..... 112
5.14 Festivali i Verës ..... 114
Aneks 1: Të dhëna mbi arsimin ..... 117
Aneks 2: Të dhëna mbi infrastrukturën rrugore dhe ujësjellësit ..... 119
Aneks 3 Detyrimet e NJQV-ve lidhur me menaxhimin e mbetjeve ..... 121
Annex 4. Struktura organizative e bashkise Lezhe ..... 122

## Lista e Tabelave

Tabela 1 Ndryshimet e popullsisë në ZF të Lezhës ..... 15
Tabela 2 Diferenca mes popullsisë sipas INSTAT-it dhe RGJC-së në 2011 për Qarkun Lezhë ..... 16
Tabela 3 Migrimi i brendshëm ..... 17
Tabela 4 Popullsia banuese sipas gjinisë, grupmoshës dhe bashkisë/komunës ..... 18
Tabela 5 Numri i nxënësve sipas degëve (viti mësimor 2012-2013) ..... 20
Tabela 6 Nr. i mjekeve te përgjithshëm dhe specialiste ne Qendrat Shëndetësore të ZF ..... 22
Tabela 7 Flukset e personave qe lëvizin nga qendra e tyre e banimit për te punuar në njësi tjetër ..... 24
Tabela 8 Drejtimi I lëvizjes së banorëve për punësim në ZF Lezhë ..... 25
Tabela 9 Shpërndarja e ndërmarrjeve aktive sipas NjQV-ve ..... 26
Tabela 10 Të punësuar sipas sektorëve /aktiviteteve ekonomike në ZF Lezhë (%) ..... 29
Tabela 11 Struktura e Tokës në Zonën Funksionale Lezhë (në Ha), 2014 ..... 32
Tabela 12 Numri i Fermave, Viti 2014, Zona Funksionale Lezhe ..... 32
Tabela 13 Struktura e mbjelljeve te bimëve te arave (ne Ha), ZF Lezhë, 2014 ..... 33
Tabela 14 Prodhimi i kulturave të arave në tonë, ZF Lezhë (2014) ..... 34
Tabela 15 Pemëtaria, Sipërfaqet gjithsej dhe në prodhim (në Ha), ZF Lezhë, 2014 ..... 35
Tabela 16 Pemëtaria, Prodhimi në tonë, ZF Lezhë, 2014 ..... 35
Tabela 17 Struktura e blegtorisë 2013 ..... 36
Tabela 18 Prodhimet blegtorale në tonë, ZF Lezhë, 2014 ..... 37
Tabela 19 Krahasimi i prodhimit blegtoral me rajonin dhe vendin, ZF Lezhë, 2014 ..... 37
Tabela 20 Numri dhe madhësia e fermave blegtorale ..... 38
Tabela 21 Numri i mjeteve mekanike bujqësore ..... 39
Tabela 22 Nr. Punonjësve sipas Subjekteve AgroIndustriale në çdo njësi, ZF Lezhë, 2014 ..... 40
Tabela 23 Numri i Subjekteve AgroIndustriale sipas kategorive në çdo njësi, 2014 ..... 41
Tabela 24 Bilanci tregtar I produkteve të detit, 2013 ..... 46
Tabela 25 Leje Minerare Aktive në ZF Lezhë, 2014 ..... 48
Tabela 26 Monumentet e Kulturës ..... 52
Tabela 27 Prodhimi i mbetjeve për banor në një ditë, Zona Funksionale Lezhë ..... 58
Tabela 28 Struktura e mbetjeve ne %, 2012 ..... 59
Tabela 29 Distanca nga landfill Bushat ..... 61
Tabela 30 Mbulimi i popullsisë me shërbime të menaxhimit të mbetjeve ..... 62
Tabela 31 Frekuenca e ofrimit të ofrimit të menaxhimit të mbetjeve në Zonë ..... 62
Tabela 32 Kontraktorët e shërbimit të pastrimit ..... 66
Tabela 33 Kostot operacionale (Dhjetor 2014) ..... 72
Tabela 34 Tarifat e shërbimeve UK Lezhë ..... 73
Tabela 35Numri i konsumatorëve (Dhjetor 2014) ..... 73
Tabela 36 Të ardhurat dhe arkëtimet UK Lezhë (viti 2014 – në mijë lekë) ..... 73
Tabela 37 Treguesit e performancës 2014 ..... 73
Tabela 38 Të dhëna mbi rrjetin shpërndarës UK Lezhë (2014) ..... 74
Tabela 39 Rrjeti rrugor në ZF Lezhë ..... 76
Tabela 40 Rrjeti i Rrugëve Rurale ..... 76
Tabela 41 Statistika mbi arsimin në ZF (2014-2015) ..... 117
Tabela 42 Punonjës në sektorin e arsimit (2014-2015) ..... 117
Tabela 43 Numri i nxënësve sipas klasave dhe programeve të veçanta ..... 117
Tabela 44 Rrugët e Financuara nga FSHZH në ZF Lezhë (2005-2013) ..... 119
Tabela 45Investimet sipas burimeve të financimit në rrjetin rrugor (2012) *(në mijë lekë)* ..... 119
Tabela 46 Investimet sipas burimeve të financimit në rrjetin rrugor (2013) (në mijë lekë) ..... 120

## Tabela e figurave

Figura 1 Zona Funksionale Lezhë ..... 9
Figura 2 Harta fizike e Shqipërisë ..... 9
Figura3 Zonat e mbrojtura në ZF të Lezhës ..... 11
Figura 4 Harta e institucioneve arsimore në Zonën Funksionale Lezhë ..... 21
Figura 5 Harta të dendësisë së popullsisë në grida 1 km $^2$ dhe me kufijtë e NJQV-ve ekzistuese ..... 23
Figura 6 Punësimi sipas sektorëve ..... 27
Figura 7 Punësimi në Sektorin Publik ..... 26
Figura 8 Papunësia sipas grupeve të popullsisë ..... 28
Figura 9 Harta e ndërveprimit ekonomik (shpërndarja e bizneseve dhe lëvizjet për punësim) ..... 29
Figura 10 Koncepti për zonën industriale të Lezhës ..... 31
Figura 11 Përbërja e Flotës së Peshkimit në Shqipëri ..... 45
Figura 12 Harta e mbulimit te UK ..... 70
Figura 14 Lidhjet me rrjetin e ujësjellës kanalizimeve (qershor 2014) ..... 72
Figura 13 Impianti I trajtimit të ujërave të zeza ..... 71
Figura15 Harta e rrjetit rrugor në qarkun Lezhë ..... 75
Figura 16 Buxheti për periudhën 2013-2015 ..... 76
Figura 17 Investime në infrastrukturë rrugore ..... 77

## Shkurtimet

| | |
|---|---|
| NJQV | Njësi të Qeverisjes Vendore |
| DLDP | Decentralisation and Local Development Program |
| INSTAT | Instituti i Statistikave |
| MCV | Ministri i Çështjeve Vendore |
| RGJC | Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile |
| SH.A. | Shoqëri Aksionare |
| TVSH | Tatimi i Vlerës së Shtuar |
| UK | Ujësjellës Kanalizime |
| ZF | Zonë Funksionale |

# Hyrje

Ky dokument është hartuar në kuadrin e programit dldp 3 të zbatuar nga Helvetas me mbështetje të Qeverisë Zvicerane.

Synimi kryesor i këtij dokumenti është të kryejë një analizë të potencialit të zhvillimit të zonës funksionale, duke identifikuar tiparet e përgjithshme të zhvillimit të saj ekonomik dhe mundësive të krijimit të vlerës së shtuar në zhvillim nëpërmjet bashkëpunimit dhe bashkimit të burimeve midis njësive vendore ekzistuese.

Koncepti i zonës funksionale ishte në themel të reformës territoriale që u krye në Shqipëri gjatë vitit 2014 dhe që ka përcaktuar njësi të reja vendore më të mëdha dhe ka krijuar pritshmëri për një zhvillim më koherent dhe përdorim më eficient të burimeve të sektori publik, por edhe të shfrytëzimit të energjive të sektorit privat. Koncepti i zonës funksionale ndërtohet mbi strukturën ekonomike dhe sociale të territorit dhe identifikohet kryesisht nëpërmjet lëvizjeve për punësim, potencialit ekonomik dhe zinxhirit të vlerës, disponibilitetit të shërbimeve dhe rrjetit të infrastrukturës fizike.

Ky material është hartuar në periudhën tetor – shkurt 2014 dhe është bazuar në një seri konsultimesh me aktorët lokalë si edhe konsultimin e të dhënave nga burime ekzistuese. Të dhënat primare janë marrë nga njësitë e qeverisjes vendore që përbëjnë zonën funksionale të Lezhës si edhe qarku i Lezhës. Të dhënat mbi popullsinë janë marrë nga INSTAT, census 2011 dhe janë krahasuar me të dhënat administrative të popullsisë nga regjistri i Gjendjes Civile. Burimi i të dhënave të përdorura në tekst është cituar në çdo rast.

Ky dokument është një ekstrakt fillestar i burimeve për njohjen e zonës funksionale dhe identifikimin e potencialit të zhvillimit. Mbi bazën e kësaj analize fillestare dhe në konsultim të ngushtë me aktorët lokalë, përfshirë komunitetet vendore, komuniteti i biznesit, punonjës të administratave vendore ekzistuese dhe përfaqësues të organeve të qeverisjes vendore në nivel qarku, dokumenti përmban një propozim fillestar për drejtimet ku administrata e njësisë së re vendore të Lezhës mund të përqendrohet për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm të zonës duke i kushtuar vëmendje të veçantë edhe kohezionit të brendshëm ekonomik e social dhe zbutjes së pabarazive ndërvendore.

# 1 Territori i Zonës Funksionale të Lezhës

## *1.1 Pozita Gjeografike, Kufijtë, Përbërja e NJQV-ve*

Qarku Lezhë përbëhet nga pesë bashki dhe 16 komuna, me 9 qytete dhe 170 fshatra, me një popullsi prej 134,027 banorë[1]. Qarku i Lezhës ka një sipërfaqe prej 1,588.4 km2 dhe kufizohet me Qarkun Shkodër në veri, qarqet Kukës dhe Dibër në verilindje, lindje dhe juglindje, qarkun e Durrësit në jug dhe shtrihet përgjatë bregdetit të Adriatikut në perëndim me një vijë bregdetare prej 38 km. Territori i qarkut të Lezhës përbëhet nga një zonë malore në lindje (65%) dhe zona fushore në perëndim (35%). Shumica e popullsisë jeton në zonat rurale (rreth 60%), ndërsa 40% jetojnë në qendrat urbane.

**Figura 1 Zona Funksionale Lezhë**

*Burimi: MCV*




Zona Funksionale (ZF) e Lezhës ndodhet në Qarkun e Lezhës dhe është një nga tre zonat funksionale të këtij rajoni. Ajo shtrihet në pjesën veriperëndimore të Shqipërisë dhe ndodhet në gjerësinë gjeografike 41°47'14.32 dhe gjatësi gjeografike 19°38'42.94".

ZF e Lezhës ka një sipërfaqe prej 456.8 km$^2$ (ose 28.8përqind të territorit që zë qarku i Lezhës) dhe kufizohet nga 5 Zona Funksionale (ZF e Shkodrës, Vaut të Dejës, Pukës, Mirditës dhe Kurbinit) dhe deti Adriatik. Në krahasim me zonat e tjera të vendit, në nivel territori ZF e Lezhës zë një sipërfaqe të vogël, rreth 1.7 përqind e sipërfaqes totale të territorit të vendit. ZF e Lezhës përfshin në administrimin e vet 10 Njësi të Qeverisjes Vendore (NJQV)(1 Bashki dhe 9 komuna), nga 21 gjithsej që ka Rajoni i Lezhës (16 komuna dhe 5 bashki),duke e pozicionuar këtë zonë në vend të parë për numrin e NJQV-ve në krahasim me 2 zonat e tjera funksionale të Rajonit të Lezhës. ZF e Lezhës zë rreth 28.8 përqind të territorit që mbulon Qarku i Lezhës dhe ka49% të totalit të popullsisë të qarkut.

**Figura 2 Harta fizike e Shqipërisë**

ZF e Lezhës shtrihet në pjesën veriperëndimore të vendit, nga Ultësira e Shkodrës në veri e deri në Bregun e lumit Mat në jug, nga Malësia Pukë-Mirdite në verilindje e lindje e deri në detin Adriatik në Perëndim.

Lezha është një zonë me veçori të ndryshme relievi. **Territori i Lezhës** ndahet në pjesën kodrinore-malore dhe në atë të mirëfilltë fushore. Në

[1]Popullsia sipas INSTAT, census 2011.Të dhënat administrative sipas Regjistrit të Gjendjes Civile e regjistrojnë popullsinë në nivelin e 212,781 banorë në po të njëjtin vit.

pjesën kodrinore-malore përfshihen Kashnjeti, Kreshta, Mali i Velës, Malësia e Lezhës që në rajonizimin e relievit të Shqipërisë bëjnë pjesë në Krahinën Malore Qendrore. Në pjesën fushore ndodhet fusha e Zadrimës (32% e saj shtrihet në rrethin e Lezhës-zona ku ndodhen komunat Dajç dhe Blinisht).

## *1.2 Aksesi në Zonën Funksionale*

Zona funksionale e Lezhës ka një pozicion shumë të favorshëm. Ajo ndodhet në qendër të arterieve kryesore të transportit që lidhin veriun me jugun dhe lindjen me perëndimin. Ajo përshkohet nga të gjitha llojet e transportit: rrugor, hekurudhor dhe detar. Afërsia e ZF me portet kryesore detare e bën këtë një zonë mjaft tërheqëse dhe lehtësisht të arritshme jo vetëm në plan kombëtar, por edhe në plan rajonal për vendet fqinje, si: Italia, Mali i Zi, Kosova dhe Maqedonia dhe Greqia.




ZF e Lezhës ka rrugë të mira dhe rrjet hekurudhor që e lidh atë me Shkodrën, Tiranën, Durrësin dhe Prishtinën[2]. Gjithashtu në këtë zonë ndodhet njëri prej tre porteve më të mëdhenj të vendit, porti i Shëngjinit dhe aeroporti i Gjadrit[3].

Janë shkurtuar ndjeshëm distancat jo vetëm brenda qarkut dhe me qarqet kufitare, por dhe me Malin e Zi, Kosovën dhe Maqedoninë, përmes superstradës Shkodër-Hani i Hotit dhe autostradës Durrës-Kukës-Morinë. Ndërtimi i këtyre rrugëve jo vetëm që ka shkurtuar distancat dhe ulur kohën e udhëtimit, por ato kanë ndihmuar në rritjen e bashkëpunimit e shkëmbimeve tregtare, rritjen e numrit të turistëve, zhvillimin e ekonomisë, etj.

**Figura 3: Harta e rrjetit hekurudhor**

ZF e Lezhës përshkohet nga 130.45 km rrugë kombëtare (ose 44.5 përqind të rrjetit kombëtar që përshkon qarkun), 80 km rrugë rajonale dhe 282.5 rrugë komunale (ose 68 përqind të rrjetit komunal të qarkut). Infrastruktura rrugore (komunale dhe rajonale) si dhe shërbimet që lidhen me të janë në pronësi dhe administrim të pushtetit vendor. NJQV janë vendimmarrëse për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e tyre.

Zona Funksionale e Lezhës përshkohet nga segmenti hekurudhor Vorë-Shkodër, i cili është një nga pesë segmentet e hekurudhës shqiptare. Ky segment përbëhet nga dy linja: Linja hekurudhore

[2]Ajo ndodhet vetë m 55 km nga kryeqyteti i Shqipërisë . Largësia Lezhë-Shkodër është 35 km, Lezhë-Durrës është 70 km, Lezhë-Rinas është 40 km dhe largësia Prishtinë-Kukës-Lezhë është 220 km.
[3]Aktualisht jashtë funksionit (shënim i autorëve)

Laç-Lezhë 20 km e gjatë dhe Lezhë-Shkodër është 34 km e gjatë. Në këtë linjë ka dy stacione ndërmjetës midis Lezhës dhe Shkodrës, stacionet Baqel dhe Mjedë. Ky stacion ndodhet në luginën e Vaut të Dejës dhe vetëm disa kilometra larg hidrocentralit me të njëjtin emër[4].

Në ZF të Lezhës ndodhet dhe Porti i Shëngjinit. Ky port ndodhet 60 km në veri të portit të Durrësit dhe është porti i vetëm në këtë zonë. Porti po zhvillohet me qëllim rritjen e aftësisë akostuese, përpunuese dhe sigurinë e lundrimit. Volumi i përpunimit të mallrave në këtë port është pesëfishuar krahasuar vitet e para 90.Përmes tij realizohen shkëmbime të shumta, duke ndikuar kështu ndjeshëm në zhvillimin ekonomik. Në portin e Shëngjinit realizohen disa aktivitete si: peshkimi, transporti i pasagjerëve dhe ngarkim-shkarkimi i mallrave të ndryshme. Përfundimi i rrugës Durrës-Kukës-Morinë i ka dhënë një rëndësi strategjike këtij porti si nyjë e rëndësishme për daljen në det të Kosovës.

Ai përpunon 9 % te vëllimit te mallrave te përpunuara ne portet shqiptare dhe në të ushtrohen aktivitete si përpunimi i mallrash, import/eksport, transport udhëtarësh dhe peshkim. Shënkolli gjithashtu ka një strukturë ekonomike dinamike qoftë në agro-turizëm po ashtu edhe në industri ndërtimi.

**Porti i Shëngjinit**

- Kalata operative - 160 metra
- Thellesia varion nga 5 -7,5 metra
- Kapacitet ankorues anijesh deri ne 5.000 ton
- Sasia maksimale e mallrave, qe perpunohen arrin deri ne 350 mije ton, ndonese kapaciteti eshte për 500 mije ton.
- Ne vitin '99 eshte hartuar masterplani i zhvillimit te portit te Shëngjinit nga Instituti i studimeve te transortit ne Ministri dhe Banka Boterore

*Burimi: Studim Fizibiliteti mbi Zhvillimin e Zonës Industriale në Lezhë USAID, Co-Plan, Bashkia Lezhe, 2008*

Në zonë ndodhet edhe Aeroporti i Gjadrit, aktualisht një pistë ajrore ushtarake në fshatin Gjadër të Komunës Dajç, 10 Km nga qyteti I Lezhës[5] dhe 50 km nga Tirana. Ai është unik në vend sepse është ndërtuar pranë një mali në mënyrë që avionët ushtarak të cilët uleshin mbi të, të futeshin në tunelin e nëndheshëm. Në mars të vitit 1997, baza u sulmua gjatë revoltave kombëtare në atë kohë. Disa ndërtesa, duke përfshirë edhe kullën e kontrollit, u shkatërruan dhe ushtarët e braktisën bazën ajrore. Mungesa e fondeve për ta riparuar bënë që operacionet fluturuese të ndërpriteshin në vitin 2000. Baza përdoret tashmë për ruajtjen e avionëve luftarakë të tërhequr nga shërbimi. Asnjë nga forcat ajrore shqiptare nuk është e vendosur më aty. Kjo bazë ajore nuk është më aktive që prej vitit 2001.

Harta Aeroporti I Gjadrit, Lezhë, Shqipëri

[4] *http://ëëë.t669.net/hekurudha_shqiptare.html*
[5] Plani Strategjik pwr Zhvillimin Ekonomik, Bashkia Lezhw, 2006 (*Grupi i Bankës Botërore, Instituti i Shoqërisë së Hapur, LGI dhe FLAG)*

Nuk ka ndonje studim aktual apo projekt lidhur me potencialin zhvillimor që Aeroporti i Gjadrit mund te kete ne nivel lokal dhe kombëtar. Gjithsesi, rëndësia e tij për zhvillimin ekonomik të zonës përmendet në dokumente të ndryshme strategjike të Bashkisë dhe Qarkut.

Ne strategjinë e Qarkut të hartuar nga PNUD në Shqipëri, përmendet aeroporti i Gjadrit si një nder më të njohurit në Shqipëri dhe impakti qe do te kishte kthimi i tij në aeroport civil, në fluksin e turistëve në qarkun Lezhë. Në dokument përmendet edhe nevoja për ndërtimin e rrugës autostradë-aeroport, me gjatësi 1.5 km që kërkon një fond prej 375 mijë euro.
Megjithatë, operatori i Aeroportit Ndërkombëtar "Nënë Tereza", gëzon për periudhën 20- vjeçare 2005-2025[6] ekskluzivitet mbi fluturimet ndërkombëtare, e për rrjedhojë asnje aeroport tjeter nuk mund të lejohet per fluturime nderkombetare tregtare (kargo dhe pasagjere) gjatë kësaj kohe.

## *1.3 Klima dhe Mjedisi*

ZF e Lezhësshtrihet në një territor me natyrë të larmishme – me burime të pasura ujore, lumenjtë (Drin dhe Gjadër), pranë detit Adriatik, maleve e kodrave, me një florë dhe faunë mjaft të pasur – çka i shton interesit ekonomik edhe potencialin turistik për qytetarët shqiptarë dhe të huaj.

### 1.3.1 Klima

ZF e Lezhës karakterizohet nga një klimë e butë e tipit mesdhetar për shkak të pozitës gjeografike me dalje të gjerë në det dhe me reliev në përgjithësi të ulët. Rrethi i Lezhës karakterizohet nga vera e nxehtë dhe e thatë, dimër i butë dhe i lagësht në pjesën e ulët dhe qytet, ndërsa dimër të lagësht dhe të ftohtë në zonën malore. Temperatura mesatare vjetore për rrethin është 15 gradë, mesatarja e Janarit 7 gradë, ndërsa mesatarja e Korrikut plus 24-25 gradë. Në këtë zonë bien mesatarisht 1700 mm reshje në vit.

[6] Ligji Nr.9312, datë 11.11.2004 , Neni 2.3 (c) pwr Marrwveshjen e Koncesionit ndwrmjet Kwshillit tw Ministrave Tw Republikws sw Shqipwrisw dhe Shoqwrisw Koncesionare "Tirana Airport Partners ", Shpk, pwr ndwrtimin, vwnien nw punw, operimin dhe mirwmbajtjen e aeroportit ndwrkombwtar "Nwnw Tereza ", Tiranw dhe pwr dhwnien e disa stimujve kwsaj shoqwrie Koncesionare*: "Qeveria e Shqiperise garanton se gjate Afatit te Koncesionit nuk do te licensohet, autorizohet dhe as operohet asnje aeroport tjeter per fluturime nderkombetare tregtare (kargo dhe pasagjere), ne Republiken e Shqiperise, me perjashtim te uljeve emergjente."*

## 1.3.2 Mjedisi




Rrethi i Lezhës ka burime të shumta ujore. Në territorin e tij rrjedhin dy lumenj, lumi i Drinit dhe ai i Gjadrit. Drini i Lezhës fillon në afërsi të fshatit Mjedë të rrethit të Shkodrës, bashkohet me ujërat e lumit Gjadër, kalon përbri Lezhës dhe derdhet në detin Adriatik. Lumi i Gjadrit e përshkon rrethin e Lezhës në 10 km gjatësi. Ky lumë ka një gjatësi prej 40.5km dhe një pellg ujor rreth 120 km$^2$. Prurjet mesatare vjetore janë 8.8m$^3$/sek. Gjithashtu në territorin e ZF rrjedhin disa përrenj[7] dhe ndodhen disa rezervuarë artificial[8], të cilat risin shumë potenciale për zhvillimin e bujqësisë në këtë zonë.

**Figura3: Zonat e mbrojtura në ZF të Lezhës (MCV)**

Zona e mbrojtur Kune-Vain-Tale me sip. 4,393.2ha[9] shtrihet në grykëderdhjen e lumit Drin. Këtu ka shumë shpendë ujorë dhe gjenden dy laguna, ajo e Cekës me sip 235 ha dhe e Merxhanit 77 ha. Surpriza më e këndshme për turistin është ishulli ranor i Kunes me një sip prej 125 ha në të djathtë të deltës së Drinit. Ishulli i Kunes është i mbuluar me një bimësi të harlisur hidrofile. Aty rriten shkurre të gjelbra mesdhetare, liane, shelgje, frashër etj. Në këtë rajon njihen 227 lloje bimësh. Përsa i takon faunës nga shpendët përmendim rosat e egra, fazanët, qukapikët, karabullakët, çapkat, rosën e madhe krye kuqe etj. Në këtë sistem lagunor gjenden 92 lloje shpendësh, 22 reptilë nga 33 që ka Shqipëria dhe 6 lloje amfibësh nga 15 që ka Shqipëria dhe disa lloje gjitarësh. Lagunat e Lezhës janë mjaft atraktive dhe mund të shfrytëzohen për shëtitje në natyrë dhe për gjueti sportive.

Ekosistemet ligatinore bregdetare të Kunes-Vainit janë të shpallur me ligj, zona të mbrojtura natyrore. Në ZF të Lezhës[10] ndodhen gjithashtu shumë monumente të natyrës të mara në mbrojtje nga shteti (Rëra e Hedhur; Rrapi i Grykës; Rrepet e Kolshit; Shpella e Hutit; Shpella e Sukës së Vogël; Rivat e Drinit; Këneta e Kashtës; Rrapi i Pirajave (Blinisht); Lisi i Markatomajt; Pylli (dushk, frashër, shkozë), i Shën Eufemisë Kallmet (1 ha).

ZF e Lezhës trashëgon pasuri të rëndësishme natyrore. Por duhet të theksohet gjithashtu se administrimi i papërshtatshëm i mbetjeve, keqpërdorimi i tokës bujqësore, zhvillimi kaotik urban, erozioni i lartë i tokës, mbishfrytëzimi i ujërave nëntokësore, degradimi i zonave të mbrojtura natyrore e varfërimi i biodiversitetit, janë ndër problematikat kryesore mjedisore me të cilat përballet kjo zonë.

Erozioni është shndërruar në një problem potencial për rrethin e Lezhës. Ai shfaqet si në forma të ndryshme (erozion detar, lumor dhe sipërfaqësor). Ndryshimet klimatike kanë ndikuar veçanërisht në zonat bregdetare të Shëngjinit dhe Shënkollit ku deti po merr gjithnjë e më tepër terren në tokë. Erozioni detar është gjithashtu aktive përgjatë bregut detar të lagunave Kune dhe Vain si dhe në derdhjen e lumit Buna.

Përgjatë bregdetit të përfshirë në zonën e Lezhës, avancimi i detit llogaritet mesatarisht deri në 2,5 m në vit. Ndër shkaqet kryesore për përparimin e bregdetit në zonën e Lezhës është bllokimi i aluvioneve që vijnë nga lumi Drin. Humbjet mesatare të tokës janë në rreth 12 ton/ha/vit në zonën fushore (Lezhë)[11] Këto ndryshime

[7]Përroi i Lushisë dhe i Qershisë në komunën e Kallmetit; Përroi i Troshanit në komunën e Blinishtit; Përroi i Manatisë në komunën Kolsh
[8]Rezervuari i Troshanit, Komuna Blinisht, rezervuari i Fishtës; Kallmetit; I Patalej në Kolsh dhe i Kashnjetit në Ungrej
[9]Zone e mbrojtur e kategorisë se IV me VKM nr.432, date 28.04.2010.
[1010]http://ëëë.planifikimi.gov.al/sites/default/files/Ligji%20Nr.8906,%20Dt%2006.06.2002_Per_zonat_e_mbrojtura_.pdf
[11]Raporti i gjendjes në mjedis 2011, fq. 11

do të japin ndikimet e tyre në ekonomi, dhe do të ndikojnë në qëndrueshmërinë dhe mundësitë për zhvillim brenda zonës

Degradimi i tokës së punueshme për shkak të erozionit dhe përmbytjeve vazhdon të jetë një nga problemet më të mëdha në zonën e Zadrimës[12]. Rënia e vegjetacionit, mospërdorimi i tokës për qëllime bujqësore, metodat e papërshtatshme të ujitjes janë disa nga faktorët, të cilat e përshpejtojnë fenomenin e erozionit në zonë. Zona të veçanta përdoren për kullotje, në kundërshtim me çdo lloj kriteri, duke stimuluar mbipërdorimin e bimësisë dhe për pasojë rritjen e erozionit dhe dëmtimin e peizazhit.

Ndryshimet klimatike pritet të kenë ndikim të dukshëm dhe në të ardhmen në këtë zonë. Zona bregdetare ndërmjet derdhjeve të lumenjve Drin e Mat është identifikuar si një nga zonat më vulnerabël ndaj ndryshimeve klimatike në Shqipëri[13]. Ekosistemet e kësaj zone pritet të ndikohen mjaft nga këto ndryshime, me pasojë zhdukjen ose fragmentimin e tyre dhe pamundësinë për t'i zëvendësuar. Kjo do të sillte humbjen e shërbimeve që përftohen nga ekosistemet.

Ndryshimet klimatike do të përkeqësojnë ndjeshëm rreziqet ekzistuese të tilla si përmbytjet nga ciklonet dhe stuhitë detare. Rreziqet e tjera të lidhura me klimën, rritja e nivelit të detit, depërtimi i ujit të kripur në ujërat nëntokësore, thatësira, ndryshimi i pritshëm në regjimin e temperaturave, pritet të bëhen rreziqe më serioze për sigurimin e ushqimit, ujit, energjisë dhe shëndetit të njerëzve. Ndryshimet klimatike do të ndikojnë biodiversitetin në të gjitha nivelet: gjini, specie, habitate dhe ekosisteme.

ZF e Lezhës është një nga rajonet me potenciale të mëdha të energjisë së rinovueshme. Energjia e erërave mund të përdoret si burim energjie, pasi kjo favorizohet nga kushtet e relievit me kodra të buta, afër zonave me popullim të madh si kodrat e Dajçit, dhe ekzistenca e erërave lokale të bollshme, deri në 120 ditë në vit[14]. Gjithashtu meqenëse rajoni i Lezhës ka klimë mesdhetare dhe kemi rreth 226 ditë me diell në vit, energjia diellore (nëpërmjet paneleve diellore), është një potencial i mirë që mund të shfrytëzohet gjerësisht nga bizneset, operatorët turistikë dhe institucionet lokale.

Menaxhimi i mbetjeve (grumbullimi, transporti, trajtimi dhe asgjësimi) është një praktikë - që ushtrohet plotësisht sidomos në qendrën e propozuar të ZF Lezhë. Bashkia Lezhë (80 përqind) ndërsa komunat Shëngjin (85 përqind), Zejmen (70 përqind), Shënkoll (70 përqind), Balldren i Ri (70 përqind), Kolç (50 përqind) dhe Kallmet (50 përqind) kanë të organizuar grumbullimin dhe transportin e mbetjeve urbane. Bashkia Lezhë ka filluar të grumbullojë dhe depozitojë mbetje të ndara në dy rryma. Popullsia banuese në komunat Dajç, Ungrej dhe Blinisht nuk mbulohet nga ky shërbim, dhe aplikohet kryesisht kompostimi individual. Dldp ka financuar ndërtimin e dy impianteve për ndarjen e mbetjeve në qytetin e Lezhës dhe në Komunën e Dajçit, në Lezhë[15]. Në zonat rurale ku shërbimi i grumbullimit të mbetjeve nuk ofrohet, ato shkarkohen në kanale, lugina ose në anë të rrugës, ku së fundmi shkarkohen edhe në lumenj.

Asgjësimi i mbetjeve urbane bëhet kryesisht në vend depozitimin e Bushatit (Bashkia Lezhë dhe komunat Balldren e Shëngjin). Ndërkohë që në mjaft raste mbetjet e komunave Shënkoll, Zejmen dhe Milot depozitohen në vend depozitimin e Berzantit, komuna Zejmen. Megjithëse jashtë funksionit në ditët e sotme, këtu vazhdojnë të depozitohen mbetje. Ky vend depozitim është i ngritur në afërsi te deltës se lumit Mat, dhe filtrimi i ujërave të shiut dhe atyre nëntokësore përbëjnë problem serioz për ndotjen e këtij lumi. Një pjesë e mbetjeve urbane, përfshi ato inerte nga ndërtimet dhe prishjet, hidhen përgjatë lumit Drin ose në liqenin e Knallës.

[12]Plani rajonal i veprimit në mjedis, fq.16
[13]Plani i menaxhimit RNM Kune-Vain-Ishëm 2012, Fq.7
[14]Plani rajonal i veprimit në mjedis, fq.15
[15]Planifikimi i Menaxhimit Lokal të Mbetjeve, dldp 2012, fq. 66

## *1.4 Tendencat Demografike*

### 1.4.1 Popullsia, Tendenca e Lëvizjeve, Migrimi

Popullsia e qarkut të Lezhës përbën më pak se 6% të popullsisë së vendit dhe është e vendosur në 21 njësi të qeverisjes vendore të organizuara në tri rrethe: rrethi Kurbin (4 njësime qendër Laçin); rrethi Lezhë (10 njësi me qendër Lezhën) dhe rrethi Mirditë (7 njësi me qendër Rrëshenin). Në vitin 2011, popullsia e qarkut të Lezhës ishte 134 027 banorë, 49 përqind (65633 banorë) e të cilëve jetonin në rrethin e Lezhës, 16 përqind (22,103) në rrethin e Mirditës dhe rreth 35 përqind (46 291 banorë) në rrethin e Kurbinit (INSTAT, Census 2011).

Popullsia e ZF Lezhë është 65,633 banorë ose 49 përqind e popullsisë së qarkut të Lezhës dhe është shpërndarë në 10 njësi të qeverisjes vendore. ZF e Lezhës ka popullsinë më të madhe krahasuar me dy zonat e tjera funksionale të këtij rajoni. Popullsia e ZF të Lezhës është afërsisht 3 herë me e madhe së popullsia në ZF të Mirditës (22 103) dhe 1.4 herë me e madhe se popullsia në ZF të Kurbinit (46 291) (INSTAT, Census 2011).Numri i femrave është 9.2 përqind më i ulët se ai i meshkujve.

**Tabela 1:** Ndryshimet e popullsisë në ZF të Lezhës

| Njesite Vendore | DEMOGRAFIA | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Siperfaqe km² | Banesa | Popullsia 2001 | Popullsia 2011 | Ndryshimi popullsise 2011/2001 (%-je) | Meshkuj | Femra | Urbane | Rurale |
| | **456.9** | **22874** | **67714** | **65633** | **-3.1** | **32947** | **32686** | | |
| Lezhe | 5.5 | 5968 | 14420 | 15510 | 7.6 | 7659 | 7851 | 15510 | 24835 |
| Shengjin | 53.4 | 4080 | 6807 | 8091 | 18.9 | 4073 | 4018 | | |
| Balldre | 91.2 | 1778 | 7203 | 6142 | -14.7 | 3096 | 3046 | | |
| Dajc | 35.2 | 1300 | 5183 | 3834 | -26.0 | 1907 | 1927 | | |
| Blinisht | 38.1 | 1142 | 4238 | 3361 | -20.7 | 1638 | 1723 | | |
| Kallmet | 18.1 | 1487 | 5493 | 4118 | -25.0 | 1976 | 2142 | | |
| Kolc | 38.1 | 1282 | 4923 | 4228 | -14.1 | 2080 | 2148 | | |
| Zejmen | 42.2 | 1422 | 6713 | 5660 | -15.7 | 2794 | 2866 | | |
| Shenkoll | 32.4 | 3637 | 8894 | 13102 | 47.3 | 6890 | 6212 | | |
| Ungrej | 102.7 | 778 | 3840 | 1587 | -58.7 | 834 | 753 | | |
| **Kombetare** | **28748** | **1012400** | **3069275** | **2800138** | **-8.8** | **50.1** | **40.9** | | |

*Burimi: Statistikat Qarku Lezhë 2014*

Shumica e njësive kanë dendësi më të ulët se dendësia mesatare për ZF (133 banorë/km$^2$): katër nga 10 NJQV janë nën nivelin 100 banorë/km², ndërsa dendësia mesatare e popullsisë së komunave është 123 banorë/km$^2$. Pjesa urbane e ZF (qyteti i Lezhës) ka dendësinë më të lartë (3,102 banorë/ km$^2$). Njësia më e vogël është Ungrej me 1587 banorë.

Sipas të dhënave të Censusit 2011 popullsia rezidente e ZF të Lezhës është 65,633 banorë. Ndërkohë të dhënat zyrtare të Regjistrit të Gjendjes Civile të vitit 2013, flasin për numër popullsie të regjistruar rreth 62përqind më të lartë, me përqendrim të ngjashëm të njësive të qeverisjes vendore të raportuara nga Censusi 2011.

Bazuar në të dhënat e Censusit 2011, niveli i urbanizimit është tepër i lartë në bashkinë Lezhë. Dendësia në zonën e re funksionale do të jetë 133 banorë/km$^2$, duke ulur kështu diferencimin tejet të lartë të dendësisë (asaj minimale dhe maksimale) të popullsisë ndërmjet zonave rurale të kësaj njësie. Aktualisht vetëm katër njësi vendore (Zejmen, Shënkoll, Shëngjin dhe Lezhë) gjenden mbi mesataren e zonës funksionale. Numri i femrave është 9.2 përqind më i ulët se ai i meshkujve.

Në vitin 2011 popullsia rurale përfaqëson për herë të parë, më pak se gjysmën e popullsisë së përgjithshme në nivel kombëtar[16],ndërsa në ZF të Lezhës kemi një situatë të ndryshme. Nëse shikojmë shpërndarjen e popullsisë sipas vendbanimeve, vëmë re se vetëm 31 përqind e saj banon në zonën urbane dhe pjesa tjetër në zonën rurale (69 përqind). Megjithatë duhet theksuar që afërsisht 56 përqind e popullsisë jeton në tre njësi të kësaj zonë (bashkinë Lezhë dhe komunat Shëngjin dhe Shënkoll). Këto njësi kanë fituar banorë (Shënkoll 47.3 përqind, Shëngjin 18.9 përqind dhe Lezha 7.6 përqind), ndërsa të gjitha njësitë e tjera kanë humbur banorë. Tre njësitë kanë fituar 78.8 përqind të popullsisë që kanë humbur njësitë e tjera. Përqendrimi i madh i popullsisë në këto njësi lidhet me zhvillimin me ritme të shpejta të turizmit në këtë zona.

Diferenca midis të dhënave nga Census 2011 dhe të dhënave nga RGJC është shumë e madhe. Popullsia e regjistruar në regjistra është 43 përqind më e madhe se ajo që rezultoi nga Censusi. NJQV që e kanë ndryshimin më të madh janë komuna Ungrej (49 përqind), Dajc (44 përqind). Komuna me ndryshimin më të vogël është komuna Shënkoll (14 përqind).

**Tabela 2 Diferenca mes popullsisë sipas INSTAT-it dhe RGJC-së në 2011 për Qarkun Lezhë**

| Njësia | Census 2011 | Regjistri Civil 2011 | Ndryshimi i popullsisë | Ndryshimi në % |
|---|---|---|---|---|
| **Ungrej** | 1,578 | 3,103 | -1,515 | -49% |
| **Blinisht** | 3,361 | 5,512 | -2,151 | -39% |
| **Dajc** | 3,834 | 6,895 | -3,061 | -44% |
| **Kallmet** | 4,188 | 6,883 | -2,765 | -40% |
| **Kolsh** | 4,228 | 6,649 | -2,421 | -36% |
| **Zejmen** | 5,660 | 9,090 | -3,430 | -38% |
| **Balldren i Ri** | 6,142 | 10,392 | -4,250 | -41% |
| **Shëngjin** | 8,091 | 11,551 | -3,460 | -30% |
| **Shënkoll** | 11,102 | 15,302 | -2,200 | -14% |
| **Lezhë** | 15,510 | 27,415 | -11,905 | -43% |
| **ZF Totali** | 65,633 | 102,792 | -37,159 | -43% |

### 1.4.2 Struktura dhe lëvizja e Popullsisë

Procesi i emigrimit, ulja e lindshmërisë dhe e vdekshmërisë ka patur ndikimin e vet dhe në strukturën e popullsisë të ZF Lezhë. 21.4 përqind e popullsisë është nën moshën 15 vjeç, ndërsa grupi i popullsisë mbi 65 vjeç është 11.5 përqind e popullsisë totale. Koeficienti i varësisë–raporti i numrit të personave në grupmoshat 0-14 vjeç dhe 65 vjeç e lart përkundrejt numrit të personave në grupmoshën aktive 15-64 vjeç, shprehur në përqindje është 49. Në nivel kombëtar ky tregues është 47 nga 73 që ka qenë në vitin 1979. Kjo nënkupton një zvogëlim të konsiderueshëm të barrës së personave të varur brenda njësive ekonomike familjare dhe ekonomisë në përgjithësi[17].

Koeficienti i përgjithshëm i varësisë mund të ndahet në koeficientin e varësisë së të rinjve dhe koeficientin e varësisë së të moshuarve, të cilët përfaqësojnë respektivisht raportin e popullsisë së grupmoshave 0-14 vjeç dhe 65 vjeç e lart kundrejt popullsisë në moshën 15-64 vjeç. Për ZF të Lezhës këto tregues janë respektivisht 32 dhe 17. Kjo ndarje tregon qartë një popullsi në plakje sepse koeficienti i varësisë së të rinjve është ulur krahasuar me vitin 1979 (ka qenë 64 përqind në nivel kombëtari) dhe kompensohet nga gradualisht nga një koeficient në rritje i varësisë së të moshuarve i cili rritet nga 9 në rreth 17 përqind për të njëjtën periudhë[18]. Koeficientët e varësisë të ZF Lezhë janë të njëjta me koeficientët në nivel kombëtar.

[16] INSTAT, Tipologjia e komunave dhe bashkive, fq.48
[17] INSTAT, Popullsia dhe dinamika e saj në Shqipëri, fq.33
[18] Po aty, fq.33

### Tabela 3Migracioni I brendshëm (Census, INSTAT)

Tabela 2: Matrica e migracionit të brendshëm

| Qarku 2011 | Qarku 2001 | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Berat | Dibër | Durrës | Ebasan | Fier | Gjirokastër | Korçë | Kukës | Lezhë | Shkodër | Tiranë | Vlorë | Gjithsej |
| **Berat** | | 283 | 154 | 673 | 2.123 | 398 | 636 | 450 | 59 | 58 | 418 | 2.852 | **8.104** |
| **Dibër** | 569 | | 154 | 774 | 1.168 | 816 | 280 | 205 | 173 | 102 | 265 | 140 | **4.646** |
| **Durrës** | 3.098 | 10.064 | | 4.772 | 2.045 | 1.066 | 2.055 | 3.649 | 2.160 | 1.978 | 2.791 | 381 | **34.059** |
| **Ebasan** | 664 | 534 | 362 | | 1.418 | 194 | 2.320 | 717 | 345 | 1.384 | 1.141 | 278 | **9.357** |
| **Fier** | 3.023 | 588 | 339 | 2.084 | | 2.384 | 808 | 1.685 | 225 | 443 | 1.626 | 2.832 | **16.037** |
| **Gjirokastër** | 401 | 177 | 69 | 134 | 529 | | 220 | 92 | 65 | 85 | 780 | 287 | **2.839** |
| **Korçë** | 609 | 624 | 241 | 2.258 | 964 | 194 | | 430 | 190 | 427 | 589 | 463 | **6.989** |
| **Kukës** | 102 | 255 | 117 | 95 | 212 | 99 | 102 | | 181 | 409 | 326 | 73 | **1.971** |
| **Lezhë** | 1.152 | 1.936 | 868 | 2.230 | 315 | 161 | 392 | 356 | | 4.016 | 2.241 | 143 | **13.810** |
| **Shkodër** | 421 | 1.046 | 1.881 | 416 | 718 | 581 | 475 | 945 | 1.356 | | 869 | 462 | **9.170** |
| **Tiranë** | 9.811 | 21.279 | 6.048 | 10.120 | 13.968 | 7.527 | 10.985 | 13.965 | 5.230 | 8.159 | | 5.088 | **112.180** |
| **Vlorë** | 1.405 | 248 | 248 | 825 | 2.200 | 2.002 | 521 | 623 | 272 | 552 | 894 | | **9.790** |
| **Gjithsej** | **21.255** | **37.034** | **10.481** | **24.381** | **25.660** | **15.422** | **18.794** | **23.117** | **10.256** | **17.613** | **11.940** | **12.999** | **228.952** |

*Burimi: INSTAT*

Lezha është një rast interesant që shënon një normë lëvizjeje prej 18 përqindësh. Në këtë rast, si migracioni hyrës ashtu edhe ai dalës kontribuojnë në normën e lëvizjes. Në disa vende, ka flukse dalëse të rëndësishme, ndërsa zona të tjera të bregdetit mesdhetar dhe pranë qytetit të Lezhës tërheqin edhe migrantë nga rajone të tjera[19].

Në ZF të Lezhës mund të vëzhgohet fenomeni tjetër që migrimi nuk ndodh vetëm në qendër të ZF (bashkia Lezhë), por dhe në njësitë vendore të afërta suburbane (Shëngjini dhe Shënkolli). Migrimi në drejtim të Tiranës ka qenë vetëm 5%, ndërsa Lezha është qarku i preferuar në veri të vendit, duke tërhequr migrantët e brendshëm nga Shkodra (29 përqind), Dibra (14 përqind), Elbasani (16 përqind) dhe Tirana (16 përqind). Lezha është qarku i katërt në Shqipëri i destinacionit të migrimit. [20]

Shumica e migrantëve të brendshëm (75.5 përqind) kanë ardhur nga këto qarqe.[21] Lezha, tërheq gjithashtu një numër të konsiderueshëm shqiptarësh që kthehen nga Italia, por numri i atyre që kthehen nga Greqia mbetet më i madh se i të parëve, ashtu si edhe në qarqet e tjera të vendit. Më shumë se gjysma e migrantëve të brendshëm në qarkun e Lezhës e kanë ndryshuar rrethin të paktën një herë[22].

[19] INSTAT, Migracioni në Shqipëri, 2014 fq. 18
[20] INSTAT, Migracioni në Shqipëri, 2014 fq. 22
[21] Po aty, fq.25
[22] Po aty, fq.24

**Tabela 4 Popullsia banuese sipas gjinisë, grupmoshës dhe bashkisë/komunës**

| Bashkia/Komuna | Gjinia dhe grupmosha | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Gjithsej** | | | | **Meshkuj** | | | | **Femra** | | | |
| | **Gjithsej** | **0-14** | **15-65** | **+65** | **Gjithsej** | **0-14** | **15-65** | **+65** | **Gjithsej** | **0-14** | **15-65** | **+65** |
| Balldren I Ri | 6 142 | 1 355 | 4 087 | 700 | 3 096 | 713 | 2041 | 342 | 3046 | 642 | 2046 | 358 |
| Blinisht | 3 361 | 634 | 2 232 | 495 | 1 638 | 331 | 1 074 | 233 | 1 723 | 303 | 1 158 | 262 |
| Dajç | 3 834 | 704 | 2 567 | 563 | 1 907 | 378 | 1 263 | 266 | 1 927 | 326 | 1 304 | 297 |
| Kallmet | 4 118 | 819 | 2 683 | 616 | 1 976 | 436 | 1 247 | 293 | 2 142 | 383 | 1 436 | 323 |
| Kolç | 4 228 | 882 | 2 834 | 512 | 2 080 | 460 | 1 396 | 224 | 2 148 | 422 | 1 438 | 288 |
| Lezhë | 15 510 | 3 314 | 10 702 | 1 494 | 7 659 | 1 779 | 5 180 | 700 | 7 851 | 1 535 | 5 522 | 794 |
| Shëngjin | 8 091 | 1 786 | 5 358 | 947 | 4 073 | 961 | 2 671 | 441 | 4 018 | 825 | 2 687 | 506 |
| Shënkoll | 13 102 | 2 937 | 8 829 | 1 336 | 6 890 | 1 555 | 4 689 | 646 | 6 212 | 1 382 | 4 140 | 690 |
| Ungrej | 1 587 | 322 | 1 056 | 209 | 834 | 174 | 558 | 102 | 753 | 148 | 489 | 107 |
| Zejmen | 5 660 | 1 278 | 3 679 | 703 | 2 794 | 650 | 1807 | 337 | 2 866 | 628 | 1 872 | 366 |
| Total | 65 633 | 14 031 | 44 027 | 7 575 | 32947 | 7437 | 21926 | 3584 | 32686 | 6594 | 22101 | 3991 |

*Burimi: INSTAT, Censusi I Popullsisë dhe Banesave. Lezha 2011*

## *1.5 Zhvillimi Social*

Sipas LSMS në 2012, rajoni i Lezhës shënon një nivel varfërie prej 17.5%, thellësi varfërisë 4.3% dhe ashpërsie 1.7%, tregues relativisht të lartë krahasuar me vlerat kombëtare.

Fondet e Akorduara për vitin 2013 për Ndihme Ekonomike dhe Personat me aftësi të kufizuara në Zonën Funksionale Lezhë jepen në tabelën më poshtë.

| Njësia | Ndihme Ekonomike në 000/leke |
|---|---|
| Dajc | 605,1 |
| Kolsh | 8.955,0 |
| Lezhe | 24.575,1 |
| Zejmen | 7.673,7 |
| Shën Koll | 9.615,8 |
| Shën Gjin | 5.792,8 |
| Balldren | 3.207,6 |
| Kallmet | 2.386,1 |
| Ungrej | 30.760,8 |
| Dajc | 1.642,9 |
| Blinisht | 340,6 |
| **Total ZF** | **95.555,4** |
| **Total Rajoni** | **298.378** |
| **Total Vendi** | **4.095.214** |

| Njësia | Fondet për personat me aftësi te kufizuara (në 000/leke) |
|---|---|
| **Dajc** | 25,067 |
| **Kolsh** | 5,344 |
| **Lezhe** | 90,337 |
| **Zejmen** | 30,496 |
| **Shën Koll** | 59,343 |
| **Shën Gjin** | 38,137 |
| **Balldren** | 37,199 |
| **Kallmet** | 24,144 |
| **Ungrej** | 9,911 |
| **Dajc** | 21,758 |
| **Blinisht** | 14,754 |
| **Total ZF** | **356,490** |
| **Total Rajoni** | **9,507,166** |
| **Total Vendi** | **15,272,086** |

*Burimi: Baza e të dhënave ISB*

Persona me aftësi të kufizuara ne te gjithë qarkun përfaqësojnë rreth 5.3% të popullsisë së rajonit. Numri i individëve në vështirësi (me aftësi të kufizuara, sëmundje etj.) në Bashkinë Lezhë përbën rreth 3% të popullsisë së Bashkisë, ku 2% e zënë invalidët e punës dhe 1% personat të paaftë mendorë dhe fizikë.

Për t'i ardhur në ndihmë personave me aftësi të kufizuara (PAK), që prej vitit 1996 është ngritur *Qendra e Zhvillimit Ditor Lezhë*. Kjo qendër e përkujdesit shoqëror për PAK, vepron si institucion me fond të deleguar dhe në varësi nga Kryetari i Bashkisë. Qendra ka karakter social-edukativ dhe ofron shërbim për fëmijë dhe të rinj me AK nëpërmjet aktiviteteve të mëposhtme ortofoni, pavarësi praktike, shërbim ushqimor, fizioterapi, transport, aktivitet shtëpiak, pedagogji, kënd muzike, pikturë, shërbim lavanderie, aktivitete të ndryshme argëtuese etj. Gjatë vitit 2013 kjo qendër është frekuentuar nga 29 persona. Përsa i përket mjediseve publike, vetëm 7% e tyre ofrojnë standardet e duhura për personat me aftësi të kufizuara.

Në Bashki funksionon dhe Qendra e Moshës së Tretë e cila është hapur për herë të parë në vitin 2008. Gjatë vitit 2013 numri i të moshuarve që marrin pjesë në aktivitet e qendrës është 70 persona.

### 1.5.1 Arsimi

Arsimi në ZF të Lezhës ofrohet nga dy sektorë: sektori publik dhe ai privat, nga të cilat 86 përqind e institucioneve arsimore janë institucione publike.

Të dhënat e Drejtorisë Rajonale Arsimore Lezhë tregojnë se në vitin 2014 në ZF zhvillojnë veprimtarinë e vet 55 institucione arsimore të sistemit parashkollor (kopshte), 59 shkolla të sistemin 9 vjeçar, 13 shkolla të

arsimit të mesëm të përgjithshëm dhe 1 shkolle arsimit profesional. Numri i përgjithshëm i nxënësve është përkatësisht; 2345 nxënës në sistemin parashkollor, 9020 në sistemin 9 vjeçar, 2724 në arsimin e mesëm dhe 559 në atë të mesëm profesional.

Në vitin 2014–2015, numri i kopshteve në Lezhë është 8.4 për çdo 10 000 banorë. Ky indikator është shumë afër indikatorit kombëtar[23]. Numri i fëmijëve për çdo edukatore është mesatarisht 20 fëmijë. Numri i shkollave 9-vjeçare është 8.9 për 10 000 banorë. Numri i nxënësve për çdo mësues është mesatarisht prej 15.6 nxënës.

Numri i shkollave të mesme është 2.0 për 10 000 banorë. Numri i mësuesve për 10 000 banorë varion nga 12–40, me një mesatare prej 24. Numri i nxënësve për çdo mësues është 15.7 nxënës. Institucionet arsimore publike janë të shpërndara në të gjithë ZF. Të gjitha komunat kanë shkolla 9 vjeçare dhe të mesme.

Në qytetin e Lezhës ofrohet **edukim profesional** nga shkolla "Kolin Gjoka", e cila është hapur për here të parë në shtator 2003. Shkolla i formon nxënësit në pesë profile kryesore: (ekonomi-biznes, administrim zyre, TIK, anglisht-frëngjisht dhe drejtimi pedagogjik). 53.9 përqind e nxënësve janë femra, megjithatë nga tabela mund të konstatohen lehtë stereotipet gjinore në shkollat profesionale. Kështu në degën TIK vetëm 13.9 përqind e nxënësve janë femra, ndërkohë që në pedagogji 94.6 përqind janë femra.

**Tabela 5 Numri i nxënësve sipas degëve (viti mësimor 2012-2013)**

| Nr. | Dega | Nxënës gjithsej | Nxënëse femra |
|---|---|---|---|
| **1** | Ekonomi-Biznes | 204 | 106 |
| **2** | Administrim zyre | 89 | 33 |
| **3** | TIK | 86 | 12 |
| **4** | Anglisht-Frëngjisht | 119 | 95 |
| **5** | Pedagogji | 56 | 53 |
| | Numri i përgjithshëm | 554 | 299 |

*Burimi: http://kolingjoka.vet.al/statistika/2012*

**Nevojitet një evidentim I mëtejshëm i mungesës së arsimit profesional si në kapacitetet pritëse ashtu edhe në zhvillimin e kurrikulave të cilat duhet të adresojnë jo vetëm aspektet teorike po edhe ato praktike.**

Harta me poshtë paraqet një shpërndarje të institucioneve arsimore (kopshte, shkolla nëntëvjeçare, gjimnaze dhe shkollat profesionale) në Zonë. Ne qytetin e Lezhës ato janë treguar me rrathët bojë qielli. Ndërsa, për njësitë e tjera janë përdorur rrathët e kuq.

[23] Aneks-Treguesit Arsimore

**Figura 4 Harta e institucioneve arsimore në Zonën Funksionale Lezhë**




*Burimi: Ministria e Arsimit, Njësitë Vendore, 2014*

Sa i përket transportit të nxënësve, tabela më poshtë paraqet një listë të shkollave për te cilat kryhet transporti (ose duhet te kryhet).Nuk dihet nëse te gjitha shkollat në liste e ofrojnë transportin e nxënësve.

| Shkollat, nxënësit e te cilave do te transportohen me mjet ( me fondet publike) | Shkolla pritëse |
|---|---|
| **Ndrec Nikolli** | Kalivac |
| **Gjobardhaj** | Kalivac |
| **Kaluer** | Ungraj |
| **Sukaxhi** | Ungraj |
| **Berzana** | Pllanë |
| **Grykë-manati** | Manati |
| **Balldren** | Kodër Balldren |
| **Lagja e Re** | Mbyllet si shkolle |
| **Gocaj** | Kakariq |
| **Baqel** | Blinisht |
| **Koterr** | Dajç |
| **Piraj** | Blinisht |
| **Kodhel** | Blinisht |
| **Fishtë+Krajen** | Troshan |
| **Merqi** | Rraboshtë |
| **Vrosh** | Gjergj Kastrioti |

*Burimi: VKM Nr. 709, datë 05.10.2011 "Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e mësuesve dhe të nxënësve që punojnë e mësojnë jashtë vendbanimit".*

Me prioritet per zonen duhet te jete edhe pjesëmarrja e të rinjve në vendimmarrje. Kjo çështje qe nuk eshte akoma detyrim ligjor ose administrativ për titullarët e institucioneve qëndrore/vendore, ben që herë të merret mendimi i të rinjve dhe herë të nënvlerësohet krejtësisht. Aktualisht pushteti lokal po sensibilizohet në riaktivizimin e shërbimeve me bazë komunitare në përfitim të grupeve të ndryshme shoqërore, duke përdoruar asetet bashkiake për këto shërbime të cilat ju vijnë në ndihmë komuniteteve të tyre.

Jane te nevojshme nisma specifike per te adresuar fuqizimin e grupeve lokale të veprimit të të rinjve dhe ngitjen e strukturave të qëndrueshme për ofrimin e shërbimeve miqësore për ta si edhe per te nxitur pjesëmarrjen e tyre ne iniciativa komunitare me karakter edukativ e sensibilizues.

### 1.5.2 Shëndetësia

Shërbimi shëndetësor ofrohet nëpërmjet shërbimit shëndetësor parësor dhe atij spitalor.
Qarku Lezhe ka 3 spitale me 319 shtretër si dhe 92 qendra shëndetësore dhe një numër total mjekësh prej 155. Distanca nga qendra më e afërt shëndetësore/mjeku më I afërt në zonat urbane është 23 minuta, ndërsa në zonat rurale,19 minuta.

Ne Bashki kujdesi shëndetësor parësor ofrohet përmes një qendre shëndetësore dhe katër ambulanca. Shërbimi shëndetësor parësor ofron shërbim mjekësor të specializuar që mbulon i). shërbim mjeku të familjes, ii). shërbim pediatrik, iii). konsultor të nënës dhe fëmijës, iv). kardiologji, v). mikrokirurgji, vi). shërbim mini laboratorik (dy laboratorë) si dhe vii). shërbim urgjence mjekësore

Spitali rajonal, i ndodhur në Qytetin e Lezhës, ofron shërbime të kujdesit shëndetësor në patologji, obstetri-gjinekologji, kirurgji, infektiv, pediatri, reanimacion, radiologji dhe shërbime laboratorike. Numri i punonjësve është 35 mjekë specialistë, 104 infermierë, 17 staf mjekësor (laborantë, farmacistë) dhe 100 veta personel ndihmës dhe administratë. Aktualisht ky spital ka një kapacitet prej 162 shtretërish. Numri i shtretërve për 10,000 banorë është 55. Numri i pacientëve të shtruar gjatë vitit 2013 ishte 7,031 prej të cilëve 27% ishin prej rretheve të tjera të qarkut Lezhë.

**Tabela 6 Nr. i mjekeve te përgjithshëm dhe specialiste ne Qendrat Shëndetësore të ZF**

| Njësia | Total MPF | Total MS | Total Mjeke |
|---|---|---|---|
| Q.SH. Lezhe | 9 | 3 | 12 |
| Q.SH. Shëngjin | 4 | 1 | 5 |
| Q.SH. Zejmen | 4 | 0 | 4 |
| Q.SH. Shën Koll | 6 | 0 | 6 |
| Q.SH. Balldren | 5 | 0 | 5 |
| Q.SH. Kolsh | 3 | 0 | 3 |
| Q.SH. Dajc | 3 | 0 | 3 |
| Q.SH. Kallmet | 3 | 0 | 3 |
| Q.SH. Ungrej | 1 | 0 | 1 |
| Q.SH. Blinisht | 2 | 0 | 2 |
| **Total ZF** | **40** | **4** | **44** |
| **Total Rajoni** | **81** | **11** | **92** |

*Burimi: Baza e të dhënave ISB, DRSKSH Lezhë*

## *1.6 Karakteristikat dhe ndërveprimet në Zonën Funksionale*

Termi *"Zonë funksionale"* i referohet një hapësire të caktuar (pavarësisht nivelit, bashki, rajon e kështu me radhë), e cila nuk përcaktohet nga kufijtë e saj administrative apo historike. Ajo formohet më tepër nga ndërveprimet e ndryshme që ndodhin brenda kësaj hapësire si për shembull; bashkëveprimeve ndërmjet banorëve për punësim apo shkëmbime tregtare, entiteteve qeveritare dhe njësive ekonomike brenda territorit të saj. Koncepti "Zonë Funksionale" në kuadër të kësaj analize, përdoret për të përcaktuar një hapësirë ku ndërveprimet mes banorëve strukturave publike dhe private janë të dendura dhe të shpeshta.

Harta e Qarkut Lezhë e paraqitur më poshtë është një detajim i hartës se Kluster-ave Urbanë në Shqipëri publikuar në botimin e fundit të INSTAT; "Një Klasifikim i Ri Urban/Rural i Popullsisë Shqiptare", Maj 2014. Kjo tipologji përdorur edhe në vendet e BE-së, është një klasifikim i ri i territorit Urban/Rural i cili konsideron si njësi bazë të klasifikimit rrjetin e qelizave prej 1km$^2$ [24]. Sipërfaqja e Qarkut është e ndarë në qeliza/ kuadrate prej 1 km$^2$ dhe janë vënë në pah me blu kuadratet ku popullsia është e përqendruar (më shumë se 300 banorë/km2). Nëse shikohet vazhdimësia e pikave blu, domethënë e përqendrimit të popullsisë, në një total prej të paktën 5,000 banorë, kjo zonë quhet zonë urbane.

**Figura 5 Harta të dendësisë së popullsisë në grida 1 km $^2$ dhe me kufijtë e NJQV-ve ekzistuese**




*Burimi: INSTAT*

Lezha si rajon është përgjithësisht rural sepse popullsia rurale është mbi 50% e popullsisë totale ((37, 8% urban dhe 62.2% rural). Njësitë me pak të dendura në Zonën Funksionale të Lezhës janë Balldreni Ri, Blinisht, Dajç, Kallmet, Kolsh[25], Ungrej dhe Zejmen. Quhen me dendësi të ulët sepse më shumë se 50% e popullsisë tyre jeton në qelizat e rrjetit rural. Njësitë me dendësi mesatare janë Shenkolli, Lezha dhe Shëngjini sepse më pak se 50 % e popullsisë jeton në qelizat e rrjetit rural dhe më pak se 50% e popullsisë jeton në aglomerimet me dendësi më të lartë. Ky klasifikim tregon se në 5 nga 8 njësitë me dendësi të ulet (Balldren, Blinisht, Dajç, Kolsh, Ungrej), e gjithë popullsia jeton në zona rurale. Në Zejmen dhe Kallmet për shembull, përkatësisht 98,8% dhe 95,6 % jeton në zona rurale. Tre zonat më të urbanizuara të zonës funksionale janë Lezha ku 99,3 % e popullsisë jeton në zona urbane, Shënkolli (62,8) dhe Shëngjini (54,7)26.

Harta më sipër jep një pamje të qartë të përqendrimit të popullsisë në zonën funksionale të Lezhës. Këto tipare demografike të zonës, kombinuar me treguesit për "commuters" ose personat që udhëtojnë nga vendi i rezidencës për të punuar diku tjetër, tregojnë të dyja bashkë dendësinë e ndërveprimeve në zonë.

[24] qasje e përdorur edhe nga OECD më parë*(OECD, 2011 and Jonard et al. 2009)*

[25] Ne studimin e tipologjisë urban rural te instat Kolshi është ngaterruar me Shën kollin

[26] Shifrat marrë nga studimi INSTAT; "Një Klasifikim i Ri Urban/Rural i Popullsisë Shqiptare, Maj 2014

### 1.6.1 Numri i personave që udhëtojnë për qëllime punësimi nga/drejt Zonës Funksionale:

Nga të dhënat e Censusit 2011, Instat ka përpunuar të dhënat për personat që kanë një vend fiks pune larg shtëpisë së tyre[27]. Në dy tabelat më poshtë paraqiten lëvizjet për punë ndërmjet njësive vendore në Lezhë dhe drejt njësive të tjera në vend të cilat lejojnë të kuptohet më mirë dinamizmi i ndërveprimit, drejtimet e lëvizjes dhe qendrat kryesore të punësimit.

**Tabela 7 Flukset e personave qe lëvizin nga qendra e tyre e banimit për te punuar në njësi tjetër**

| Zona Funksionale | Bashkia/ Komuna | Daljet e përditshme në njësi[28] (a) | Hyrjet e përditshme njësi[29] (b) | Fluksi Ditor Neto (b)- (a) |
|---|---|---|---|---|
| Lezhë | BALLDREN I RI | 198 | 31 | -167 |
| | BLINISHT | 59 | 13 | -46 |
| | DAJÇ | 42 | 39 | -3 |
| | KALLMET | 122 | 3 | -119 |
| | KOLÇ | 278 | 9 | -269 |
| | LEZHË | 506 | 1523 | 1017 |
| | SHËNGJIN | 534 | 381 | -153 |
| | SHËNKOLL | 268 | 188 | -80 |
| | UNGREJ | 6 | 11 | 5 |
| | ZEJMEN | 189 | 77 | -112 |

*Burimi: INSTAT*

Nga tabelat vërehet se:

- **Bashkia Lezhë** është njësia me numrin më të madh neto të personave qe hyjnë për punë (1017), sidomos nga njësitë Kolsh, Shëngjin, Shënkoll dhe Zejmen[30] . Në të gjitha njësitë e tjera (përveç Ungrej), ka më tepër persona që dalin nga njësia e tyre për të punuar diku tjetër, brenda zonës funksionale apo jashtë saj (p.sh. në Tiranë, Krujë etj.)

- **Njësitë me nr. më të madh të personave qe dalin nga njësia** për punë ne një njësi tjetër vendore janë; Kolsh (-269), Balldren (-167), Shëngjin (-153), Kallmet (-119), Zejmen (-112)

[27] Albania Commuting from Home to Ëork, May 2014
[28] Personat qe dalin nga njësia për ne pune ne një njësi tjetër vendore
[29] Personat qe hyjnë nga njësitë e tjera për pune
[30] Shiko tabelën 5 më poshtë

**Tabela 8Drejtimi I lëvizjes së banorëve për punësim në ZF Lezhë**

| Njësia e Vendbanimit | Total | BRADASHESH | LAÇ | BALLDREN I RI | BLINISHT | DAJÇ | KALLMET | KOLÇ | LEZHË | SHËNGJIN | SHËNKOLL | UNGREJ | ZEJMEN | DERJAN | SHKODËR | TIRANË | ZALLHERR |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 0702 | 1802 | 1901 | 1902 | 1903 | 1904 | 1905 | 1906 | 1907 | 1908 | 1909 | 1910 | 2403 | 3212 | 3414 | 3418 |
| | | | | | | | | | | | | | | **52** | **14093** | **143715** | **1597** |
| **BALLDREN I RI** | **255** | | | **57** | | 5 | | | 74 | 1 9 | * | | | | * | * | |
| **BLINISHT** | **220** | | | | **161** | * | | | 28 | | 21 | | | | * | | * |
| **DAJÇ** | **129** | | | * | * | **87** | | | * | * | | | | | * | * | |
| **KALLMET** | **146** | | | 7 | * | | **24** | | 72 | 9 | 14 | * | * | | * | | 11 |
| **KOLÇ** | **296** | * | | * | | * | * | **18** | 214 | 19 | * | * | 18 | 4 | * | 4 | |
| **LEZHË** | **3566** | 16 | * | 12 | 9 | 22 | | | **3 6** | 2 2 | 47 | 5 | 32 | * | 13 | 42 | 16 |
| **SHËNGJIN** | **1095** | 9 | * | 5 | * | 6 | * | * | 438 | **561** | 21 | * | 5 | * | 7 | 13 | |
| **SHËNKOLL** | **475** | 17 | | * | * | | | * | 175 | 16 | **2 7** | * | 17 | * | * | 12 | |
| **UNGREJ** | **114** | | | | | | | | 6 | | | **1 8** | | | | | |
| **ZEJMEN** | **435** | * | 5 | | | | | * | 133 | 8 | 26 | | **246** | | * | 5 | |

**Shpërndarja gjeografike e bizneseve në zonë** është gjithashtu e lidhur ngushtë me aksesin në të mira/shërbime dhe punësimin e përqendrimin e lartë të popullsisë në qendrat urbane. Sipas të dhënave të Instat, numri i ndërmarrjeve aktive që ushtrojnë aktivitetin e tyre në zonën funksionale Lezhë është 1,696 biznese të shpërndara sipas NjQV-ve si më poshtë. Qyteti është gjithashtu qendër e shërbimeve bankare dhe financiare në zonë.

Rreth 80% e bizneseve janë të vendosura në tri NJQV-të e Lezhës, Shëngjinit dhe Shënkollit. Shihet nga tabela se sektori privat është më dinamik e i zhvilluar në degë si Tregti, Shërbime dhe Industri.

Numri më i lartë i bizneseve për 1,000 banorë vërehet në Lezhë (62) dhe Shëngjin (43) dhe më i ulëti në Ungrenj (6) dhe Kolsh (9).

**Tabela 9 Shpërndarja e ndërmarrjeve aktive sipas NjQV-ve**

| Komuna / Bashki | Bujqësia e Peshkimi | Industria | Ndërtimi | Tregtia | Shërbime | Gjithsej | Biznese për 1,000 banorë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Balldreni i Ri** | | 8 | | 42 | 27 | 81 | 13 |
| **Blinisht** | 4 | | | 19 | 11 | 37 | 11 |
| **Dajç** | | 6 | | 23 | 13 | 44 | 11 |
| **Kallmet** | | 9 | | 18 | 12 | 42 | 10 |
| **Kolsh** | | 4 | | 15 | 15 | 37 | 9 |
| **Lezhë** | 6 | 93 | 54 | 394 | 414 | 961 | 62 |
| **Shëngjin** | 35 | 19 | 9 | 97 | 116 | 276 | 34 |
| **Shënkoll** | 6 | 17 | 4 | 47 | 51 | 125 | 10 |
| **Ungrej** | | | | | 9 | 9 | 6 |
| **Zejmen** | | 18 | 4 | 32 | 30 | 84 | 15 |
| **ZF Lezhë** | **55** | **177** | **79** | **687** | **698** | **1,696** | **26** |

*Burimi: Instat (2012), Censusi 2011*

Shpërndarja e bizneseve në NJQV-të është e lidhur ngushtësisht jo vetëm me aksesin e banorëve të këtyre zonave në të mira dhe shërbime por edhe në punësim. Sipas të dhënave të Instatit, ndërveprimi i të punësuarve që udhëtojnë jashtë qendrës së banimit është relativisht i lartë drejt qendrës urbane ku ndodhet dhe numri më i madh i bizneseve.

### 1.6.2 Punësimi/Struktura e papunësisë

Në ZF të Lezhës deklarohen si të punësuar 4,152[31] persona ose % e popullsisë së aftë për punë. Në totalin ë të punësuarve peshën më të madhe e zë sektori privat me 65.7% ose 2,729 persona. Natyrisht që raporti midis punësimit në të dy sektorët ka ndryshime të mëdha në NJQV pjesë e ZF.

**Figura 6 Punësimi sipas sektorëve**




Burimi: Qarku Lezhë, statistikat

Punësimi në sektorin publik paraqitet me diferenca të mëdha midis NJQV. 57.6 përqind e tyre janë të deklaruar si të punësuar në qytetin e Lezhës dhe pjesa tjetër është e shpërndarë nëpër komuna. Kjo shpërndarje lidhet me faktin që në qytet janë të përqendruara pothuajse të gjitha institucionet në nivel qarku, por ndërkohë kemi dhe numrin më të madh të të punësuarve në sektorin e arsimit, shëndetësisë, etj. Siç mund të shihet nga grafiku në nivel komune përqindjen më të madhe të të punësuarve në këtë sektor e ka Komuna e Shëngjinit (13.9 përqind).

**Figura 7 Punësimi në Sektorin Publik**




70.5 përqind e të punësuarve në sektorin privat jobujqësor janë deklaruar në bashkinë Lezhë, 9.5 përqind në komunën Shëngjin dhe pjesa tjetër shpërndahet midis komunave të tjera.

Të dhënat e punësimit në të dy sektorët tregojnë qartë diferencat për mundësitë e punësimit midis zonës urbane dhe rurale.

ZF e Lezhës është një nga zonat me një shkallë papunësie shumë të lartë. Sipas censusit të vitit 2011 shkalla e papunësisë në nivel kombëtar ishte 29.3%, ndërsa shkalla e papunësisë në ZF të Lezhës sipas këtij censusi ka qenë 42.4%, pra rreth 13 përqind më e lartë sesa niveli kombëtar. Komunat me shkallën më të lartë të papunësisë kanë qenë Shënkoll (60.0 përqind), Kallmet (57.7 përqind), Kolç (52.0 përqind) dhe Balldren me (49.9 përqind)[32].

[31] Statistikat e Qarkut Lezhë

Shkalla e papunësisë midis femrave dhe të rinjve rezulton më e lartë sesa mesatarja në nivel kombëtar. Shkalla e papunësisë për femrat në nivel kombëtar është 31.4 përqind, ndërsa në ZF të Lezhës është mesatarisht 42.5 përqind, ose 11.1 përqind më e lartë. Shkalla më e lartë e papunësisë tek femrat është regjistruar në komunën Kallmet (66.6 përqind), Shënkoll (59.1 përqind), Kolç (51.4 përqind). Një shkallë papunësie më e ulët se shkalla e papunësisë në nivel kombëtar është regjistruar në komunat Ungrej ((27.3 përqind) dhe Dajc (30.1 përqind), ndërkohë që shkalla e papunësisë tek femrat është afër nivelit kombëtar në bashkinë Lezhë (33.7 përqind) dhe komunat Ungrej ((27.3 përqind), Dajc (30.1 përqind), Shëngjin (31.8 përqind), Zejmen (32.1 përqind). Pra zonat me një shkallë më të lartë zhvillimi dhe me potenciale të zhvillimit të turizmit kanë një shkallë papunësie më të ulët.

Shkalla e papunësisë midis të rinjve si në shumë rajone të tjera të vendit është e lartë dhe në ZF të Lezhës . Shkalla e papunësisë në nivel kombëtar ka qenë 52.9 përqind sipas të dhënave të censusit të vitit 2011. Për ZF të Lezhës ajo është 15.9 përqind më e lartë ose 68.8 përqind. Të gjitha njësitë e qeverisjes vendore në ZF të Lezhës e kanë shkallën e papunësisë më të lartë se shkalla e papunësisë në nivel kombëtar.

**Figura 8 Papunësia sipas grupeve të popullsisë**




*Burimi: INSTAT*

Aktualisht në ZF të Lezhës janë deklaruar si të papunë 3,840 persona[33] nga të cilët 81.5 përqind i takojnë bashkisë Lezhë, 12.9 përqind nga komuna Shëngjin dhe vetëm 5.6 përqind nga komunat e tjera.

Shkallët më të ulëta rajonale të punësimit në vitin 2011 konstatohen në pjesën veriore të Shqipërisë, veçanërisht në Kukës, Dibër, Lezhë dhe Shkodër. Sfida për këto tregje pune është krijimi i vendeve të punës. Mundësitë e punësimit janë të përqendruara kryesisht në zona më të mëdha urbane si Tirana, Elbasani dhe Durrësi[34]

Në ZF të Lezhës oferta e punës është kryesisht në industrinë ushqimore (përpunimi i peshkut), industria e këpucëve dhe turizmi. Aktualisht ka një ofertë prej 380 vende pune, të ofruara nga sipërmarrjet fason.

[32] INSTAT, http://instatgis.gov.al/#!/l/prefectures/population/prefpop1
[33] Statistikat e Qarkut Lezhë
[34] INSTAT, Dinamika e tregut të punës, fq.51

Natyrisht që ZF e Lezhës ofron dhe shumë mundësi në fushën e bujqësisë, por këtu ka më shumë ekonomi familjare dhe vetëpunësim.

**Ka një mos-shfrytëzim të ofertës së punësimit nga sektorët që përdorin sistemin "fason", e cila sipas komenteve te aktoreve te zonës vjen kryesisht për shkak të kushteve të munguara të punës dhe pagesave të ulëta të cilat fshihen për arsye fiskale. Nevojitet një vlerësimi i mëtejshëm i arsyeve**

Tabela më poshtë tregon qarte se numri më i madh i të punësuarve është në sektorët Bujqësi/Pyje/Peshkim, Shërbime dhe Ndërtim.

**Tabela 10: Të punësuar sipas sektorëve /aktiviteteve ekonomike në ZF Lezhë (%)**

| NjQV | Bujqësi, pyje dhe peshkim | Tregti shumicë & pakicë | Ndërtim | Industri | Shërbime | E papërcaktuar |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Balldreni i Ri** | 28.6 | 8.6 | 15.4 | 10.2 | 28.2 | 9.0 |
| **Blinisht** | 46.7 | 3.4 | 11.2 | 5.0 | 21.0 | 12.8 |
| **Dajç** | 43.6 | 7.1 | 11.0 | 6.7 | 26.0 | 5.5 |
| **Kallmet** | 10.1 | 8.2 | 20.4 | 13.7 | 29.1 | 18.5 |
| **Kolsh** | 19.7 | 11.2 | 14.2 | 14.4 | 37.4 | 3.2 |
| **Lezhë** | 2.3 | 18.0 | 7.9 | 13.8 | 56.5 | 1.5 |
| **Shëngjin** | 10.5 | 16.0 | 9.8 | 10.4 | 51.8 | 1.5 |
| **Shënkoll** | 10.1 | 10.7 | 19.0 | 10.8 | 42.2 | 7.1 |
| **Ungrej** | 80.4 | 0.3 | 0.3 | 1.0 | 13.6 | 4.2 |
| **Zejmen** | 15.9 | 11.2 | 12.2 | 17.6 | 37.7 | 5.5 |

Burimi: Instat

Figura më poshtë paraqet të dhëna mbi përqendrimin e popullsisë dhe bizneseve të cilat dëshmojnë qartë se zonat ekonomikisht më të gjalla janë qyteti i Lezhës, ku janë përqendruar numri më i madh i shërbimeve dhe komunat e Shëngjinit dhe Shënkollit të cilat janë më tërheqëse për shkak të potencialit të turizmit. Lëvizja e banorëve për efekt punësimi gjithashtu ka përqendrim sipas këtij kahu.

**Figura 9 Harta e ndërveprimit ekonomik (shpërndarja e bizneseve dhe lëvizjet për punësim)**




*Burimi: MCV*

### 1.6.3 Tipologjia Ekonomike e Zonës Funksionale

Sektorët ekonomikë me potencial më të lartë zhvillimi për Zonën Funksional të Lezhës janë;

1. ***Bujqësi/Blegtori, Pyje dhe Peshkim*** me një fokus të veçantë në zhvillimin e Agro Industrisë dhe Agrobiznesit
2. **Turizmi** Historik, Kulturor/Fetar, Rural dhe Natyror
3. ***Industri të ndryshme nxjerrjeje dhe përpunimi*** mineralesh jo metalike, materiale ndërtimi apo lëndë drusore

Pavarësisht se pothuaj të gjitha strategjitë e zhvillimit të njësive lokale theksojnë si sektorët më të rëndësishëm Turizmin dhe Bujqësinë apo kombinimin e tyre, në Lezhë vihen re edhe sektorë të tjerë në rritje dhe që janë  të rëndësishëm qoftë për nga numri i bizneseve dhe i të punësuarve në to. Të tillë janë; industritë te lehta si ajo e drurit,  e përpunimit të peshkut dhe produkteve bujqësore dhe blegtorale. Një industri tjetër që mund të përmendet është ajo e nxjerrjes dhe përpunimit të materialeve të ndërtimit e rezervave minerare jo metalike. Ky i fundit do të analizohet më tej pavarësisht se do duhen hulumtime më të thella për të vlerësuar saktësisht potencialin e saj edhe në raport me vendin.

Motori ekonomik i zonës funksionale si për nga zhvillimi i sektorit privat, i numrit të punësuarve, dhe i përqendrimit të infrastrukturave më të rëndësishme për biznesin është trekëndëshi Lezhë, Shëngjin, dhe Shënkolli. Në këto tre njësi janë të përqendruara edhe aktivitete kyçe ekonomike për zonën,  si ai i peshkimit dhe përpunimit të peshkut, i turizmit, i industrive të ndryshme etj.

Struktura ekonomike e zonës funksionale Lezhë ka ndryshuar që pas viteve 90 e sidomos në qytetin e Lezhës ku degët kryesore të ekonomisë ishin industri të ndryshme si ajo e drurit, letrës, materialeve të ndërtimit (tulla, tjegulla etj.) si dhe industria ushqimore (përpunimi i peshkut).  Megjithatë, që pas viteve 90 një nga industritë që vijoi të konsolidohej është ajo e përpunimit të peshkut. Sot ekonomia në qytet është e diversifikuar dhe  mbështetet në tregti, shërbime dhe industri si sektorë që punësojnë numrin më të madh të banorëve.

Aktualisht zona industriale e Lezhës është jashtë funksioni dhe në të nuk ushtrohet asnjë aktivitet biznesi. Bashkia është përpjekur herë pas here ta promovojë me qëllim tërheqjen e investimeve vendase dhe të huaj por deri tani nuk ka patur asnjë të tillë. Bashkia ka përgatitur gjithashtu një studim fizibiliteti të Zonës me mbështetjen e USAID dhe Co Plan. Në këtë studim, 54,3 Ha në Lezhë dhe 3,2 Ha në Shëngjin, listohen si zonat ekonomike të miratuara në nivel vendi të cilat, të gjitha bashkë do të tërheqin në total rreth 57 milion Euro investime.  Lezha është akoma një zonë në studim ndërsa Shëngjini është në zhvillim. Gjithsesi, është për tu theksuar pozicioni strategjik i të dyjave pranë aeroportit, porteve dhe korridoreve më të rëndësishme në vend dhe rajon.

Figura 10 Koncepti për zonën industriale të Lezhës

*Burimi: Studim Fizibiliteti mbi Zhvillimin e Zonës Industriale në Lezhë, USAID, Co-Plan, Bashkia Lezhe, 2008*

Ndërtimi i Parkut të Biznesit në pjesën veriore të qytetit të Lezhës mbetet një projekt- investim prioritar në zonë, i cili do nxiste përqendrimin e bizneseve vendore, rajonale dhe të huaja në një territor të konsoliduar e te pajisur me infrastrukturën e nevojshme. Në park planifikohen të përqendrohen kryesisht aktivitetet e biznesit të mesëm dhe të madh si: prodhime konfeksionesh, prodhime këpucësh, ndërtim, prodhime agro-ushqimore, përpunim alumini, përpunim druri, transport, tregti e shërbime të ndryshme. Parashikohet që pas vënies në funksion të krijohen rreth 3,000 vende pune.

Qyteti i Lezhës me gjithë sipërfaqen e vogël, ka një pozicioni strategjik që mundëson akses në të mirat dhe shërbime. Shëngjini si porti i tretë në vend për nga madhësia shërben si një nyje e rëndësishme operative dhe logjistike për këto industri. Në fshatin Gjadër të Komunës Dajç, 10 Km nga qyteti I Lezhës dhe 50 km nga Tirana ndodhet edhe Aeroporti i Gjadrit, aktualisht një pistë ajrore ushtarake.

Në të gjitha njësitë e tjera të zonës (Kallmet, Blinisht, Dajç, Zejmen, Kolsh, Ungrej dhe Shënkoll), bujqësia, blegtoria dhe industri te lehta si agropërpunimi apo druri mbeten sektorë tipikë e tradicionalë që sigurojnë edhe burimin kryesor të të ardhurave për banorët e zonës. Ungrej është më i specializuar në blegtori dhe pyje për shkak edhe të resurseve më të larta që disponon (35% e resurseve të zonës funksionale në pyje) dhe kullota (72% e resurseve të zonës).

Ndërveprimet të tjera ekonomike në rritje brenda zonës janë; Shënkoll-Zejmen-Balldren-Kolsh në Industri përpunimi materialesh inerte, mermer, ndërtim etj. dhe; Shën koll-Shëngjin-Ungrej-Zejmen-Balldren në industri përpunimi druri.

# 2. Analizë e Sektorëve të Ekonomisë

## *2.1 Bujqësia, Blegtoria dhe Agro Industria*

### 2.1.1 Tregues të sektorit

**Bujqësia**

Zona Funksionale e Lezhës ka një sipërfaqe prej 457 km2 ose 29% e sipërfaqes totale të rajonit Lezhë. Lezha si qytet ka sipërfaqen më të ulët në zonë ndërsa njësitë me shtrirje më të madhe janë Ungrej dhe Balldren, Shëngjin dhe Zejmen. Disa nga njësitë me sipërfaqen më të madhe kanë dhe shpërndarjen më të madhe të popullsisë në territor (apo një dendësi fare të ulët) siç është rasti i Ungrej me 15 banorë/km2 dhe i Balldrenit me 67 banore/km2.

Lezha ka 18,496 hektarë tokë bujqësore, 19,256 ha pyje, 5,110 Ha Kullota dhe 2,884 Ha toke inproduktive (jo e punueshme). **Toka bujqësore në zonë përfaqëson 53% të tokës bujqësore në të gjithë qarkun dhe 3% në nivel vendi**. Më poshtë tregohet struktura e detajuar e tokës për çdo njësi.

**Tabela 11 Struktura e Tokës në Zonën Funksionale Lezhë (në Ha), 2014**

| | Sipërfaqe e tokës bujqësore (ha)[35] | Pyje (ha) | Kullota (ha) | Inproduktive (ha) |
|---|---|---|---|---|
| Lezhe | - | - | | |
| Shëngjin | 1,398 | 1,390 | 10 | 327 |
| Balldren i ri | 2,917 | 2,600 | 1,000 | 608 |
| Dajc | 2,516 | - | - | 89 |
| Blinisht | 2,579 | 1,656 | - | 109 |
| Kallmet | 1,873 | 2,033 | 400 | - |
| Kolsh | 1,389 | 2,300 | - | 400 |
| Zejmen | 1,951 | 2,621 | - | 238 |
| Shën koll | 3,022 | - | - | 634 |
| Ungrej | 851 | 6,656 | 3,700 | 479 |
| **Rrethi Lezhe** | **18,496** | **19,256** | **5,110** | **2,884** |
| **Total Qarku** | **35,184** | **98,145** | **9,229** | **7,242** |
| **Total Vendi (2012)** | **696,000** | | | |

*Burimi: Drejtoria Rajonale e Bujqësisë, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtës se Konsumatorit dhe Baza e të dhënave statistikore ISB*

Deri tani sipërfaqja e tokës bujqësore në zonë është e copëzuar dhe një fermer (familje), disponon mesatarisht 0.75 ha tokë. Ky tregues është mbi mesataren e qarkut prej 0.6 ha për fermer (familje). Tre janë njësitë në zonën funksionale me më pak se 1 ha tokë për familje dhe gjashtë të tjerat kanë një madhësi toke ndërmjet 1-2 hektarë. Këta janë tregues shumë të ulët për të mundësuar prodhimin në masë, intensiv dhe të mekanizuar të një ferme. Siç tregohet në tabelën më poshtë, numri i fermave në zonë është sa **45 % e totalit në rajon** dhe **4 % e totalit të fermave në nivel vendi**.

**Tabela 12 Numri i Fermave, Viti 2014, Zona Funksionale Lezhe**

| Njësia | Nr. I Fermave |
|---|---|
| Lezhë | - |
| Zejmen | 1,850 |
| Shenkoll | 3,100 |
| Kolsh | 1,470 |
| Kallmet | 1,350 |
| Balldren | 1,620 |
| Shëngjin | 880 |
| Blinisht | 1,297 |

[35] Të dhëna nga Drejtoria Rajonale e Bujqësisë Lezhë, 2014

| | |
|---|---|
| Ungrej | 290 |
| Dajç | 1,360 |
| **Total ZF Lezhe** | **13,217** |
| **Total Qarku** | **29,216** |
| **Total Vendi (Viti 2012)** | **350,916** |

*Burimi; Drejtoria Rajonale e Bujqësisë Lezhë*

Pozicioni gjeografik i favorshëm në ultësirën perëndimore të vendit, dalja në detin Adriatik, kushtet klimatike të një zonë mesdhetare, rezervat e pasura ujore (lumenjtë, lagunat), tokat pjellore, dhe shtrirja e tyre përgjatë brigjeve të lumit Mat, pyjet dhe kullotat e pasura, janë disa nga faktorët që mundësojnë një prodhimtari të pasur bujqësore dhe blegtorale në zonë.

Bujqësia është një nga sektorët tipikë e tradicionalë pothuajse në të gjitha njësitë e zonës, por sidomos në njësi të tilla si Kallmeti, Blinishti, Dajçi, Zejmeni e Shënkolli. Ky mbetet një sektor që përbën një burim të qëndrueshëm të të ardhurave për banorët e zonës. Për më tepër, bujqësia mbetet një sektor prioritar edhe në nivel kombëtar. Ai ka njohur një rritje prej 18,4% ne vitet 2077-2011[36].

Zona e Lezhës dallohet për prodhimtarinë qoftë të bimëve të arave po ashtu edhe pemëtarisë. Struktura e mbjelljeve me bimë arash si p.sh. drithëra buke (grurë e misër), perime (të njoma, të thata, bostane), patate, fasule, kultura industriale (soje)dhe foragjere jepet në tabelën më poshtë. e cila tregon qarte se zona funksionale Lezhe ka sipërfaqet më të mëdha në rajon të mbjella me këto kultura.

**Tabela 13 Struktura e mbjelljeve te bimëve te arave (ne Ha), ZF Lezhë, 2014**

| | Drithëra buke | Perime gjithsej | Patate | Fasule | Kultura industriale | Bime Medicinale | Foragjere |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Zejmen** | 600 | 52 | 22 | 35 | | | 680 |
| **Shenkoll** | 800 | 72 | 34 | 60 | - | | 1,700 |
| **Kolsh** | 72 | 52 | 10 | 8 | | 1 | 400 |
| **Kallmet** | 600 | 58 | 20 | 35 | | | 750 |
| **Balldren** | 680 | 185 | 15 | 52 | | | 1,120 |
| **Shëngjin** | 235 | 76 | 9 | 32 | | 2 | 405 |
| **Blinisht** | 650 | 89 | 15 | 50 | | 1 | 800 |
| **Ungrej** | 100 | 22 | 6 | 8 | | | 130 |
| **Dajç** | 970 | 102 | 20 | 32 | 0 | | 1,120 |
| **ZF Lezhe** | **4,707** | **675** | **151** | **312** | **0** | **4** | **6,970** |
| **Qarku Lezhë** | **6,543** | **1,402** | **448** | **660** | **165** | **12** | **14,189** |
| **Shqipëria (viti 2012)** | **143,000** | **31,000** | **9,318** | **14,623** | **3,022** | | **208,880** |

*Burimi; Drejtoria Rajonale e Bujqësisë Lezhë*

Tabela e prodhimtarisë së kulturave bujqësore më poshtë tregon se **Zona Funksionale Lezhe ka prodhimtarinë më të lartë sa i përket drithërave të bukës në nivel rajoni (70%).** Edhe **prodhimi i perimeve dhe foragjereve është i rëndësishëm duke qenë se përfaqëson rreth gjysmën e prodhimtarisë rajonale** (përkatësisht 53% për perimet dhe 50% për foragjeret). **Në raport me nivelin kombëtar prodhimtaria varion nga 1% për fasulen dhe pataten, në 2% për perimet, 3% për drithërat dhe deri në 4% për foragjeret.**

[36] Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor në Shqipëri, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Maj 2013

**Tabela 14 Prodhimi i kulturave të arave në tonë, ZF Lezhë (2014)**

| | Drithëra buke | Perime | Patate | Fasule | Kultura industriale | Bime Medicinale | Foragjere |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Zejmen** | 2,973 | 1,655 | 308 | 42 | | | 17,620 |
| **Shenkoll** | 4,427 | 2,307 | 476 | 72 | | | 59,440 |
| **Kolsh** | 303 | 1,175 | 15 | 18 | | 1 | 12,250 |
| **Kallmet** | 2,680 | 1,132 | 300 | 60 | | | 24,860 |
| **Balldren** | 4,540 | 5,059 | 288 | 73 | | | 42,005 |
| **Shëngjin** | 1,185 | 1,752 | 162 | 50 | | 1 | 13,829 |
| **Blinisht** | 2,825 | 1,769 | 135 | 60 | | 1 | 25,300 |
| **Ungrej** | 495 | 325 | 72 | 9 | | | 2,900 |
| **Dajç** | 5,990 | 4,238 | 320 | 32 | 1 | | 50,892 |
| **ZF Lezhe** | **24,317** | **18,474** | **2,076** | **374** | **1** | **4** | **232,629** |
| **Qarku Lezhë** | **34,866** | **34,758** | **8,250** | **1,110** | **283** | **14** | **461,616** |
| **Shqipëria (viti 2012)** | **696,823** | **914,022** | **232,956** | **27,210** | **4,821** | **-** | **5,949,845** |

*Burimi; Drejtoria Rajonale e Bujqësisë Lezhë*

**Blinishti dhe Dajci** janë studiuar edhe në raport me zonën e Zadrimës. Përsa i përket prodhimtarisë bujqësore  në Blinisht, pjesën më të madhe (69%) e zënë foragjeret, por ka gjithashtu edhe misër, grurë e vreshta. Nga ana tjetër, Komuna Dajç, në shumicën e kategorive si grurë, patate, fasule, fruta, vreshta radhitet e para në nivel Zadrime. Kjo prodhimtari e lartë në bujqësi në këto dy njësi  i shërben zhvillimit të blegtorisë dhe anasjelltas.  **Në Zejmen,**  toka pjellore, klima e favorshme dhe eksperienca e fermerëve kanë sjellë shtimin e prodhimit të drithërave të bukës (grurë e misër), vreshtarisë dhe frutikulturës. Shtimi i prodhimeve bujqësore është shoqëruar me shtimin e pikave të grumbullim-përpunimit si dhe me sigurimin e tregut për shitjen e tyre. Prodhimet tipike të zonës janë; shalqi, patate, mjaltë, luledielli, drithëra buke. Prodhohet rreth 1472 ton grurë, 1000 t misër, 26,480 ton foragjere, 75 ton patate, 24 ton fasule, 58 ton fruta dhe 560 ton vresht. **Balldreni** njihet ne prodhimin e drithërave dhe lulediellit, ndërkohë që fusha e Torovicës është e njohur për prodhimin e perimeve.

## Pyje dhe Pemëtaria

Njësitë që kanë në territorin e tyre një numër të madh hektarësh pyje janë Ungrej (6656), Balldreni (2600), Zejmeni (2621), Kolshi (2300) dhe Kallmeti (2033). Këta janë zona edhe me kullota të pasura e livadhe. Si rrjedhojë ndër orientimet e tyre të zhvillimit janë pemëtaria, blegtoria dhe në disa prej tyre industria e përpunimit të drurit.

**Në Balldrenp.sh.** pyjet dhe kullotat, një pjesë e të cilave administrohen nga komuna tashmë, i jepen për përdorim familjeve (deri ne 1 ha ) për një periudhë nga 1-10 vjet me 15.000 lekë në vit tarifë shfrytëzimi.

Zona Funksionale Lezhë  është e pasur në pemë frutore, vreshta, ullinj dhe agrume. Ky  është një drejtim tjetër për zhvillimin ekonomik, sidomos në vitet e fundit. Sipërfaqja dhe nr. i rrënjëve të mbjella po rritet vit pas viti kjo e mbështetur edhe nga subvencionet shtetërore  për vreshtat dhe ullinjtë. Subvencionet arrijnë shifrën e 50.000 lek për kultivimin e vreshtarisë dhe 30.000 lek për kultivimin e ullirit.  Më poshtë jepen dy tabela që tregojnë sipërfaqet në hektarë të mbjella me pemë dhe prodhimtarinë në ton. **Të gjitha sipërfaqet e mbjella me agrume në rajon ndodhen në zonën funksionale të Lezhës (100%). Zona përfaqëson rreth 40% të sipërfaqeve të mbjella me pemë frutore dhe vreshta në rajon.**

**Tabela 15 Pemëtaria, Sipërfaqet gjithsej dhe në prodhim (në Ha), ZF Lezhë, 2014**

| | | Peme frutore | Ullinj | Agrume | Vreshti | Pjergulla ( në rrënjë) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Zejmen** | **Gjithsej** | 29 | 16 | 5 | 25 | 43,000 |
| | **Ne prodhim** | 19 | 3 | 3 | 25 | 36,000 |
| **Shenkoll** | **Gjithsej** | 53 | 56 | | 34 | 11,000 |
| | **Ne prodhim** | 31 | 40 | | 19 | 10,000 |
| **Kolsh** | **Gjithsej** | 4 | 6 | | | 25,000 |
| | **Ne prodhim** | | 2 | | | 20,000 |
| **Kallmet** | **Gjithsej** | 2 | 50 | | 40 | 6,000 |
| | **Ne prodhim** | 1 | 20 | | 35 | 6,000 |
| **Balldren** | **Gjithsej** | 2 | 7 | 1 | 4 | 20,735 |
| | **Ne prodhim** | 2 | 3 | | 4 | 18,500 |
| **Shëngjin** | **Gjithsej** | 4 | 4 | 3 | 1 | 20,000 |
| | **Ne prodhim** | 4 | 3 | 3 | 1 | 18,400 |
| **Blinisht** | **Gjithsej** | 8 | 30 | | 40 | 2,200 |
| | **Ne prodhim** | 6 | 6 | | 40 | 2,200 |
| **Ungrej** | **Gjithsej** | 11 | | | 2 | 4,200 |
| | **Ne prodhim** | 2 | | | 1 | 3,500 |
| **Dajç** | **Gjithsej** | 46 | 10 | | 14 | 26,000 |
| | **Ne prodhim** | 5 | 2 | | 14 | 23,500 |
| **Lezha** | **Gjithsej** | **159** | **179** | **9** | **159** | **158,135** |
| | **Ne prodhim** | **69** | **78** | **6** | **139** | **138,100** |
| **Qarku** | **Gjithsej** | **298** | **426** | **9** | **382** | **504,735** |
| | **Ne prodhim** | **165** | **275** | **6** | **343** | **472,700** |

*Burimi; Drejtoria Rajonale e Bujqësisë Lezhë*

Prodhimtaria e agrumeve të Zonës përbën 90% të prodhimtarisë së rajonit dhe 2 % të prodhimit kombëtar. Ullinjtë përbëjnë 55% të prodhimit në nivel qarku, Vreshti (39%) dhe pemët frutore e pjergullat një të tretën e prodhimit rajonal. Nr. i rrënjëve të pjergullave është sa 5% e shifrës kombëtare.

**Tabela 16Pemëtaria, Prodhimi në tonë, ZF Lezhë, 2014**

| Emërtimi | Peme frutore | Ullinj | Agrume | Vreshti | Pjergulla rrënjë |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | |
| **Zejmen** | 260 | 46 | 86 | 106 | 144 |
| **Shenkoll** | 428 | 130 | 115 | 97 | 70 |
| **Kolsh** | 105 | 30 | 14 | | 110 |
| **Kallmet** | 120 | 90 | 28 | 110 | 33 |
| **Balldren** | 130 | 14 | 28 | 28 | 93 |
| **Shëngjin** | 82 | 11 | 48 | 4 | 122 |
| **Blinisht** | 52 | 62 | 27 | 120 | 18 |
| **Ungrej** | 71 | | | 5 | 7 |
| **Dajç** | 226 | 1 | 1 | 84 | 94 |
| **Lezha** | **1,472** | **383** | **346** | **554** | **691** |
| **Qarku** | **4,827** | **699.05** | **383.25** | **1418** | **2176.5** |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Shqipëria (viti 2012)** | **210,000** | **125,112** | **18,880** | **123,078** | **15,193** |

*Burimi; Drejtoria Rajonale e Bujqësisë Lezhë*

**Shënkolli** dallohet në nivel zone funksionale për prodhimtari të lartë të pemëve frutore, ullinjve, agrumeve dhe vreshtit. Në njësi kultivohen kryesisht kulturat perimore, bostanore, fasule, patate, fruta dhe foragjere. Kultivimi i fasules varion në 70-90 ha. Fermerët po rrisin sipërfaqet e mbjella, sepse ky prodhim ka gjetur treg më të mirë si dhe është më me rendiment se kulturat perimore e bostani. Këto dy vitet e fundit, ka filluar shtimi i sipërfaqes me pemëtore (kryesisht Kivit) dhe kultivimi i agrumeve të tjera. Në komunë funksionon një qendër prodhimi fidanësh frutore me kapacitet 20-30 mijë fidanë në vit e cila furnizon tregun dhe fermerët e zonës në shtimin e sipër faqeve të mbjella me drufrutorë. Tabela me sipërfaqet e mbjella tregon se Shënkolli ka akoma potencial të pashfrytëzuar të tokës.

**Në Kallmet** janë shtuar sipërfaqet e mbjella me ullishta dhe vreshta kjo në sajë të subvencioneve të Drejtorisë së Bujqësisë, kryesisht gjatë viteve 2007-2013. Gjatë kësaj periudhe janë mbjellë 50.000 rrënjë ulliri, 2 Ha Vreshta dhe 4 Ha arra. Ndërsa 6 Ha vreshta të varietetit të Kallmetit janë përfituar nga fondet e donatorit IADSA. Ndërtimi i Kantinës së Verës së Kallmetit dhe Fabrikës së Vajit të Ullirit ka nxitur banorët që të shtojnë sipërfaqet e mbjella me ullishta edhe vreshta. Kallmeti përfaqëson përkatësisht 20% dhe 23% të prodhimtarisë së vreshtit dhe ullinjve në ZF në vitin 2014.

Në **komunën Blinisht** gjithashtu janë shtuar sipërfaqet me vreshta dhe është ngritur kantina e prodhimit Gjok Gjini. Blinishti dallon në nivel Zone Funksionale për prodhimin e vreshtit i cili arrin në 120 tonë në 2014.

**Zejmeni** renditet si një nga njësitë me prodhimtarinë më të lartë të pemëve frutore në zonë *(260 ton në vitin 2014, ose 18% e ZF)*. Komuna ka potencial shumë të mirë për zhvillimin e vreshtarisë (19% e prodhimtarisë së ZF në 2014). Furnizuesi kryesor me fidanë në komunë është firma Fidal sh.p.k e cila, plotëson rreth 80% të nevojave të tregut. 12 Fermerë kanë vreshta të konsoliduara në një sipërfaqe prej 22 ha.

## Blegtoria

Përsa i përket sektorit të blegtorisë, veçanërisht e zhvilluar është blegtoria familjare e cila është e specializuar në rritjen e bagëtive të imëta, gjedhit, derrave dhe shpendëve.

Kushtet natyrore të shumicës së njësive në zone, si Kallmeti, Ungrej, Blinisht, Dajc, Shënkoll, Balldren e Zejmen, zonat fushore, kodrinore, malore, dhe resurset e mëdha pyjore, favorizojnë ndjeshëm rritjen e bagëtive të ndryshme dhe prodhimin e produkteve me origjinë shtazore të një cilësie të lartë. Të gjitha këto bëjnë që blegtoria të jetë një nga drejtimet kryesore të zhvillimit të këtyre njësive. Produktet blegtorale të prodhuara në zonë janë; qumështi dhe nënproduktet e tij, mishi dhe vezët.

Struktura e blegtorisë dhe raportet me rajonin e vendin paraqiten në tabelën më poshtë. **Siç shihet zona funksionale dallohet në nivel rajoni sa i përket numrit të derrave (62% e totalit të qarkut dhe 26% e totalit kombëtar); të leshtave (51% e rajonit); gjedhëve (49%), shpendëve (45%) dhe bletëve (43%).**

**Tabela 17 Struktura e blegtorisë 2013**

| | Gjedhe | Te leshta | Te dhirta | Derra | Njëthundrakë | Shpendë | Blete (koshere) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Zejmen | 1,772 | 1,565 | 2,100 | 3,680 | 60 | 9,700 | 395 |
| Shenkoll | 3,250 | 3,200 | 1,060 | 6,400 | 50 | 15,000 | 720 |
| Kolsh | 780 | 480 | 1,574 | 2,040 | 25 | 6,995 | 405 |
| Kallmet | 1,050 | 1,230 | 1,920 | 1,500 | 35 | 9,250 | 400 |
| Balldren | 3,220 | 3,570 | 4,180 | 2,450 | 35 | 12,400 | 310 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Shëngjin | 1,250 | 2,700 | 1,214 | 1,400 | 19 | 6,962 | 668 |
| Blinisht | 1,673 | 1,019 | 1,560 | 1,851 | 46 | 15,079 | 441 |
| Ungrej | 604 | 2,480 | 4,100 | 970 | 78 | 4,000 | 620 |
| Dajç | 3,360 | 1,100 | 920 | 20,380 | 108 | 35,290 | 774 |
| Lezha | 16,959 | 17,344 | 18,628 | 40,671 | 456 | 114,676 | 4,733 |
| Qarku | 34,580 | 33,739 | 61,459 | 65,836 | 1,491 | 254,020 | 11,063 |
| Shqipëria(viti 2012) | 498,000 | 1,809,000 | 810,000 | 159,000 | 97,000 | 9,494,000 | 239,000 |
| **Raporti mbi qarkun** | **49%** | **51%** | **30%** | **62%** | **31%** | **45%** | **43%** |
| **Raporti mbi vendin** | **3%** | **1%** | **2%** | **26%** | **0%** | **1%** | **2%** |

*Burimi; Drejtoria Rajonale e Bujqësisë Lezhë*

Prodhimi blegtoral për çdo njësi të zonës funksionale ne vitin 2014 jepet ne tabelën më poshtë ku dallohet qartë se ZF përfaqëson më shumë se gjysmën e prodhimtarisë rajonale në qumësht, mish dhe lesh.

**Tabela 18 Prodhimet blegtorale në tonë, ZF Lezhë, 2014**

| | Zejmen | Shenkoll | Kolsh | Kallmet | Balldren | Shëngjin | Blinisht | Ungrej | Dajç | Lezha | Qarku | Shqipëria |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Qumësht** | 4,183 | 6,196 | 1,226 | 2,145 | 6,810 | 2,626 | 4,127 | 929 | 5,185 | **33,428** | **60,074** | **1,105,000** |
| Lope | 3,915 | 5,945 | 1,058 | 1,932 | 6,137 | 2,349 | 3,957 | 558 | 5,100 | 30,951 | 53,725 | 957,000 |
| Dele | 90 | 66 | 29 | 49 | 307 | 168 | 54 | 85 | 39 | 888 | 1,439 | 81,000 |
| Dhi | 178 | 186 | 139 | 164 | 366 | 109 | 115 | 286 | 47 | 1,589 | 4,909 | 67,000 |
| **Mish gjithsej** | 940 | 1,214 | 348 | 535 | 589 | 214 | 369 | 168 | 1,570 | **5,947** | **9,843** | 150,000 |
| Gjedhi | 378 | 453 | 162 | 280 | 286 | 77 | 165 | 28 | 275 | 2,103 | 2,959 | 69,000 |
| Dele | 36 | 63 | 22 | 29 | 43 | 28 | 28 | 30 | 28 | 307 | 445 | 48,000 |
| Dhi | 38 | 17 | 32 | 30 | 51 | 12 | 13 | 39 | 11 | 243 | 742 | |
| Derri | 470 | 650 | 119 | 182 | 180 | 75 | 123 | 57 | 1,166 | 3,022 | 4,535 | 17,000 |
| Shpendi | 18 | 31 | 13 | 14 | 30 | 22 | 39 | 15 | 89 | 272 | 384 | 16,000 |
| **Lesh gjithsej** | 2 | 5 | 1 | 2 | 13 | 6 | 2 | 5 | 3 | **38** | **70** | 3,000 |
| **Dele** | 2 | 5 | 1 | 2 | 9 | 6 | 2 | 5 | 3 | 33 | 59 | |
| **Dhi** | | | | | 4 | 1 | | | | 5 | 11 | |
| **Veze (000/kokrra)** | 902 | 1,190 | 581 | 762 | 989 | 598 | 637 | 240 | 2,899 | 8,798 | 21,292 | 887,000,000 |
| **Mjaltë** | 4 | 7 | 5 | 5 | 2 | 4 | 2 | 4 | 4 | 37 | 82 | 3,000,000 |

*Burimi; Drejtoria Rajonale e Bujqësisë Lezhë*

Në tabelën më poshtë jepet një pasqyrë e prodhimit blegtoral të zonës funksionale Lezhë në raport me prodhimtarinë rajonale dhe atë kombëtare. **Në nivel vendi zona dallohet për prodhimin e mishit të derrit (18% e prodhimit kombëtar). Ndërsa në nivel rajoni për një sërë prodhimesh si; Mish gjedhi (71% e prodhimit të qarkut), mish shpendi (71%), mish dele (69%), mish derri (67%), qumësht lope (58%), Lesh (54%).**

**Tabela 19 Krahasimi i prodhimit blegtoral me rajonin dhe vendin, ZF Lezhë, 2014**

| | Raporti mbi qarkun | Raporti mbi vendin |
|---|---|---|
| **Qumësht gjithsej** | 56% | 3% |
| **Lope** | 58% | 3% |
| **Dele** | 62% | 1% |

| | | |
|---|---|---|
| **Dhi** | 32% | 2% |
| **Mish gjithsej** | 60% | 4% |
| **Gjedhi** | 71% | 3% |
| **Dele** | 69% | 1% |
| **Dhi** | 33% | |
| **Derri** | 67% | 18% |
| **Shpendi** | 71% | 2% |
| **Lesh gjithsej** | 54% | 1% |
| **Dele** | 56% | |
| **Dhi** | 43% | |
| **Veze (000/kokrra)** | 41% | 0% |
| **Mjaltë** | 45% | 0% |

*Burimi; Drejtoria Rajonale e Bujqësisë Lezhë*

Zona Funksionale Lezhe ka ne territorin e saj numrin më të madh të fermave të ndryshme blegtorale në raport me rajonin. Disa tregues paraqiten në tabelën më poshtë.

**Tabela 20 Numri dhe madhësia e fermave blegtorale**

| Emërtimi | Zona Funksionale Lezhë | Qarku |
|---|---|---|
| Ferma që mbarështojnë gjedhë/qumësht mbi 10 krerë | 43 | 63 |
| Ferma që mbarështojnë gjedhë/mish me mbi 10 krerë | 14 | 14 |
| Ferma që mbarështojnë gjedhë/qumësht mish me mbi 10 krerë | 3 | 3 |
| Ferma që mbarështojnë të imta 100-200 krerë | 12 | 17 |
| Te dhirta 200-500 krerë | 2 | 4 |
| Ferma që mbarështojnë derra mbi 10 krerë | 17 | 28 |
| Ferma që rrisin derra për majmëri | 243 | 256 |
| Ferma që mbarështojnë shpendë për vezë deri 100 krerë | 5669 | 10266 |
| Ferma që mbarështojnë shpendë 100-500 krerë | 131 | 131 |
| Ferma që mbarështojnë shpendë mbi 1000 krerë | 1 | 1 |
| Ferma që mbarështojnë mish 500-1000 krerë | 32 | 32 |
| Ferma që mbarështojnë mish mbi 1000 krerë | 9 | 9 |
| Ferma që mbarështojnë gjel deti 100-500 krerë | 34 | 36 |
| Mbi 500 krerë | 7 | 7 |

*Burimi: Strategjia e turizmit dhe Agroturizmit ne Qarkun Lezhe, 2010-2013*

Së fundmi ka filluar gjithashtu edhe ngritja e kompleksveve të fermave blegtorale me një numër më të madh krerësh në krahasim me ato tradicionale, megjithatë ato mbeten të pakta në numër.

**Blinishti, Dajci dhe Shënkolli** kanë një traditë të mirë në mbarështimin e derrit dhe prodhimin e mishit të tij. Në rajon ka disa komplekse të grumbullimit dhe shitjes së mishit. Rendimentet e prodhimit blegtoral në Shënkoll janë me të larta në raport me mesataren e komunave të tjera të Zonës Funksionale. Në këtë njësi funksionojnë 3 stacione të inseminimit artificial të gjedhit, të cilat mbulojnë të gjithë zonën. Në këto stacione aplikohet me sukses përmirësimi racor me raca të pastra me drejtim prodhim qumështi, të dyfishtë dhe me raca mishatake. Në disa ferma aplikohet edhe kryqëzimi industrial për prodhim mishi. Në rajon ka gjithashtu disa komplekse të grumbullimit dhe shitjes së mishit si dhe linja të përpunimit të qumështit, të cilat ofrojnë kushtet të mira teknologjike dhe të higjienës.

**Ungrej** gjithashtu është i specializuar në blegtori për shkak edhe të resurseve më të larta që disponon në pyje (35% e resurseve të zonës funksionale) dhe kullota (72% e resurseve të zonës).

**Shenkolli, Balldreni, Dajci dhe Zejmeni** kanë prodhimtaritë më të larta të qumështit në zonë. Këto njësi, me përjashtim të Balldrenit, dallojnë edhe për prodhimtarinë e lartë edhe të mishit.

### Prodhimet tipike bujqësore dhe blegtorale

Zona Funksionale e Lezhës është e njohur edhe në nivel rajonal e kombëtar për disa produkte tipike bujqësorë e blegtorale që mbajnë markën e zonës ku prodhohen. Këtu mund të përmendim rrushin/verën Kallmet, rakinë e Lezhës dhe gjelin e detit të Zadrimës.

Zadrima, pjesë e së cilës janë Dajci e Blinishti, është e njohur si vend origjine **e rrushit Kallmet,** një varietet i certifikuar dhe i mbrojtur në tregun e BE-së dhe potencial shumë i fortë zhvillimi. Shumë prej kantinave të prodhimit të verës në Zadrimë janë përqendruar në prodhimin e verës Kallmet. Kjo zone, në rastin tonë Dajci, dallohet edhe për rritjen e **gjelit te detit**.

**Vera e Kallmetit** është produkt karakteristik i njësisë së Kallmetit. Prodhimi i saj realizohet në kushte bashkëkohore të teknologjike dhe në përputhje me standardet e kërkuara në kantinën e verës "Kallmeti Sh.p.k" Kjo kantinë vlerësohet si një nga mundësitë kryesore për zhvillimin ekonomik të mëtejshme duke bërë të mundur rritjen e prodhimit të verës dhe sigurimin e tregjeve jo vetëm rajonale, por edhe atyre ato kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjithashtu, prodhimi i verës Kallmet apo i varieteteve të tjera të saj realizohet edhe nga vetë banorët e zonës por me metoda tradicionale. **Kallmeti ka një traditë të njohur në kultivimin e ullirit (90 ton prodhim viti 2014), në prodhimin e Vajit të Ullirit dhe kultivimin e fasules**.

**Zona Funksionale dallon dhe për disa produkte tipike blegtorale si djathi i Zadrimës ,** një produkt i njohur tashmë në tregjet lokale dhe kombëtare**, djathi i dhisë në Kallmet** i cili ka patur një hov të rëndësishëm në vitet e fundit, dhe **mishin e derrit**. Për këtë të fundit, Lezha dallon edhe në nivel kombëtar. Prodhimi i mishit të derrit (28,9%) në Lezhe, bashkë me qarqet Shkodër (27,1%) dhe Fier (14%) përbëjnë 70% të prodhimit total kombëtar[37].

Perimet janë karakteristike për njësitë Balldren (shegë dhe shalqi) dhe Kallmet (fasule dhe perime). Në Ungrej prodhime tipike janë arra dhe gështenja.

**Bimët medicinale** te rritura ne gjendje te egër janë te shumta ne zonën e **Malit te Kakarriqit dhe malit te Shëngjini**t. Një pjese e madhe e banoreve te zonave te Balldrenit, Kakarriqit, Blinishtit e Dajcit nxjerrin te ardhurat e tyre nëpërmjet këtij aktiviteti.

## Mekanika Bujqësore

Mekanika bujqësore është pak e përdorur. Për të përmirësuar situatën kërkohet bashkëpunim më i madh ndërmjet fermerëve për krijimin e fermave më të mëdha dhe nga shteti për subvencionimin e karburanteve dhe inputeve të tjera të prodhimit bujqësor. Më poshtë paraqitet inventari i mjeteve në ZF;

**Tabela 21 Numri i mjeteve mekanike bujqësore**

| Emërtimi | Zona Funksionale Lezhë | Qarku |
|---|---|---|
| **Traktor me rrota** | 252 | 412 |

[37]Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor në Shqipëri, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Maj 2013

| | | |
|---|---|---|
| **Minitraktorë** | 108 | 242 |
| **Makina mbjellëse** | 74 | 150 |
| **Moto korrëse** | 99 | 147 |
| **Autokombajna** | 14 | 28 |
| **Traktorë me zinxhirë** | 4 | 7 |
| **Freza** | 108 | 191 |

*Burimi: Strategjia e turizmit dhe Agroturizmit ne Qarkun Lezhe, 2010-2013*

*Mjete Mekanike dhe agregate bujqësore, ZF Lezhë, 2014*

| Njësia | Numër mjetesh total |
|---|---|
| **ZF Lezhe** | **963** |
| Zejmen | 87 |
| Shenkoll | 218 |
| Kolsh | 4 |
| Kallmet | 52 |
| Balldren | 164 |
| Shëngjin | 35 |
| Blinisht | 182 |
| Ungrej | 29 |
| Dajç | 192 |

*Burimi: Drejtoria Rajonale e Bujqësisë, 2014*

| Emërtimi | ZF Lezhë | Qarku | Vendi |
|---|---|---|---|
| Traktor me rrota | - | 463 | 8,719 |
| Minitraktore | - | 267 | 4,808 |
| Makine mbjellëse | - | 274 | 3,292 |
| Moto korrëse | - | 183 | 2,151 |
| Autokombajna | - | 24 | - |
| Traktor me zinxhirë | - | 6 | - |
| Freza | - | 245 | - |
| **Shuma** | **963** | **1,462** | **18,970** |

*Burimi: Drejtoria Rajonale e Bujqësisë (2014), Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtës se Konsumatorit (2012)*

## Agroindustria

Agroindustria po njeh rritje në njësitë e Zonës Funksionale Lezhe dhe në nivel kombëtar gjithashtu *( 17,8% për periudhën 2007 - 2011[38])*. Megjithatë, nevojiten investime të mëtejshme për t'i shtuar vlerën sektorit.

Shifrat e Drejtorisë së Bujqësisë tregojnë se në vitin 2014 ka 73 subjekte agroindustriale që ushtrojnë aktivitet në zonë (58% e totalit te rajonit) të cilët punësojnë 657 persona (ose 85% e totalit te rajonit). Këto biznese përfshijnë më së shumti; prodhim peshku, fabrika vaji dhe vere, baxho, furra buke, piceri, byrektore, fast food dhe pastiçeri.

**Tabela 22 Nr. Punonjësve sipas Subjekteve AgroIndustriale në çdo njësi, ZF Lezhë, 2014**

| Subjekti/ Njësia | Balldre | Blinish | Daj | Kallme | Lezh | Shëngji | Shenkol | Shëngji | Zejme | Tota |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|

[38]Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor në Shqipëri, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Maj 2013

| | n | t | ç | t | e | n | l | n | n | l |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Baxho | 3 | 4 | 9 | | 9 | | | | | 25 |
| Byrektore | | | | | 20 | 4 | | | | 24 |
| Fabrike vere | | | | | 6 | | | | | 6 |
| Fabrike Birre | | | | | | 3 | | | | 3 |
| Fabrike Mielli | | | | | | | 3 | | | 3 |
| Fabrike vere dhe vaji | | 3 | | 3 | | | | | | 6 |
| Fast- Food | | | | | 9 | 6 | | | | 15 |
| Furre Buke | 3 | | | | 35 | 6 | 4 | 3 | 3 | 54 |
| Pastiçeri | | | | | 20 | | | | | 20 |
| Përpunim Fruta Perime | | | | | | | | | 60 | 60 |
| Përpunim Peshku | | | | | 270 | 156 | | | | 426 |
| Piceri | | | | | 9 | 6 | | | | 15 |
| Total | 6 | 7 | 9 | 3 | 378 | 181 | 7 | 3 | 63 | 657 |

*Burimi: Drejtoria Rajonale e Bujqësisë (2014)*

**Tabela 23Numri i Subjekteve AgroIndustriale sipas kategorive në çdo njësi, 2014**

| Subjekti/ Njësia | Balldren | Blinisht | Dajç | Kallmet | Lezhe | Shëngjin | Shenkoll | Shëngjin | Zejmen | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Baxho | 1 | 1 | 3 | | 3 | | | | | 8 |
| Byrektore | | | | | 8 | 2 | | | | 10 |
| Fabrike vere | | | | | 2 | | | | | 2 |
| Fabrike Birre | | | | | | 1 | | | | 1 |
| Fabrike Mielli | | | | | | | 1 | | | 1 |
| Fabrike vere dhe vaji | | 1 | | 1 | | | | | | 2 |
| Fast- Food | | | | | 4 | 3 | | | | 7 |
| Furra Buke | 1 | | | | 13 | 2 | 2 | 1 | 1 | 20 |
| Pastiçeri | | | | | 10 | | | | | 10 |
| Përpunim Fruta Perime | | | | | | | | | 1 | 1 |
| Përpunim Peshku | | | | | 2 | 2 | | | | 4 |
| Piceri | | | | | 4 | 3 | | | | 7 |
| Total | 2 | 2 | 3 | 1 | 46 | 13 | 3 | 1 | 2 | 73 |

*Burimi: Drejtoria Rajonale e Bujqësisë (2014)*

Njësitë Dajç, Blinisht, Balldren, Kallmet dhe Ungrej dallohen për një përqendrim të lartë të objekteve të përpunimit të qumështit për traditën e vreshtave; për prodhimin e verës tipike të zonës (disa kantina të ngritura në zonë).

### 2.1.2 Avantazhe Konkurruese te Sektorit

Zona funksionale Lezhë  përfaqëson sipërfaqen më të lartë të mbjellë me drithëra në nivel qarku (72%) dhe afërsisht gjysmën e sipërfaqeve të sipërfaqet e mbjella me foragjere, perime dhe fasule në rajon (respektivisht 49%, 48% dhe 47%).

Zona Funksionale Lezhe dallohet në nivel rajoni edhe për prodhimtarinë më të lartë sa i përket drithërave të bukës (70%), prodhimin e perimeve(53% ) dhe foragjereve (50%). Zona përfaqëson edhe  3% të prodhimit kombëtar të drithërave dhe 4% për foragjeret. Këto të fundit janë të rëndësishme edhe për zhvillimin e mëtejshëm të blegtorisë.

100% e sipërfaqeve të mbjella me agrume në rajon ndodhen në zonën funksionale të Lezhës.  Kjo zonë përfaqëson rreth 40% të sipërfaqeve të mbjella me pemë frutore dhe vreshta në rajon.

Ullinjtë përbëjnë 55% të prodhimit në nivel qarku, Vreshti (39%) dhe pemët frutore e pjergullat një të tretën e prodhimit rajonal.

Zona funksionale dallohet në nivel rajoni edhe në fushën e blegtorisë. Numri i derrave  është sa 62% e totalit të qarkut dhe 26% e nivelit kombëtar); të leshtat (51% e rajonit); gjedhët (49%), shpendët (45%) dhe bletët (43%).

ZF përfaqëson  më shumë se gjysmën e prodhimtarisë rajonale në qumësht, mish dhe lesh. Prodhimi i mishit të derrit në ZF është sa 18% e prodhimit kombëtar.

Një nga  cilësitë e zonës që mund ta dallojë në rang rajonal edhe atë kombëtar, është potenciali që ka **për zhvillimin e markave zonale/rajonale për produkte tipike** si p.sh.;  rrushi dhe vera Kallmet, ullinjtë dhe gjeli i detit (Dajc e Kallmet), djathi (Kallmet, Dajc, Blinisht), mishi i derrit (Dajc, Blinisht, Shën Koll), bimët medicinale (Balldren -Malit i Kakarriqit dhe Shëngjinit), perimet si shegë dhe shalqi (në Balldren), fasule dhe perime (në Kallmet), arra dhe gështenja (Ungrej).

Një aspekt tjetër, i cili me më tepër investim mund të kthehet në një avantazh për zonën, është **industria e lehtë agropërpunuese** e cila po merr gjithnjë e më shumë rëndësi dhe po orientohet drejt përpunimit të frutave,  perimeve, ullinjve  dhe prodhimeve blegtorale.

Si përfundim, Zona Funksionale Lezhë ka; potenciale të lartë natyror sa i përket tokave dhe prodhimtarisë bujqësore e blegtorale;  ka prodhime karakteristike bujqësore e blegtorale; ka mundësi për zhvillim të zinxhirit të vlerës në bujqësi e blegtori (p.sh. shtimin e pikave te grumbullimit, magazinimit, përpunimit dhe tregtimit brenda dhe jashtë vendit përmes suportit logjistik që i jep porti i Shëngjinit); ka pozicion gjeografik shumë të favorshëm, akses të lehtë në infrastrukturat kryesore qe e lidhin me vendin dhe rajonin (akse rrugore, aeroporti, porti i Shëngjinit).

### 2.1.3 Problematika dhe Rekomandime

Problematikat e sektorit bujqësor dhe blegtoral janë të shumta në zonë dhe një pjesë e mirë e tyre janë të ngjashme në të gjithë territorin e vendit;

**Fragmentarizimi i lartë i tokës bujqësore dhe madhësia shumë e vogël e fermave** (bujqësore/blegtorale) përbën një pengesë reale për  të prodhuar e shitur në vëllime të konsiderueshme në tregje rajonale e kombëtare.  Fragmentarizmi i lartë pengon gjithashtu edhe investimet teknologjike në sektor për shkak të kostove shumë të larta.  Aktualisht prodhimi bujqësor e blegtoral shkon për përmbushjen e nevojave të konsumit lokal.

Zonat me traditë në bujqësi e blegtori janë prekur në 10 vjeçarët e fundit nga një **shpopullim masiv sidomos në zonat rurale**. Mosha e fermerëve është fermerëve është relativisht e lartë dhe ka pak të rinj që duan të merren me bujqësi 50-60 vjeç.

**Mekanika bujqësore** plotëson pjesërisht nevojat e fermerëve në zbatimin e hallkave teknologjike për kultivimin e kulturave bujqësore. Një pjesë e këtyre mjeteve janë të amortizuara e jo të pajisura me agregatet e nevojshme, si për plugimin, nivelimin, shpërndarjen e plehrave, mbjelljen, deri tek procesi i korrjes e përpunimit të produkteve bujqësore e atyre foragjere për blegtorinë

**Rreziku i përmbytjeve të tokave bujqësore** në pothuaj të gjitha njësitë rrezikon herë pas here prodhimtarinë bujqësore duke prekur në mënyrë direkte familjet e zonave të cilat bujqësinë e blegtorinë e kanë burimin kryesor të të ardhurave (p.sh. rasti i Torovicës në Balldren ku toka bujqësore përmbytet ne masën mbi 60%).

**Probleme me sistemet e vaditjes dhe kullimit** sidomos në disa njësi si Shënkolli, Balldreni, Zejmeni**. Në Shën Koll** problematik mbetet rrjeti i dytë e i tretë kullues e në përgjithësi sistemi ujitës i parehabilituar. Në **Balldren** sistemet kulluese janë ne gjendje tejet te amortizuar dhe si rrjedhim toka bujqësore e cila shtrihet kryesisht ne fshatin Torovicë përmbytet herë pas here. **Në Zejmen** mungon totalisht sistemi i dërgimit të ujit nëpër parcela. Infrastruktura e vaditjes është tejet e amortizuar. Gjatë verës nuk arrihet të sigurohet ujë më shumë se disa ditë. Totali i tokave të vaditura në nuk i kalon 250Ha.

**Mungesa e shërbimeve, sidomos në mekanizim e ujitjes, dhe mos aplikimi teknologjive bashkëkohore** për shkak të mungesave në mjetet mekanike ulin ndjeshëm prodhimtarinë në sektor

**Standardet bazë higjieno-sanitare** përgjatë gjithë zinxhirit, nga sigurimi/prodhimi i lëndëve të para, përpunimi, dhe deri tek tregtimi drejt konsumatorit final, nuk janë ende në përputhje me standardet për sigurinë ushqimore (p.sh. pikat e prodhimit e përpunimit të produkteve blegtorale mish, qumësht). Nga ana tjetër **sistemet e standardeve të cilësisë** nuk janë mjaftueshmërisht të zhvilluara.

**Mangësi në teknikat për mbarështimin dhe përmirësimin e racave ekzistuese** nëpërmjet praktikave të inseminimit artificial të gjedhëve dhe strukturën e ushqimit të gjësë së gjallë.

**Infrastrukturë agro-industriale jo mjaftueshmërisht e zhvilluar**. Ka mungesa sa i përket tregjeve agro-bujqësore, qendrave të grumbullimit, ruajtjes dhe përpunimit të prodhimeve bujqësore, frutave dhe perimeve, thertoreve, fabrikave të përpunimit të qumështit e mishit. Gjithashtu marrëdhëniet kontraktuale ndërmjet fermerëve dhe përpunuesve janë të paformalizuara.

**Kosto e inputeve është zakonisht e lartë** dhe fermerët/përpunuesit kanë vështirësi në mbulimin e saj; *(energjia, lënda djegëse dhe ambalazhimi - kryesisht i importuar).*

**Rekomandime për Autoritete e Zonës Funksionale**

**Në nivel politikash lokale** autoritetet e zonës funksionale duhet të marrin masa për;

- Të luftuar informalitetin kontraktual/tregtar(midis fermerëve dhe përpunuesve) dhe atë fiskal ( p.sh. punishtet e vogla informale, të cilat nuk paguajnë TVSH dhe taksa të tjera)
- Të konceptuar në bashkëpunim me institucione financiare, publike, private dhe organizata të specializuara, hartimin e produkteve financiare mbështetëse (kredi, grante, subvencione) të përshtatura për nevojat e sektorit
- Të mbështetur nga pikëpamja institucionale dhe administrative mbrojtjen e prodhimeve tipike të zonës (markat rajonale/patenta/standardet e sigurisë e cilësisë)
- Te nxitur bizneset e vogla bujqësore, blegtorale, dhe industrinë përpunuese ushqimore nëpërmjet mundësimit të infrastrukturave territoriale mbështetëse dhe politikave fiskale lehtësuese (ndërtim tregjesh vendore, investim në burime njerëzore, promovim/ marketim i produkteve)

- Edukimin**,** Informimin, orientimin dhe trajnimin e fermerëve ne lidhje me; mundësitë e skemave të financimit dhe mekanizmave institucionalë për thithjen e fondeve nga burime të ndryshme (publike, private, të huaja); për përfitimet e organizimit të fermerëve dhe blegtorëve në shoqata dhe minikooperativa; për domosdoshmërinë e zbatimit të standardeve të sigurisë dhe cilësisë së ushqimit *(kjo masë mund të arrihet nga një koordinim përpjekjesh mes strukturash lokale dhe qendrore)*

**Në lidhje me infrastrukturë fizike mbështetëse për bujqësinë** nevojitet një koordinim mes Bordit të Kullimit dhe Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë ne hartimin e një plani veprimi për rehabilitimin e sistemit kullues dhe ujitës dhe eliminimin e përmbytjeve në të gjitha zonat e njësisë .

**Shtimi i hapësirave të mbjella me prodhime tipike dhe konkurruese për zonën si** p.sh. ulliri, perimet dhe vreshtat. Shembuj projektesh mund të jenë; *zgjerimi me 1000 ha ullishte ne Pacram-Hajmel-Bushat-Berdice_Kallmet-Dajc; mbështetje e produkteve te ullirit dhe shegës ne Balldren dhe Kallmet; zgjerimi i te mbjellave me zarzavate ne zonën Zejmen-Shenkoll*

**Te stimuloje prodhimin e foragjereve** dhe të përdorë në mënyrë eficiente sipërfaqet e kultivuara me foragjere si një lëndë e parë e rëndësishme edhe për zhvillimin blegtoral po aq prioritar për zonën.

**Të investojë në rritjen e nr. te krerëve** (gjedh, dhen, derra dhe shpend), shtimin **dhe specializimin e kompleksëve blegtorale, të përmirësojë teknikat e mbarështimit të kafshëve**.

**Hartëzimi i zinxhirit aktual të vlerës (ku, sa dhe si prodhohet, infrastrukturat ndërlidhëse mes operatorëve të biznesit) dhe zhvillimi i skenarëve për të ardhmen** *(p.sh. identifikim i nevojave për investime në ngritjen e Dhomave Frigoriferike, Qendrave Magazinuese, tregjeve të mëdha zonale – në Lezhë, Shëngjin, Shën Koll; ndërtimi i një thertoreje me standarde bashkëkohore për gjithë ZF; ndërtim baxhosh, pularish, stacionesh të reja të inseminimit artificial; qendër grumbullimi dhe përpunimi për produktet e gështenjës dhe arrës ne Ungrej etj.)*

**Sektori i verës** ka nevojë për të përmirësuar standardet në nivel ferme (përfshi pas-vjeljen, magazinimin, kategorizimin, etj.) dhe prodhimin e kultivarëve të tavolinës në sera. Investimet nevojiten gjithashtu në kantinat e verës që integrojnë edhe prodhimin e rrushit

**Siguria Ushqimore dhe Cilësia -** Autoritetet lokale dhe Drejtoria Rajonale e Bujqësisë duhet të bëjnë një diagnostikim të detajuar të kushteve të prodhimit bujqësor e blegtoral, të rrjetit logjistik nëpër të cilin produktet kalojnë, inspektimin e zbatimit të kushteve bazë higjeno-sanitare (në çdo fermë dhe operator biznesi) dhe ofrimit të shërbimit veterinar e vaksinimit të kafshëve, dhe sigurimin e kushteve për blerjen e inputeve bujqësore cilësore dhe të certifikuara, etj. **Respektimi i standardeve të sigurisë dhe cilësisë së ushqimeve** nga njëra anë mbron shëndetin e konsumatorit dhe nga ana tjetër është parakusht primar për aksesin dhe konkurrimin në tregje më të gjera (p.sh. vendet anëtare të BE-se).

**Hartimi i një plani veprimi për prodhimet tipike autoktone si elementë primarë në ngritjen dhe mbrojtjen e një modeli agroturizmi autokton**; *(*shembuj projektesh; *mbështetje për mbrojtje/certifikim/ standardizim prodhimesh, mbështetje për përmirësimin e ambalazhimit dhe etiketimit, masa promovuese/marketingu – panaire, festivale Gastronomie etj.)*

## *2.2 Aktiviteti i Peshkimit*[39]

### 2.2.1 Tregues Bazë

Vetë pozicioni gjeografik i zonës së Lezhës dhe resurset e pasura ujore e bëjnë peshkimin dhe industrinë e përpunimit të tij një nga aktivitetet kryesore ekonomike. Zona përshkohet nga lumenjtë Drin dhe Mat, ka dalje ne detin Adriatik (vija bregdetare 38 km) dhe më në brendësi ka komplekset lagu norë të Kunës dhe Vainit.

Peshkimi është gjithashtu një sektor me rëndësi në nivel kombëtar. Në vitin 2011 janë zënë; 4 804 tonë peshk, nga të cilat 2 287 tonë janë zënë në det, 495 tonë në breg (viti 2012), 229 tonë në lagunat bregdetare, 1 793 tonë në pellgjet ujore. Prodhimi i akuakulturës në vend është1 304 tonë kurse i midhjes është 1 300 tonë[40]. Sot flota e peshkimit është e përqëndruar në katër portet e peshkimit në vend të cilat sipas madhësisë renditen si vijon; Durrës (111 anije peshkimi), Vlorë (85), Shëngjin (50) dhe Sarandë (34).

**Figura 11 Përbërja e Flotës së Peshkimit në Shqipëri**




Burimi: Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Drejtoria e Peshkimit, 2011

Industria e peshkimit ne Lezhe ka njohur investimet më të mëdha në rang vendi përsa i përket ngritjes së stabilimenteve të peshkut. Në vitin 2006, në këtë zonë janë ngritur tre pika përpunimi të peshkut dhe 90% e peshkut që zihet shkon drejt këtyre pikave. "Eurofish", "Poseidon" dhe "Rozafa" dhe "Inca" janë biznese të mëdha (2 Italo-Shqiptare dhe dy Shqiptare) që punësojnë mbi 1000 punonjës dhe që furnizojnë me produkte detare tregun e Lezhës edhe qytetet e tjera si dhe për eksport. Investimet e kryera janë te niveleve te larta duke plotësuar te gjitha standardet veterinare edhe për eksport.

Në nivel kombëtar konservimi i peshkut ka tërhequr 14.7 milionë leke investime[41].

[39] Analiza e këtij sektori nuk u detajua më tej për shkak se të dhënat për të ishin të pamjaftueshme, të vështira për tu siguruar nga strukturat në zonë ose për një pjesë të tyre nuk mund të garantohet saktësia/plotësia.
[40]Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor në Shqipëri, Maj 2013
[41]Vjetari Statistikor 2011, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit

Peshkimi është një mundësi punësimi për shumë banorë të zonës. Ne këtë sektor punojnë rreth 260 peshkatarë, te organizuar ne shoqata, qe peshkojnë ne dete dhe ne laguna. Sipas të dhënave gjatë vitit 2011 numri i varkave të licencuara për peshkim ishte rreth 50, kurse numri i subjekteve të ujërave të ëmbla dhe akuakulturës ishte 65. Në to peshkohen 31 lloje peshqish si; levrek, kocë, barbun, gjuhëz, karkalec, ngjalë, oktapod, krap etj.

Ndërmarrjet e prodhimit në sektor kanë HACCP dhe ISO. Nuk ka informalitet por ka mungesa në numrin e punonjësve (minimalisht për rreth 200 vete). Aq problematik është ky fenomen sa disa kompani po mendojnë të shpërngulen nga Lezha dhe Shëngjini për mungesë të krahut tëpunës. Megjithë thirrjet në TV lokale dhe kërkesat ne zyrat e punës, çështja e punësimit mbetet akoma e pazgjidhur. Punonjësit merren me autobusë çdo ditë, jo vetëm nga Shëngjini por edhe nga zonat përreth disi më të largëta si p.sh. Mamurrasi. Një kompani e përpunimit te prodhimeve te peshkimit "Mare Adriatik" prej disa vitesh është shpërngulur duke ndërtuar fabrikën ne Vaun e Dejës ne Shkodër.

Peshkimi është një është një nga sektorët me te rëndësishëm te ekonomisë dhe punësimit edhe për banoret e Shëngjinit porti i të cilit shtrihet ne zonën veriperëndimore te vendit, ne bregdetin Adriatik, ne një distance prej 60 km ne Veri te portit me te madh te vendit, atij te Durrësit. Porti i Shëngjinit zë vendin e trete ne vend për nga madhësia. Zënia e peshkut mundësohet nga një flote peshkimi e përbërë nga 50 anije. Peshku prodhohet e përpunohet si lende te pare, si produkt ne bllok ose i kripur ne fuçi nga importi, kryesisht nga Spanja, Italia, Greqia, Maroku, etj. Produkti përfundimtar ka destinacion kryesisht vendet e BE. Pranë Portit të Shëngjinit, në një sipërfaqe prej 100 ha kultivohen rreth 30-50 ton midhje në vit në raport me 1 300 tonë në nivel kombëtar[42].

Në vitin 2013,volume I eksportit të peshkut dhe produkteve të peshkut ishte 5,851 tonë me një vlerë prej € 30,7milionë. Importi I peshkut dhe frutave të detit ishte në masën 10,155 tonë me një vlerë €25,6 milion (Tabela 24).

Bilanci tregtar në produktet e detit është pozitiv në terma të vlerës, por negativ në terma të volumit. Eksportohen volume të ulëta të produkteve me vlerë të lartë, ndërkohë që importet mbizotërohen nga produkte deti me vlerë më të ulët. Shumica e importeve kanë origjinën nga Italia dhe Spanja (përkatësisht 19% dhe 24%). Destinacionet kryesore për eksportet shqiptare janë Italia (91% e vëllimit total) ndjekur nga Spanja (4%) dhe Greqia (3%).

**Tabela 24 Bilanci tregtar I produkteve të detit, 2013**

| | kg | € |
|---|---|---|
| Import | 10,154,993 | 25,554,967.34 |
| Eksport | 5,851,521 | 30,711,297.77 |
| Bilanci tregtar | -4,303,471 | 5,156,330.43 |

*Burimi: INSTAT*

Aktiviteti i peshkimit dhe produkteve ujore ka pësuar rritje edhe **në nivel kombëtar** ku peshkimi detar është rritur me 16% që nga 2007, peshkimi në breg është rritur me 5% dhe prodhimi i midhjes është rritur me 25%.

Kultivimi i produkteve të detit është i zhvilluar mirë, kryesisht ne formën e kultivimit të midhjeve dhe kultivimi i peshkut është rritur gjatë viteve të fundit dhe tashmë ka zëvendësuar thuajse plotësisht importin e peshkut të kultivuar. Konsumi është dyfishuar si rezultat i rritjes së të ardhurave. Industria e përpunimit ka bërë investime të mëdha dhe zotëron teknologji mjaft të qëndrueshme.

[42]Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor në Shqipëri, Maj 2013

**Disa nga oportunitetet që duhet të shfrytëzohen nga sektori i peshkimit në zonë janë;** pozicioni gjeografik i favorshëm dhe resurset e pasura ujore; mundësitë e punësimi për shumë banorë të zonës dhe rendësia në rritje e sektorit dhe performancës së tij në nivel kombëtar (rritje e sektorit, rritje investimesh, ngritje stabilimentesh peshku, bilanci tregtar pozitiv në terma të vlerës)

### 2.2.2 Problematika dhe Rekomandime

**Sfida të ndryshme ne sektor që mbeten të rëndësishme për t'u adresuar janë** : Peshkimi i jashtëligjshëm; mangësi në mirëmbajtjen rutinë dhe jo rutinë të kapaciteteve dhe në llojet e tjera të riparimeve të mjeteve lundruese; Infrastruktura e dobët e portit në limanet ekzistuese; mungesa në tregjet e organizuara të shitjes me shumicë dhe vështirësitë në lidhje me standardet e higjienës.

**Çmime të larta të produkteve të peshkut dhe mungesa e tregjeve të organizuara me shumicë të peshkut** (të domosdoshme në çdo zonë peshkimi), mbeten problematike për operatorët e sektorit dhe produktin e tyre tregtar. Mungesa e tregjeve pengon zhvillimin e sektorit kjo sepse tregtimi i produkteve të peshkimit bëhet nga operatorë tregtarë që i mbledhin këto produkte nga anijet e peshkimit mbi bazën e marrëveshjeve private jo formale dhe aspak të favorshme për prodhuesit. Shpesh, kërkesa nga këto subjekte tregtare për te blerë, përcakton nisjen e anijeve për peshkim. Megjithatë ka disa operatorë tregtarë që kanë anijet e veta të peshkimit.

Sa i përket **sa i përket çështjeve të sigurisë ushqimore, veterinare dhe fitosanitare,** për produktet e peshkimit dhe akuakulturën, **sektori mbetet i fragmentuar për sa i përket përgjegjësive dhe komunikimit, me inspektimet e prodhimeve të peshkimit** që janë vënë në dy departamente të ndryshme në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave. Për më tepër, kontrolli i sëmundjeve të peshkimit mbulohet nga Drejtoria e Shëndetit të Kafshëve në MBUMK ndërkohë që produktet ujore/të peshkimit mbulohen nga Drejtoria e Sigurisë Ushqimore në MBUMK dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

**Konsolidimi i industrisë së përpunimit** mund të luajë një rol të rëndësishëm në garantimin e një tregu të qëndrueshëm për fermat e vogla të peshkimit dhe mund të jetë një aktor kryesor investimi për rindërtimin e flotës së peshkimit. Mbështetja e industrisë se përpunimit te peshkut përmes lehtësimit te ngritjes se flotave te peshkimit te përhershme dhe ndërmjetësimit mes tyre dhe pikave te përpunimit te peshkut midis njësive Shëngjin, Lezhë e Shën Koll është në listën e projekteve të ardhshme për zonën

**Zgjerimi i portit sipas Master Planit** për të krijuar mundësinë e ankorimit të varkave lundruese dhe rritja e kapaciteteve të flotës së peshkimit është një projekt rajonal por i cili do ketë nevojë dhe për mbështetje nga qeveria qendrore

**Adresimi i mungesave (në numër dhe kualifikime) të forcës punëtore në sektor.** Marrja e disa masave promovuese për mundësitë e punësimit qe ofron peshkimi dhe hapja e kurseve të caktuara të specializuara për trajnimin e burimeve njerëzore.

**Peshkimi** dhe aktivitetet ekonomike të lidhura me të duhet të shihen edhe në perspektivën e një sektori shoqërues apo **pjesë e një oferte të integruar agro-turistike të Zonës**.

Është e nevojshme të studiohen më tej impaktet e sektorit në kushtet sociale të komunitetit sidomos në zonat rurale.

**Disa nevoja për investime në nivel kombëtar janë:** zëvendësimi dhe rinovimi/përmirësimi i barkave të peshkimit; investime ne sektorit të kultivimit të peshkut; investime nga kompanitë përpunuese mesatare (sidomos ne drejtim të përmbushjes së standardeve me qëllim që të jenë në gjendje të eksportojnë (p.sh. në rastin e midhjeve)

## *2.3 Industri të ndryshme përpunim dhe nxjerrëse*[43]

### 2.3.1 Tregues Bazë

Në zonë, përveç sektorëve tipikë si bujqësia, blegtoria e peshkimi njohin zhvillim dhe industri të ndryshme nxjerrjeje dhe përpunimit të mineraleve jo metalike dhe metalike, të materialeve inerte, të materialeve të ndërtimit, gurit, mermerit, betonit, çimentos, tullave, dhe industri më të lehta përpunimi si ajo e drurit dhe e lëkurës.

**Në territorin e Lezhës gjenden rreth 40% e rezervave të mineraleve jo metalikë të vendit**[44]. Kërkimet minerare kanë zbuluar rezerva bakri (tip kuarc/sulfuri) që arrin masën 0.5 milion ton në pjesën verilindore të krahinës si dhe burime të shumta bakri në Vele Vendi, Zef Sul dhe Qafë Kangjel. Në kufijtë e Lezhës gjenden dy burime të nikelit-sulfurit me një masë edhe floriri, si dy burime të platinit. Mineralet e zinkut, kromit, gur gëlqeror, granitit dhe kallajit gjenden në zonat bregdetare të Rilës dhe Talës. Rezerva mermeri, graniti dhe kaolinit (porcelan, argjilë), të cilat përdoren gjerësisht gjenden në Kashnjet. Burime të tjera përreth Lezhës përfshijnë rezerva të mermerit të kuq dekorativ në fshatin Tresh, afër qytetit, materiale të ndryshme inerte në lumin Mat si dhe gur gëlqeror, në Kakarriq dhe Shëngjin, përdorur për ndërtim.

**Tabela 25 Leje Minerare Aktive në ZF Lezhë, 2014**

| Emri i Subjektit | Lloji i Mineralit | Km2 | Tipi i lejes |
|---|---|---|---|
| **MILIS BRICK** | Argjilë | 0,357 | Shfrytëzimi |
| **OTTO - AL** | Gëlqeror | 1,7 | Shfrytëzimi |
| **KORABI - K** | Gëlqeror | 0,04 | Shfrytëzimi |
| **QUSHKU & CO** | Gëlqeror | 0,01 | Shfrytëzimi |
| **MALVINI** | Gëlqeror | 0,096 | Shfrytëzimi |
| **OTTO - AL** | Gëlqeror | 1,28 | Shfrytëzimi |
| **GENERAL CEMENT ALBANIA** | Gëlqeror | 1,087 | Shfrytëzimi |
| **SHPRESA - AL** | Krom | 0,23 | Shfrytëzimi |
| **COLACEM ALBANIA** | Gëlqeror | 0,95 | Shfrytëzimi |
| **PACANI** | Gëlqeror | 0,08 | Shfrytëzimi |
| **PALUCA - SA** | Gëlqeror | 0,71 | Shfrytëzimi |
| **GENTARI** | Krom | 0,11 | Shfrytëzim |
| **MALVINI** | Gëlqeror | 0,047 | Shfrytëzim |
| **GJONI** | Traktolite | 0,037 | Shfrytëzim |
| **GEOECONOMICS** | Titano - magnetik | 9,88 | Kërkim - zbulimi |
| **BESJONA IMPEX** | Gëlqeror | 0,0507 | Shfrytëzim |
| **BICI** | Gëlqeror | 0,0907 | Shfrytëzim |
| **VLLAZNIMI DEDA IMP - EKSPORT** | Krom | 0,094 | Shfrytëzimi |
| **AYEN AS ENERGJI** | Serpentine | 0,19 | Shfrytëzimi |
| **BALKAN RESOURCES** | Bakër | 2,9 | Shfrytëzimi |
| **EUROINERT BIBA** | Gëlqeror | 0,104 | Shfrytëzimi |
| **JAB RESOURCES** | Ar | 35,84 | Kërkim - zbulimi |
| **ALBA KURBIN** | Gëlqeror | 0,054 | Shfrytëzimi |
| **AL - GEM** | Gëlqeror | 0,298 | Shfrytëzimi |
| **BALKAN RESOURCES** | Bakër | 23,05 | Kërkim - zbulimi |

*Burimi; Ministria e Energjisë dhe Industrisë*

[43] Analiza e këtij sektori nuk u detajua më tej për shkak se të dhënat për të ishin të pamjaftueshme, të vështira për tu siguruar nga strukturat në zonë ose për një pjesë të tyre nuk mund të garantohet saktësia/plotësia.
[44] Plani strategjik Bashkia Lezhë 2010-2030

**Nëntoka e Kashnjetit është mjaft e pasur ne minerale sidomos ne titan.** Titani është pasuria e dyte ne nivel kombëtar. Titanomagnetonet, siç quhen ndryshe, vlerësohen të jenë rreth 130 milionë ton rezerva te gjendura kryesisht **ne Sukaxhi dhe Ungrej të Kashnjetit**. Sot një kompani australiane (GeoEconomix) ka marrë lejen e kërkimit dhe ka aplikuar për leje shfrytëzimi dhe mendohet që këtë vit të fillojë përgatitja e hapjes së vendburimit kryesor në Zonën e Kashnjetit.

**Sektori i industrisë i lidhur me përpunimin e mermerit** që nxirret nga kodrat e Treshit dhe të **materialeve inerte të nxjerra nga lumi Mat** është një aktivitet i rëndësishëm për zonën dhe sidomos për njësitë Shënkoll e Zejmen. Për shembull në Shënkoll zhvillojnë aktivitetin e tyre 11 subjekte në këtë fushë. Nga këto, 3 subjekte merren me përpunimin e mermerit. Mermer nxirret në kufi të komunës, në fshatin Tresh të komunës së Zejmenit. Depozitimi i mermerit në Tresh përfaqësohet nga mermer i tipit "marbled limestone" në ngjyrë gri, të kuqe dhe me variacione (motley) në ngjyrë. Rezerva në Tresh vlerësohet në 13,000,000 ton. Gjithashtu në Shënkoll zhvillojnë aktivitetin e tyre 5 subjekte për nxjerrjen dhe përpunimin e inerteve dhe të betonit: 3 janë kompani përpunimi inertesh, 2 janë kompani për prodhim betoni. Një kompani ka aktivitet në fushën e shpimit për nxjerrjen e ujit. Në Zejmen 16 subjekte ushtrojnë aktivitetin në këtë fushë nga të cilat 5 merren me nxjerrjen dhe përpunimin e mermerit. Gjithashtu 11 subjekte operojnë në nxjerrjen dhe përpunimin e inerteve (6 përpunojnë inerte dhe janë biznese të mëdha të mëdha, 2 prodhojnë beton dhe 3 grumbullojnë gur dekorativ ose zhavorr)[45].

**Industria e përpunimit te gurit dhe nxjerrjes se çimentos** është e zhvilluar dhe **ne Balldren**. Kjo e fundit ka filluar te shfrytëzohet vetëm në 2009 nëpërmjet aktivitetit të dy fabrikave të çimentos (grupi Colacem Albania). Komuna ka potencial sepse përmban në territorin e saj masive të konsiderueshme shkëmbore. Nga ana tjetër **në Kolsh ushtrojnë aktivitetin ekonomik një fabrikë tullash dhe një përpunim guri.**

Në njësinë Ungrej janë në fazat e para të studimit dhe ndërtimit projekte në fushën minerare dhe shfrytëzimin e burimeve ujore për energji. Këta janë artikuluar edhe si sektorë prioritarë për ekonominë e zonës. Minierat janë një fushë në fazat e para të studimit kurse HEC-et janë në proces ndërtimi . Dy miniera që pritet të hapen dhe 2 HEC-et që janë në ndërtim janë mundësi punësimi dhe zhvillimi për zonën. Ca HEC detaje

**Përpunimi i drurit është një aktivitet që operohet aktualisht në Shënkoll, Zejmen dhe Balldren** dhe ka mundësi të operohet dhe në komunat si Kallmet e Ungrej. Në Shënkoll zhvillojnë aktivitetin e tyre: 1 subjekt për përpunim druri dhe 1 subjekt për prodhimin e objekteve prej duralumini. Përpunimi lëndës drusore dhe prodhimi i produkteve prej duralumini realizohet nga dhe për banoret e komunës. Në Zejmen ushtrojnë aktivitetin 7 subjekte në industrinë e përpunimit të drurit dhe prodhimit të mobiljeve. Industria e përpunimit të drurit ka potencial të lartë edhe ne Ungrej por duhet të studiohet e shfrytëzohet më shumë për t'i shërbyer komunitetit të saj. Në Kallmet përpunimi i drurit dhe i gurit mund të zhvillohen si elementë të ekonomisë tradicionale në zonë[46].

**Industria Fason** (si p.sh. ajo e përpunimit të lëkurës apo veshjeve), është po ashtu e rëndësishme për nga numri i personave që punëson, trendi në rritje i saj dhe eksportet drejt vendeve të tjera. Në vend në përgjithësi ofrohet fason klasik dhe jo cikël i mbyllur apo i plotë shërbimesh. Perspektiva në të ardhmen është që e gjithë industria të realizojë një ofertë të integruar (dizenjim, modelim, prodhim), dhe të shtojë vlerën e shërbimeve të teknologjisë së informacionit

Porti i Shëngjinit shërben si një nyje e rëndësishme operative dhe logjistike për këto industri. Për nga madhësia ai zë vendin e trete ne vend dhe përpunon 9 % te vëllimit te mallrave te përpunuara ne portet shqiptare. Aktivitetet e tij ndër të tjera janë; përpunimi i mallrave, si ato të importit (çimento, mallra ushqimore, karburante) dhe te eksportit (si materiale ndërtimi, inerte) transport udhëtarësh dhe peshkim.

[45] Nga Strategjitë Lokale të Zhvillimit të Njësive Zejmen dhe Shën Koll,
[46] Nga Strategjitë Lokale të Zhvillimit të Njësive

Grup mallrat kryesore qe përpunohen ne port janë materialet e ndërtimit (çimento, tulla, tjegulla) te ambalazhuara e te vendosura ne slinker (çimento) dhe me paleta (tulla, tjegulla) dhe karburante me anije cisterne

Vëllimi i punës se Portit te Shëngjinit ka ardhur në rritje përgjatë viteve. Në 2004 ka patur një rritje të eksporteve me 144% dhe të importeve me 152 %. Eksportet ne 2004 janë 14202 ton nga ku shumica material ndërtimi, inerte dhe pak skrap) kurse importet ishin 279,177 ton (kryesisht çimento, Tulla/Tjegulla, Karburante)

### 2.3.2 Problematika dhe Rekomandime

Sektori i industrisë minerare karakterizohet nga veprimtari jashtë monitorimit shtetëror të aktivitetit në sektorin minerar, madje edhe nga veprimtari të jashtëligjshme që dëmtojnë rëndë interesin publik.

Puna në miniera kryhet jashtë rregullave dhe standardeve për sigurinë në punë, duke dëmtuar shëndetin e punonjësve, si dhe duke marrë jetë njerëzish. Shkalla e përpunimit të mineraleve vazhdon të jetë mjaft e ulët dhe eksportet janë kryesisht në mineral bruto.

Investimet në sektorin minerar janë pothuajse inekzistente, duke bërë që ky sektor të ketë sot një prapambetje teknike e teknologjike të rëndësishme, çka reflektohet në produktivitetin minimal të tij.

Industria Fason karakterizohet nga informalitet, kushte shumë të vështira pune dhe paga minimale

**Masat kombëtare që duhet të ndërmerren lidhur me industrinë janë**:

- zhvillimi dhe modernizimin e mëtejshëm të sektorit të gjeologjisë dhe minierave
- Hartimin e politikave specifike që nxisin, orientojnë dhe garantojnë investime e financime masive të brendshme e të huaja në industrinë minerare;
- Ndërmarrja e masave ligjore dhe strukturore për të mundësuar rritjen e shkallës së pasurimit dhe përpunimit të mineraleve në vend.
- Rritje e eksporteve minerare si një element i rëndësishëm i rritjes ekonomike, punësimit dhe nivelit të jetesës në zonat minerare.
- Monitorimin e veprimtarisë minerare me synim garantimin e interesit publik në këtë sektor.
- ndërprerjen e menjëhershme të veprimtarive minerare të rrezikshme dhe të jashtëligjshme e ndërprerjen e veprimtarive minerare që nuk kanë respektuar detyrimet kontraktuale, që kanë dëmtuar e dëmtojnë rëndë mjedisin, sidomos të atyre veprimtarive pranë zonave urbane.

**Masat lokale që duhet të ndërmerren lidhur me industrinë janë**:

- Hartimi një strategjie për ruajtjen e ujerave nëntokësore nga ndotjet (infiltrimi ujit) ne zonat e kontaminuara nga veprimtaritë industriale
- Identifikimi, Studimi Fizibilitetit dhe Plani Veprimit për trajtimin e mbetjeve inerte nga aktiviteti industrial përgjatë lumenjve

## *2.4 Sektori i Turizmit*

### 2.4.1 Tregues Bazë

Turizmi në Lezhe konsiderohet si një nga sektorët prioritarë e më premtues sa i përket potencialit që ka për të kontribuar në zhvillimin social-ekonomik të rajonit. Në të ardhmen zona projektohet që të konkurroje edhe me oferta turistike të vendeve fqinje si Mali i Zi, Kroacia, Sllovenia etj.

**Zona disponon një sërë asetesh turistike (natyrore e kulturore) si p.sh.;** pozicion gjeografik të përshtatshëm, gjatësia e vijës bregdetare (38 km), trashëgimi të pasur arkeologjike, etno-kulturore e historike, objekte të lashta kulti (kisha katolike, ortodokse, xhamia dhe teqe), tradita të zhvilluar të mikpritjes dhe gatimeve tradicionale, praninë e portit të tretë më të madh në vend (Shëngjinit) etj.

Qyteti i Lezhës, qendër e Qarkut dhe qendër e ZF është themeluar në vitin 385 para erës sonë. Gjatë gjithë historisë ilire dhe më vonë, ky qytet ka luajtur një rol të veçantë historik. Pozicioni gjeografik që ka qyteti i Lezhës me rrethinat ka bërë që ai që në lashtësi të jetë një ndër qendrat tregtare e politiko ushtarake të rëndësishme. Është kjo arsyeja që pikërisht në këtë qytet, në momente të caktuara të historisë sonë, janë bërë aktivitete politike e kulturore të nivelit të lartë kombëtar, si: "Lidhja e Lezhës" më 1444, "Kuvendi i Arbrit" në 1703, etj. Prezenca e Urdhrit Franceskan në Lezhë, e themeluar nga vetë Shën Francesku i Asizit në vitin 1220,i shtohet historisë dhe kulturës së qytetit.

**Kalaja e Lezhës**

**Vendvarrimi i heroit kombëtar Gjergj Kastrioti**

ZF e Lezhës ka një trashëgimi të pasur etnokulturore, historike, arkeologjike dhe etnografike. Në të ndodhen shumë vende dhe monumente historike me interes për t'u vizituar. Memoriali "Gjergj Kastrioti" Skënderbeu *(ku vizitorët mund të shohin emblemat e familjeve feudale shqiptare dhe një kopje të shpatës dhe përkrenares së Skënderbeut);* (Kisha e Shën Nikollës, Kuvendi i Besëlidhjes dhe Vendvarrimi i Skënderbeut), Kalaja e Lezhës (Kështjella Arbërore), Nimfeumi (Shëngjini i sotëm)etj. dhe shumë objekte kulti si Kisha e Shën Gjon Kryepremit (mbajtur Kuvendi i Arbrit), Kisha e Eufemisë (shek.XII) Kisha e Shën Nunciatës, etj. përbëjnë atraksione shumë të rëndësishme për zhvillimin e turizmit kulturor në këtë zonë.

**Kalaja e Lezhës**[47]është një nga vlerat e spikatura monumentale e historike të qytetit. Origjina ilire e saj dhe gjurmët e arkitekturave ilire, romake, bizantine dhe osmane e bëjnë atë një objekt interesant për t'u vizituar.

[47]filluar ne shek. 4 përfunduar ne vitin 1521

Aty ka shumë objekte interesante për t'u vizituar si rrënojat e ndërtesave osmane brenda kalasë, xhamia, kulla në murin juglindor me një hark romak dhe kulla ilire në murin jugor. Gjithashtu Ura e vjetër e qytetit (1926) e ndërtuar mbi lumin Drin dhe shtëpia e Mlikajve (1910, një banese tipike qytetare e Lezhës, ofrojnë vlerat e tyre arkitekturore, historike dhe kulturore.

Një listë më e detajuar e monumenteve të kulturës paraqitet në tabelën më poshtë;

**Tabela 26 Monumentet e Kulturës**

| Nr. | Emri i monumentit | Vendi |
|---|---|---|
| 1 | Gërmadhat e Malit Te Shëlbuem (AKROLIS) | Mali I Shelbumit |
| 2 | Muret e Qytetit Antik Lis | Lezhë |
| 3 | Kisha e Shna Ndout Vendvarrimi I Skenderbeut | Lezhë |
| 4 | Rrenojat e Ures Plakagjonit | Fshati Rraboshtë |
| 5 | Kisha e Shen Barbulles | në fshatin Pllanë |
| 6 | Ura e Shkinës | fshatin Piraj |
| 7 | Kisha e Shen Aleksandrit | Boikon Spiten |
| 8 | Kisha e Shen Venerandës | Balldren |
| 9 | Rrenojat e Kishes Se Shen Stefanit | Blinisht |
| 10 | Kisha e Shen Mhillit | Nenshat |
| 11 | Banesa Shteterore (Ish Sali Bajram Zekës) | Varosh Lezhë |
| 12 | Banesa Shteterore (Ish Esat Mlikës) | Lezhë |
| 13 | Banesa e Geg Prendit | Patalej |
| 14 | Banesa e Ndue Frrokut | Ishull-Lezhë |
| 15 | Kalaja e Lezhës | Lezhë |
| 16 | Kisha e Shën Eufemisë | Kallmet |
| 17 | Kisha e Kuvendit të Arbërit | Merqi |
| 18 | Katedralja e Kallmetit | Kallmet |
| 19 | Banesa Shteterore (Ish Ndue Zefi) | |
| 20 | Banesa e Gjergj Fishtës | |
| 21 | Rrënojat e Kishës së Shën Mëhillit Në Kalanë e Sapës | |
| 22 | Kisha e Shen e Premtes | |

*Burimi; http://qarkulezhe.gov.al/images/pdf/monumentet%20e%20kultures.pdf*

**Në qendër të zonës funksionale ka disa objekte social kulturore** si Pallati Kulturës, Qendra Kulturore për Fëmijë, Muzeu Historik, Biblioteka Publike e qytetit të cilat në mënyrë periodike zhvillojnë aktivitete në interes të edukimit qytetarë dhe për ruajtjen e vlerave kombëtare. Në këtë zonë është bërë traditë organizimi i festivaleve të Rapsodive dhe muzikës Folklorike. Gjithashtu Qendra Kulturore e fëmijëve, organizon aktivitete për argëtimin e fëmijëve dhe nxitjen e talenteve të reja. Në pallatin e kulturës ndodhet dhe galeria e arteve ku ekspozohen vepra të autoreve Lezhjane e me gjerë.

Në këtë zonë ekziston një **infrastrukturë sportive e kënaqshme** ku përfshihen stadiumi i qytetit „Besëlidhja" dhe terrene e ambiente të tjera sportive. Ekipi i futbollit "Besëlidhja" dhe zhvillimi i shumë sporteve si atletika, mundja e lirë dhe çiklizmi tërheqin vëmendjen e sportdashësve dhe gjallërojnë jetën sportive të zonës.

ZF e Lezhës përveç vlerave të rëndësishme historike, arkeologjike, kulturore, artistike i ofron vizitorëve të saj edhe **bukuritë e spikatura natyrore** si malin, kodrën, fushën, lumenjtë, detin dhe lagunat e saj. Vendet turistike me interes të madh janë plazhet e plazhet të Shëngjinit, Kunes, Vainit dhe Tales, lagunat e Kunes dhe Vainit, hoteli i Gjuetisë, etj. Larmia e mjedisit, prania e florës dhe faunës së shumëllojshme, klima e përshtatshme janë potenciale të mëdha për zhvillimin e një turizmi bashkëkohor dhe të qëndrueshëm me të

gjitha llojet e pasurive turistike: detare, lagu norë e luginore (luginat e lumenjve) e ndër të tjera turizëm malor.

**Plazhi i Shëngjinit** është destinacioni më i rëndësishëm turistik në të gjithë rajonin po ashtu edhe në nivel vendi. Ai është ndër plazhet më të vjetra në vend.

**Plazhet e Talës e Rënës së Hedhun** janë në fillimet e shfrytëzimit të tyre dhe përfaqësojnë zona me potencial të madh zhvillimi. Gjithsesi investime të mëtejshme janë të nevojshme në infrastrukturë.

**Laguna e Kunë-Vainit** është një zone me florë dhe faunë shumë të pasur e cila ka një sipërfaqe prej 180 Ha tokë lagu norë dhe 1050 ha sipërfaqe ujore dhe një thellësi 1,5-5 metra. Ka disa lokale përreth qe gatuajnë peshkun e freskët të lagunës. Nëzonë gjatë sezoneve të caktuara zhvillohen aktivitete të shumta të gjuetisë ku shumë gjuetarë amatorë të huaj dhe vendas marrin pjesë.

**Ishull Lezhë** kanjë varg hotelesh, motelesh, restorantesh moderne e tradicionale duke e bërë atë tërheqës për turistët vendas dhe të huaj.

Disa nga tipet e turizmit më të zhvilluara ose me potencial të mëtejshëm zhvillimi në Zonën Funksionale të Lezhës janë; turizmi bregdetar, rural e kulturor. Një përshkrim më i detajuar dhe disa tregues paraqiten më poshtë;

***Turizmi Bregdetar*** **-** Në zonë ka një infrastrukturë të ngritur dhe kapacitete akomoduese të mëdha, sidomos në Shëngjin. Turizmi është sezonal (maj-shtator) dhe ofron diell, det dhe rërë. Lagunat e Kunë-Vainit kanë një shumëllojshmëri flore dhe faune. Bregdeti nga Rana e Hedhun e në vazhdim ka rërë shumë të pastër e të pasur me jod veçanërisht në zona të pashfrytëzuara si Talë. Pas rërës në Shëngjin vjen një brez pishash deri në fund të Kunës kurse në pjesën kur lidhet me Vainin në bregdet vazhdon me një pyll me pisha e drurë shumëvjeçarë por është i izoluar në të dy anët për mungesë të dy urave dhe infrastrukturës së nevojshme. Në këtë zonë në 20 vitet e fundit po rriten presionet klimatike si p.sh. erozioni i lartë (deti përparon në drejtim të tokës çdo vit mesatarisht deri ne 3 m), përmbytjet e fuqishme bregdetare, stuhitë detare etj.

Plazhet frekuentohen nga Maji në Shtator me turistë rezidentë dhe ditorë, vendas dhe të huaj. Funksionon një rrjet shërbimi tregtar që shërben turistët me çadra dhe shezlongë. Pastrimi i bregut bëhet çdo natë nga pronarët e hoteleve kurse pjesët e tjera mbeten gjerësisht të pambuluara nga komuna. Lëvizja e pushuesve kryhet me furgonë, autobusë dhe mjete private.

Në ZF Lezhe ushtrojnë aktivitetin 28 hotele, 7 motele, me 3940 shtretër. Funksionojnë 118 lokale shërbimi. Në Shëngjin ka rreth 550 shtëpi private që jepen me qira gjatë sezonit të plazhit. Të dhënat e komunës tregojnë se gjatë sezonit të plazhit vijnë mbi 5000 pushues në ditë krahas vizitorëve që vijnë gjatë vitit në qark për turizëm historik dhe etno-kulturor. Në Shëngjin nga vitet 1990 deri në 2008 sipërfaqja e shfrytëzuar e plazhit është rritur nga 4 deri në 13 ha nr. I hoteleve nga 7 në 24, nr. i dhomave nga 214 në 979 dhe nr. i shtretërve nga 680 në 3054. Nr. i turistëve në Shëngjin nga 2008 në 2009 është rritur me 20%. Në bregdetin e Shëngjinit ka ndërtime të tjera janë ende në proces.

Në veri të Shëngjinit, **plazhi i Ranës së Hedhun** ka një peizazh të ndërthurur det, rërë pisha e drurë. Pavarësisht se mbetet akoma e pashfrytëzuar për shkak të mungesës së infrastrukturës, ka shumë investitorë të huaj që kanë shfaqur interes për të investuar[48].

[48] Nuk garantojmë tërësisht saktësinë apo plotësinë e të dhënave në këtë paragraf. Ka qenë e veshtirë të mblidhen tregues koherentë dhe të azhornuar për këtë sektor

**Turizmi natyror / Ekoturizmi / Turizmi rural/AgroTurizmi**

Sa i përket këtij lloj turizmi resurset e zonës janë të mëdha dhe me potencial te larte zhvillimi por nevojitet një studim më i detajuar, tregues më të saktë, të azhornuar e të dhëna të plota, një inventar asetesh, dhe një zhvillimi koncepti të i integruar produkti turistik.

Një nga historite e suksesit për zonën funksionale në fushën e agro-turizmit është **"Mrizi i Zanave"** (http://ëëë.mrizizanave.com/). Ky model është një nga përfaqësuesit me te denjë te filozofisë "sloë Food – Ushqim i Ngadalte", një projekt kulturor qe propozon një filozofi të kënaqësisë dhe një program edukimi të shijimit, të ruajtjes së trashëgimisë enogastronomike e të formimit të konsumatorit, një filozofi të kënaqësisë dhe një program edukimi të shijimit, të ruajtjes së trashëgimisë enogastronomike dhe të formimit të konsumatorit. Mrizi i Zanave ofron një menu autentike Shqiptare me përbërës te freskët, dhe prodhime bio te kultivuara ne zonën përreth. Komentet e konsumatorëve e listojnë si një nga eksperiencat kulinare me te jashtëzakonshme dhe te arrira ne Shqipërinë e Veriut.

Ferma e vetë restorantit mbjelle përreth me vreshta, ullinj dhe perime, pozicioni i këndshëm ne fshatin Fishte, historia e zonës e cila është vendlindja e njërit prej personaliteteve te shekullit te 19, Gjergj Fishta, janë te gjithë elemente te rëndësishëm qe formojnë identitetin e këtij modeli agro-turizmi.

Çdo gjë e shërbyer është tërësisht organike, me produkte tipike të zonës. Perimet e freskëta mblidhen direkt ne kopesh dhe shërbehen ne pjata qeramike te përgatitura nga një artizan i zonës. Djathërat përpunohen nga stafi I restorantit, proshuta tipike e vendi ruhet ne qilar dhe vera e kuqe prodhohet nga vreshtat e mbjella përreth. Te tille elemente e bëjnë Mrizin e Zanave një eksperiencë gastronomike rurale autentike.

Artizanati gjithashtu kosiderohet si një mundwsi për punësim dhe njw komponent qe integrohet natyrshem ne oferten turistike. Ka disa zona nw Lezhw me traditw të gjatë në prodhimin e produkteve të artizanatit dhe dekorimit për përdorim vetjak dhe për tregtim. Megjithatë, tradita e dikurshme e prodhimit të veshjeve, qilimave, tekstileve të ndryshme apo drurit rrezikon të humabse me kalimin e kohes nese mungojne mekanizmat e duhur për të kaluar zanatin nga një brez te tjetri. Mbështetja e sektorit të artizanatit ka potencialin për të rritur të ardhurat; për të promovuar turizmin kulturor dhe për rritjen e punësimit.

*Vizioni i Qarkut Lezhë[49] është që rajoni të jetë pjesë integrale e destinacionit turistik, Shqipëria e Veriut, me një turizëm të qëndrueshëm e të zhvilluar në mënyrë të balancuar; detar, rural, kulturor e të integruar në ekonominë rurale.*

### 2.4.2 Avantazhe Konkurruese

Para se të analizohen avantazhet e Zonës në Turizëm, është me rëndësi të përmenden disa tregues makroekonomikë në sektor, të cilat dëshmojnë aktraktivitetin e tij në vend, rajon dhe botë dhe potencialin që paraqet Turizmi si sektor për të ardhmen;

- Është një prej industrive me zhvillim më të shpejtë në shekullin e 21-të për sa i përket kontributit global të PBB-së, të ardhurave nga shkëmbimi valutor dhe krijimit të vendeve të punës.
- Sipas llogaritjeve për Shqipërinë kontributi i drejtpërdrejtë i turizmit për PBB-në për vitin 2013 ishte 4,8 % të tij ndërsa kontributi i përgjithshëm për ekonominë ishte 16,7%. Sektori i turizmit ka hapur drejtpërdrejt 4,3 % të numrit të përgjithshëm të vendeve të reja të punës ndërsa në mënyrë të tërthortë ka hapur 15,2% të tyre[50].

[49] Strategjia e Turizmit dhe Agroturizmit në qarkun Lezhë, 2010-2013
[50] Nga Këshilli Botëror për Turizmin dhe Udhëtimet,

- Që prej vitit 2001 numri i vizitorëve ndërkombëtarë  në Shqipëri është rritur ndjeshëm duke çuar mbërritjet ne mbi 3,45 milion vizitorë në 2012. Rritja ishte veçanërisht e fuqishme nga Evropa dhe Ballkani Jugor (Kosova dhe ish- Republika Jugosllave e Maqedonisë) midis viteve 2008 dhe 2012[51].
- Në 2010 vizitorët ndërkombëtarë shpenzonin 82 Euro/në ditë me një kohëzgjatje mesatare prej 5 ditësh ndërsa për turistët e argëtimit, koha mesatare e qëndrimit ishte më e shkurtër – rreth 2,8 ditë. Shpenzimi mesatar në destinacionin vendor është 79 Euro[52].

Të gjithë këta tregues makroekonomikë pozitivë, janë një arsye më tepër se përse Zona duhet ta konsiderojë si prioritet zhvillimin e mëtejshëm e këtij sektori.

**Disa nga avantazhet e zonës në sektor janë;**

- Pozita gjeografike dhe afërsia me hallkat më të rëndësishme logjistike në vend e bëjnë lehtësisht të aksesueshëm nga turistë brenda dhe jashtë vendit .
- Lezha ne nivel Kombëtar[53] përmendet në rrjetin e qyteteve që ofrojnë turizëm kulturor[54]. Gjithashtu Shëngjini përmendet  në rrjetin  e pikave të turizmit bregdetar dhe me kapacitete të bollshme akomoduese[55]
- Zona disponon mjaft resurse të shumëllojshme natyrore e kulturore për të zhvilluar një ofertë turistike të pasur larmishme
- Zona ka potencial për zhvillimin e mëtejshëm të agro turizmit (produkte tipike gastronomike të kombinuara me një mjedis natyror të këndshëm).  Megjithëse i rralle ne Shqipëri si lloj turizmi , nëse zhvillohet me kujdes, ai  mund te kthehet  ne një instrument rigjenerimi te traditave te zonës, kuzhinës rurale dhe promovues i mbrojtjes e mjedisit dhe zhvillimit ekonomik.  Ai mund te shërbejë si një forme e re bashkëpunimi midis bizneseve lokale dhe ne te njëjtën kohe te rrisë interesin e njerëzve për prodhimet lokale.
- Ekziston një studim urbanistik i zhvillimit të Turizmit dhe mbrojtjes së bregut në zonën turistike të Gjirit të Drinit me një sipërfaqe rreth 1100 ha.

### 2.4.3 Problematika dhe Rekomandime

Disa problematika të rëndësishme dhe emergjente për t'u adresuar ne lidhje me turizmin në zonë janë;

Mungesa e një qasje të koordinuar dhe të integruar të ofertës turistik; Kaos në ndërtime dhe nr. i lartë ndërtimesh pa leje; Mungesa e  një master-plani të Turizmit; Infrastruktura pa standardet e nevojshme; Objekte social-kulturore të dëmtuara

Lezha nuk ka vizibilitet të mjaftueshëm në itineraret turistike rajonale e ndërkombëtare që sugjerohen nëpër publikime/media të ndryshme.

[51] "Rruga e Kombit" e ndërtuar kohët e fundit ka ndikuar ndjeshëm në numrin e vizitorëve nga këto vende

[53]Draft-strategjia  e Zhvillimit të Turizmit në Shqipëri 2014-2020

[54]Edhe pse nuk është qëllimi kryesor i vizitës në Shqipëri, arkeologjia/ trashëgimia/ kultura identifikohen si pikat e forta kryesore të Shqipërisë në studime të ndryshme te kryera me vizitorë dhe industrinë e udhëtimeve nga tregjet e huaja.  te vizitave turistike janë Shkodra, Lezha, Kruja, Durrësi, Tirana, Fieri, Berati, Elbasani, Korça, Përmeti, Gjirokastra, Saranda dhe Vlora.

[55]Duke iu referuar vendndodhjes së tyre, 80% e hoteleve ndodhen në zonat bregdetare dhe liqenore (Velipojë, Shëngjin, Durrës, Kavajë, Vlorë, Sarandë, Pogradec), 10% e hoteleve ndodhen në Tiranë dhe 10% ndodhen në zona të tjera

Agro-turizmi nuk është mjaftueshëm i elaboruar në dokumentet strategjikë të zonës. Flitet shpesh për agro-turizëm por koncepti është ende shumë pak i integruar dhe larg definicioneve ndërkombëtare.

Rekomandohet që zona të inventarizojë resurset e veta, për të konceptuar dhe konsoliduar më lehtësisht produkte të integruara turistike dhe gjithashtu investime të mëtejshme në mënyrë që sektori të bëhet kompetitiv dhe i diferencuar edhe në nivel vendi.

Gjithashtu me disa përmirësime infrastrukturore të caktuara (të përmendura dhe në listën e projekteve/prioriteteve) më sipër, Lezha mund të integrohet më mirë në ofertën kombëtare turistike dhe atë rajonale (Mal i Zi, Kroaci, Slloveni etj.

**Disa koncept- projekte dhe prioritete që po konsiderohen nga Zona Funksionale për zhvillim janë;**

- **Hartimi i planit rregullues të vijës bregdetare dhe hartimi i planeve rregulluese lokale**. Me prioritet janë instrumentet e Planifikimit te Territorit për njësitë vendore Shëngjin dhe Shenkoll me fokus zhvillimin e turizmit dhe mbrojtjen e natyrës
- **Inventarizim i burimeve kryesore turistike, malore, historike dhe etnografike** të zonës; analizë e gjendjes së tyre fizike dhe nevojave për investime; dhe konceptimi i paketave të produkteve të ndryshme turistike
- **Krijimi i një produkti turistik me fokus turizmin historik dhe fetar,** duke përfshirë(Kishën e Laçit, Destinacionet ne Bashkinë e Lezhës, Kishën e Shën Eufemise (Kallmet), Padre Antonio (Kambanat e Paqes - Blinisht), etj., Pllane, Rubik,Orosh)
- **Projektimi i një itinerari ciklistik përgjatë Drinit te vjeter,** duke lidhur Zadrimen - Lezhe - Shëngjin (vazhdim i itenerarit te bicikletave/projekti Dajcit B.Bunes "Living the River")
- **Promovim/Marketing/Komunikim** ( p.sh. krijimi platformes dixhitale për promovimin e destinacioneve turistike ne Qarkun Lezhe; Harta turistike rajonale; zhvillim sinjalistike) / festivale /panaire promovuese të gastronomisë së Zonës *(p.sh. festivali Zadrima ne Fishte)*
- **Agro turizëm/Turizëm Natyror** (harta, sinjalistika, shtigjet për trekking tourism, nxitja e artizanatit të zonës, peshkimit, hipizmit si aktivitete shoqëruese që i shtojnë vlerë ofertës turistike të zonës)
- **Investim në kapacitetet njerëzore;** ngritja e një shkolle te mesme profesionale me fokus Hoteleri/Turizëm dhe kurse profesionale ne mbështetje te këtij sektori; Trajnim i guidave turistike dhe stafit te sigurisë bregdetare ne bashkëpunim me shkollën e mesme profesionale te hoteleri/turizëm etj.
- **Të tjera;** Ndërtimi i rrugës për në Kalanë e Lezhës dhe rikonstruksioni i murit të Kalasë, Ngritja e një muzeu Etnografik etj.

**Projekte të ndryshme infrastrukturore të cilat duhet të konsiderohen si prioritare për mbështetjen e zhvillimit të turizmit janë**; Rruga Shëngjin-Kunë-Vain e cila shumë e dëmtuar; Ndërtimi i rrugës turistike Talë-Shëngjin-Velipojë-Ulqin[56] që do të lehtësojë lëvizjen, do të krijojë kushte për shtimin e vizitorëve vendas e të huaj dhe do të nxjerrë më në pah bregdetin vendas si vazhdim i bukurive natyrore të Malit të Zi, Kroacisë, Sllovenisë etj.; Përmirësimi i mëtejshëm i furnizimit me ujë të pijshëm dhe energji elektrike (24 orë); ndërtimi i parkingjeve, shtimi i hapësirave të gjelbra në gjithë territorin

[56] Projekt i EPTISA që është ratifikuar nga qeveria

**Strategjia rajonit artikulon disa objektiva për tu arritur në sektor si p.sh.;**

- Zhvillimi i një turizmi të qëndrueshëm gjatë gjithë vitit nëpërmjet; forcimit të partneriteteve publike-private; rritjes së cilësisë së shërbimit; marrjen e masave për mbrojtjen e bregdetit dhe mjedisit; rritjen e qetësisë dhe sigurisë; ngritjen e infrastrukturës funksionale; k*onsiderimin e efekteve të ndryshimeve klimatike në investimet e ardhshme*
- Zhvillimi i një turizmi të harmonizuar bregdetar e malor, historik e etno-kulturor
- Krijimi i një imazhi pozitiv nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës fizike dhe të shërbimit; rritjen e nivelit të zbatimit të ligjit, zgjerimin dhe forcimin e rrjetit të operatorëve turistikë, ngritjen e pikave të informacionit turistik, prodhimin e materialeve promovuese dhe rritjen bashkëpunimeve me rajone jashtë vendit (seminare, panaire, programe-binjakëzimi etj.), investime ne teknologjitë e informacionit e komunikimit etj.

Elemente të reja të strategjitë strategjisë kombëtare të Turizmit 2014-2020, të cilat do te duhet të konsiderohen edhe nga Zona Funksionale për hartimin e strategjisë së saj të turizmit janë; integrimi i koncepteve dhe fokusimi tek krijimi i produktit, cilësia e tij dhe strukturat, burimet e mekanizmat e zbatimit dhe treguesit e përdorur kontribut-rezultat që sigurojnë një skeme më të mirë monitorimi.

# 3. Shërbimet vendore në zonën funksionale

Ndër "funksionet e veta" më të rëndësishme në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve utilitare që mbulohen nga NJQV janë:

- furnizimi me ujë të pijshëm; funksionimi i sistemit te kanalizimeve të ujërave të bardha, të ujërave të zeza dhe kanaleve mbrojtëse të zonave të banuara;
- ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve me karakter vendor, trotuareve dhe shesheve publike;
- grumbullimi, largimi dhe përpunimi i mbeturinave;
- hartimi i planeve urbane dhe menaxhimi i tokës

## *3.1 Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve*

### 3.1.1 Prodhimi i mbetjeve në Zonën Funksionale dhe kategoritë e tyre

Sasia totale e mbetjeve e kontraktuar në nivel Zone Funksionale është 12.950 ton në vit ose 0,43 kg për frymë në ditë[57]. Megjithatë duhet të sqarohet se sasia totale e mbetjeve e kontraktuar nuk është e thënë të jetë shumatore e sasive të mbetjeve të prodhuara në çdo njësi. Kjo sepse një pjesë e mbetjeve të prodhuara hidhen ne vende të pakontrolluara ose në rastin më të mirë ripërdoren/kompostohen në burim.

Ka disa lloje mbetjesh që gjenerohen në zonë. Ato mund të jenë mbetje urbane nga familjet, mbetje që gjenerohen nga aktiviteti i bizneseve apo institucioneve, mbetje inerte, mbetje të rrezikshme (industriale, spitalore) etj. Përveç mbetjeve urbane dhe atyre tregtare, aktualisht nuk është e mundur të merren të dhëna të sakta për rryma të tjera mbetjesh.

**Mbetjet urbane** prodhohen kryesisht nga familjet, institucionet publike, tregtare dhe sektorët industriale kryesisht ato të ndërtimit, peshkimit, përpunimit dhe shërbimeve të ndryshme. Njësitë vendore në Lezhë,

[57]Urban Research Institute and Helvetass Sëiss Intercooperation Albania/DLDP, *Support Inter-LGU Cooperation and Organization of Ëaste Management Service in Lezha and Shengjin*, 2013

ashtu si edhe pjesa dërrmuese e njësive vendore ne Shqipëri, nuk kanë statistika të sakta sa i përket prodhimit të mbetjeve urbane. Mbetjet nuk peshohen sepse në vendgrumbullime nuk ka peshore për ta bërë këtë gjë.

**Mbetjet inerte** që gjenerohen nga aktiviteti ndërtues janë ndër mbetjet më voluminoze në rajon. Ato janë më problematike në zonën e bregdetit, sidomos në Shëngjin, aty ku dhe aktiviteti ndërtimor është më intensiv. Sipas raportimit të fundit nga vetë NJQV-të në 2012, sasitë e kësaj kategorie në disa nga bashkitë e rajonit variojnë nga 6 dhe 17% e mesatares së përgjithshme vjetore të mbeturinave të gjeneruara. Vetëm Lezha si bashki gjeneron 8% të mbetjeve inerte në rajon. Niveli mesatar rajonal përfaqëson 11% të mbeturinave të krijuara në vit gjithsej.

**Mbeturinat e rrezikshme** (të tilla si bateri, kimikate etj.) mblidhen dhe largohen bashkë me mbetjet urbane. Nuk ka të dhëna të besueshme për sasinë e mbetjeve të rrezikshme që gjenerohen dhe nivelin e tyre të rrezikshmërisë. Ajo që raportohet lidhet kryesisht me mbetjet e hedhura në të kaluarën si rezultat i aktiviteteve të hershme industriale, duke përfshirë këtu edhe hedhjen e pakontrolluar të mbeturinave të rrezikshme si; mbetjet spitalore, bateritë, dhe kimikatet e papërdorura në vend depozitimet lokale. Megjithëse sipas legjislacionit në fuqi, mbledhja dhe trajtimi i mbetjeve industriale është përgjegjësi e prodhuesit, ai gjen pak vend për zbatim në njësitë e zonës. Studimet e fundit të fizibilitetit të ndërmarra në lidhje me ndërtimin e një vend depozitimi mbetjesh të rrezikshme, tregojnë se këto mbetje përbëjnë rreth 3-4% të mbeturinave industriale janë. Kjo shifër përjashton mbetjet mjekësore dhe elementëve të rrezikshëm në mbetjet e familjeve. Shifra është e krahasueshme me vendet e tjera mesdhetare.

**Mbetjet Spitalore** - Nuk ka të dhëna për sasitë vjetore të mbeturinave që gjenerohen nga institucionet e kujdesit shëndetësor (Qendra Shëndetësore, Ambulanca, Spitale, Maternitet, Qendra kujdesi për fëmijët etj.) në zonën e Lezhës. Megjithëse legjislacioni I lidhur me këtë kategori mbetjesh ekziston, ai pothuaj injorohet nga strukturat e shëndetit dhe nuk nxitet zbatimi I tij. Ministria e Shëndetësisë dhe OBSH kanë bërë përpjekje për të përmirësuar situatën dhe kanë venë në dispozicion pajisje për sterilizimin e mbetjeve të kontaminuara në spitale. Asnjë nga bashkitë nuk ka kapacitete të përshtatshme për përpunimin e mbetjeve spitalore sepse ato janë përgjegjësi e vetë strukturave të shëndetit. Shpeshherë NJQV-të thonë se gjejnë mbetje spitalore në kazanët për mbetjet urbane dhe bashkë këto depozitohen në vende të caktuara. Kjo kategori mbetjesh duhet të menaxhohet me prioritet në zonë.

**Rryma të tjera mbeturinash që vërehen në zonë janë;** automjetet në fund të jetës së tyre, mbetjet nga ambalazhet, Mbetjet nga vajrat e përdorura, Mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike, Mbetjet nga nen produktet shtazore, Mbetjet nga industria e minierave.

**Sasia e mbetjeve tregtare** për bashkinë Lezhë është 8.9 ton në ditë dhe 3230 ton në vit (ose afërsisht sa 54% e mesatares së rajonit), kjo sepse pjesa më e madhe e bizneseve dhe institucioneve është e përqendruar në këtë zonë[58].

Një përllogaritje tjetër e mbetjeve bëhet edhe sipas sasive të kontraktuara për tu eliminuar nga çdo njësi me kompanitë përkatëse. Sipas këtyre kontratave sasitë variojnë nga 1,59 kg/ për banorë në ditë në Shëngjin deri në 0,13 kg/ për banorë në ditë në Balldren. Megjithatë duhet të konsiderohet se prodhimi i mbetjeve për frymë sipas kontratave nuk tregon domosdoshmërisht sasitë e prodhuara respektivisht në çdo njësi.

**Tabela 27 Prodhimi i mbetjeve për banor në një ditë, Zona Funksionale Lezhë**

| | Lezhë | Shëngjin | Balldren | Kallmet | Kolsh | Shënkoll | Zejmen | Ungrej[59] | Blinisht[60] | Dajc |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|

[58] Sipas Draft Planit për Menaxhimin e Mbetjeve në Rajonin Lezhë 2013, hartuar me Asistencën Teknike të BE-së për Forcimin e Kapaciteteve të Ministrisë së Mjedisit për Hartimin dhe Zbatimin e Legjislacionit Kombëtar për Mjedisin

[59] Te dhëna te padisponueshme. Komuna nuk e ofron shërbimin.

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Prodhimi i mbetjeve (kg/banorë/në ditë)** | 0.48[61] | 1.59 | 0.13 | 0.34 | 0 | 0.3 | 0.4 | - | - | - |

*Burimi: Urban Research Institute and Helvetass Sëiss Intercooperation Albania/DLDP, Support Inter-LGU Cooperation and Organization of Ëaste Management Service in Lezha and Shëngjin, 201*

Një vlerësim i strukturës së mbetjeve në Bashki tregohet në tabelën më poshtë;

**Tabela 28 Struktura e mbetjeve ne %, 2012**

| | Të bio degradueshme | | | Të ricikluesshme | | | | | | Të rrezikshme | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Organike | Dru | Produkte shtazore | Letër dhe Karton | Plastikë | Qelq | Tekstile | Metale (hekurore jo) | Ndërtimi | Spitalore dhe Sanitare | Të tjera të rrezikshme (bateri..) |
| **Bashkia Lezhë** | 45.2 | 1.3 | 1.5 | 14 | 15.7 | 6.4 | 5 | 1.3 | 4.9 | 4.6 | 0.1 |
| **Mesatarja e Rajonit** | 46.4 | 1.4 | 1.3 | 13.8 | 14.6 | 6 | 5.1 | 1.2 | 6 | 4 | 0.2 |

*Burimi: Urban Research Institute and Helvetass Sëiss Intercooperation Albania/DLDP, Support Inter-LGU Cooperation and Organization of Ëaste Management Service in Lezha and Shëngjin, 201*

### 3.1.2 Riciklimi/Kompostimi I mbetjeve

Me përjashtim të Bashkisë Lezhë, asnjë nga NJQV-të në zonë nuk e ndajnë ose e mbledhin veçmas pjesën e mbetjeve që mund të riciklohet. Edhe pse industritë e riciklimit në zonë mungojnë, një kategori personash, sidomos Romë, bëjnë mbledhjen e mbetjeve të ricikluesshme në kazanët publikë. Bashkia Lezhë në bashkëpunim me kompani riciklimi qe ndodhen jashtë rajonit, e ka organizuar mbledhjen e letrës dhe plastikës dhe transferimin e tyre në Qendrën e Ndarjes së Mbetjeve të Ricikluesshme brenda njësisë vendore ku mbetjet përgatiten për tregun e riciklimit.

Bashkia e Lezhës, e bën ndarjen e mbetjeve urbane në burim në dy nivele. Sistemi përbëhet nga dy lloje kazanësh: ato për mbledhjen e mbetjeve të ricikluesshme (50 kazanë me kapacitet 3,3 m³ ) dhe ato për mbledhjen e mbetjeve organike(260 kazanë me kapacitetit 1,1 m³). Mbeturinat grumbullohen veçmas. Pjesa e ricikluesshme transportohet në Qendrën e Ndarjes së Mbetjeve të Ricikluesshme mbi bazën e një kontrate shërbimi me një operator dhe më tej ndahet në letër / karton dhe plastike të cilat përgatiten për tregun e riciklimit. Mbeturinat organike mblidhen dhe transportohen drejt landfill-it në Bushat.

Projekti pilot për mbledhjen në mënyrë të diferencuar të mbeturinave në Bashkinë Lezhë po zbatohet në lagjen Besëlidhja dhe një pjesë të lagjes Gurra dhe Skënderbeg të qytetit, dhe është i përqendruar në 27 pika grumbullimi me sistem mbitokësor dhe 3 pika grumbullimi me sistem nëntokësor. 39 % e familjeve të Bashkisë aktualisht i ndajnë mbetjet në burim dhe përfitojnë largimin e diferencuar të mbetjeve. **Qendra e rindarjes së mbetjeve të ricikluesshme** bën presimin e tyre për t'ia shitur kompanive ricikluese. Në 2010 mbetje të ricikluesshme të gjeneruara përbënin 3,238 ton ose 37% të totalit të mbetjeve prej 8,528, nga të

[60] Të konfirmohet me komunën ose nga kontrata...
[61] Sipas Strategjisë Lezhë kjo është 0,86kg

cilat letër/karton 1,225 ton, plastike 1,341 ton, qelq 562 ton, metal ferroz 58 ton dhe metal joferroz 52 ton. Rreth 64% e mbetjeve bashkiake përbehet nga material i biodegradueshëm (lëndë organike, drusore, letër dhe karton). Rryma e materialeve të ricikluesshme (letër, karton, qelq, tekstil, plastikë, dru, inerte, metal) përbën 48% të totalit të mbetjeve.

Njësitë e tjera aktualisht nuk bëjnë riciklim apo kompostim mbetjesh. Gjithsesi duhet përmendur se Dajci dhe Blinishti, nën iniciativën e Nder-Komunales Zadrima kanë filluar fushata promovuese dhe sensibilizuese ne lidhje me aktivitete të riciklimit. Shënkolli nga ana tjetër është një që ka potencial infrastrukturor të përshtatshëm për të bërë riciklim dhe kompostim mbetjesh.

Sipas Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të mbetjeve 25% e sasisë së mbeturinave të grumbulluara në njësitë e qeverisjes vendore duhet të riciklohen ose kompostohen deri në 2015, ndërsa deri në vitin 2020 kjo normë duhet të arrijë 50%.

### 3.1.3 Vend-depozitimet dhe zona aktiviteti me potencial të lartë gjenerimi mbetjesh

Pasi mbetjet grumbullohet ato transportohen për asgjësim në një nga vend-grumbullimet në rajon. Në zonat rurale, të cilat nuk e ofrojnë shërbimin e grumbullimit të mbeturinave, ato hidhen në kanale, lugina apo thjesht lihen në anë të rrugëve ose në shtretër të lumenjve. I gjithë rajoni I Lezhës disponon 5 vendgrumbullime dhe një landfill. Të tilla janë;

- **Vendgrumbullimi i Berzanit** ne fshatin Berzanë të komunës Zejmen, në pjerrësinë e një kodre pranë deltës së lumit Mat. Ai është ndërtuar jashtë parametrave teknikë dhe aktualisht është pothuajse jo-operativ
- **Vend-depozitimi Cekaj**I vendosur në Rubik me një sipërfaqe prej 2500m2, kapacitet 60.000 m3 dhe një jetëgjatësi operative deri ne 2018, nuk është më operativ mgjth ai vazhdon të shkaktojë probleme mjedisore.
- **Landfilli Cekaj***(pranë vend-depozitimit Cekaj, 6 km nga Rrësheni)*ka të njëjtën madhësi si vendgrumbullimi Cekaj por parametra teknikë më të mirë dhe karakteristika moderne. Është planifikuar të jetë operativ deri ne 2018. Ai është ndërtuar, administrohet dhe përdoret nga bashkitë Rrëshen dhe Rubik dhe financohet nga bashkia Rrëshen me një fond special për ta operuar.
- **Vend-depozitimi Laçit** - 2 km nga Qyteti Laç, përdoret nga Bashkia për depozitimin e mbeturinave. Është ndërtuar në vitin 2007, por pa marrë parasysh standardet e zakonshme për ngritjen e strukturave të tilla. Ka një sipërfaqe prej rreth 10.000 m² me kapacitet prej 200,000 ton (ose 300.000 m3). Është parashikuar një aktivitet prej 6-7 vjet dhe tashmë mbeten edhe 2 vjet para se ai të mbushet plotësisht. Duke qenë se mbetjet nuk kompresohen/ngjeshen, mendohet që koha e mbetur e shfrytëzimit të jetë edhe më e shkurtër. Vendgrumbullimi në Mamurras dhe Landfilli I Bushatit.
- **Vendgrumbullimi në Mamurras** - Bashkia ka dhënë me qira për 30.000 lekë në muaj, një parcelë që gjendet rreth 7,5 km në veri-lindje të qytetit. Ajo është transformuar në venddepozitim në vitin 2010. Vendi ka një sipërfaqe prej rreth 3000 m² me një kapacitet prej 40.000 ton dhe nga periudha e vlerësuar për shfrytëzim mbeten edhe 2 vite
- **Landfilli I Bushatit**, I vendosur në një distancë prej 25 km në veri të qytetit të Lezhës

Të gjitha njësitë që ofrojnë shërbim të organizuar të menaxhimit të mbetjeve në Zonën Funksionale Lezhë, e kanë të specifikuar në kontratë me kompanitë private se destinacioni final i mbetjeve është landfill-i i Bushatit.

Ai vendosur në një distancë prej 25 km në veri të qytetit të Lezhës, është financuar nga buxheti I shtetit me qëllimin për t'i shërbyer dy rajoneve të Shkodrës dhe Lezhës. Kapaciteti I tij është 1,000,000 m3 dhe jetëgjatësia e parashikuar është 20 vite. Tarifa e depozitimit është 7 euro për ton ndërkohë qe njësitë duhet të përballojnë dhe kostot e transportit deri ne landfill.

**Tabela 29 Distanca nga landfill Bushat**

| Njësia | Lezhë | Shëngjin | Shënkoll | Kallmet | Balldre | Kolsh | Zejmen | Blinisht | Dajc | Ungrej |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Distanca nga Bushati ne km** | 25 km | 26 - 28 km | 35 km | 15-20 km | 15 - 20 km | 28 km | 25-30 km | Mungon e dhëna | Mungon e dhëna | Nuk e ofron |
| **Distanca nga Bushati ne ore** | 45-60 minuta | 108 minuta | | 2 ore[62] | 30 - 45 minuta | | | | | Nuk e ofron |

*Burimi: Urban Research Institute and Helvetass Sëiss Intercooperation Albania/DLDP, Support Inter-LGU Cooperation and Organization of Ëaste Management Service in Lezha and Shëngjin, 201*

Sa i përket **vendshkarkimeve të pakontrolluara të mbetjeve** një i tillë është **në Berzane** në territorin e komunës Zejmen. Vendi ka shërbyer si një depozitë formale për mbeturinat e të gjitha njësive të tjera të zonës. Edhe pse nuk është më  në përdorim , vendi mbetet një pikë e pakontrolluar dhe deri tani, nuk ka asnjë plan, as në nivel njësie  për të siguruar fonde për mbylljen përfundimtare të vendit

**Probleme mjedisore janë identifikuar ne komunën e Shëngjinit.** Ato shkaktohen kryesisht nga ndotjet e industrisë se lehte; mbetjet e ngurta urbane; gjendja e rrjetit te ujit te pijshëm; kanalizimet e ujërave te zeza; mungesa e gjelbërimit ne qytet dhe shpyllëzimet; erozioni, përmbytjet, etj. **Mbetjet e ngurta urbane në Shëngjin** nuk administrohen mbi bazën e kritereve mjedisore. Deri me sot nuk ka asnjë vend depozitimi te mbetjeve urbane te ndërtuar mbi bazën e kritereve mjedisore. Gjate muajve te verës, kur numri i banoreve te qytetit te Shëngjinit pesëfishohet nga turistet, mbetjet urbane te ngurta për ne dite. Pika e hedhjes se mbetjeve është 9 km larg nga Shëngjini dhe është ne kushte mjedisore dhe sanitare tepër te papërshtatshme. Një pjese e mbetjeve urbane, përfshi Shëngjinin arrijnë 2 ton ato inerte, nga ndërtimet e prishjet, hidhen përgjatë lumit Drin ose ne Liqenin e Kenalles.

**Nuk ka vende të caktuar dhe me infrastrukturën e duhur për mbledhjen e mbetjeve nga ndërtimi dhe shembja, kurse eliminimi I tyre bëhet sipas nevojës dhe jo mbi bazën e një planifikimi**. Për pasojë **kjo kategori mbetjesh raportohet nga bashkitë si shumë problematike në aspektin e kostove të mbledhjes dhe transportit.** Mungesa e vendeve dhe kazanëve të përshtatshëm për këtë lloj kategorie mbetjesh  I nxit individët dhe bizneset ti depozitojnë at pranë vendeve të mbetjeve urbane. Për më tepër gjenden shpesh edhe grumbuj mbetjesh inerte në anët e rrugëve kryesore kombëtare. **Asnjë nga NjQV-të e Zonës nuk i trajton në mënyrë sistematike mbetjet inerte.** Megjithatë, herë pas here ato janë përdorur për mbushje të gropave ose hapësirave në nivele të ndryshme. Bashkia  Lezhë ka caktuar një pikë grumbullimi për asgjësimin e këtyre lloj mbetjesh pranë shkollës "Nënë Tereza", e cila është një zonë që më parë ka qenë moçal ndërsa tani është e mbushur me mbetje. E njëjta procedurë ndiqet edhe nga NJQV-ve të tjera. Megjithatë, ka raste kur këto mbeturina hidhen direkt në lumenj nga kompanitë e ndërtimit.

**Në vendgrumbullime ndizen shpesh zjarre për të zvogëluar vëllimet e mbetjeve.** Ndodh shpesh që mbetjet të ndizen për shkak të mungesës së procedurave të duhura për heqjen e tyre.  Këto zjarre përbëjnë një burim të rëndësishëm të ndotjes së ajrit  duke qenë se çlirojnë sasi të mëdha toksinash.

Zhvillim i shpejtë i turizmit në bregdet kohët e fundit shkakton probleme edhe më madhore gjatë sezonit turistik lidhur me menaxhimin e mbetjeve dhe vështirësi për njësitë për t'i adresuar siç duhet.

**Mbetjet nga nen produktet shtazore në zonë shkaktojnë problem mjedisore gjithashtu** (Aktualisht  kjo kategori përfundon në të njëjtin vendgrumbullim me kategori të tjera. Ka tre industri kryesore përpunimi ushqimesh që kontribuojnë në gjenerimin e këtyre mbetjeve; kompania EuroFish, thertorja e qytetit dhe fabrika e pastrimit të të brendshmeve të bagëtive. Njësitë vendore nuk raportojnë të dhëna mbi sasinë e mbetjeve industriale të gjeneruara nga këto industri, megjithatë dihet se ato I shkarkojnë mbetjet e lëngshme në lumin Drin dhe të ngurtat në kazanët e mbetjeve urbane.

[62] Përfshirë këtu udhëtimin vajtje-ardhje dhe kohen e shkarkimit në landfill

Problematike mbetet dhe derdhja e mbetjeve vajore nga serviset e automjeteve në kanalizimet e ujërave të zeza apo kanale dhe gropa te hapura.

### 3.1.4 Përshkrimi i situatës aktuale të ofrimit të shërbimit

Shërbimi i organizuar i menaxhimit të mbetjeve ofrohet në pjesën më të madhe të njësive që përbëjnë Zonën Funksionale Lezhë. Nga 10 njësi, shërbimi ofrohet në 8 prej tyre përkatësisht në Bashkinë Lezhë dhe njësitë Shëngjin, Shënkoll, Balldre, Kallmet, Zejmen, Blinisht dhe Dajc. Njësitë Ungrej dhe Kolsh nuk e ofrojnë këtë shërbim publik. Sidoqoftë Kolshi organizon herë pas here grumbullim dhe pastrim ne pikat e hapura informale të mbetjeve të shpërndara në territor.

Shërbimet e menaxhimit të mbeturinave në shumicën e njësive në zonë përfshijnë; grumbullim të mbetjeve në kazanët ku ato janë depozituar nga familjet bizneset dhe institucionet; evadim/largim i tyre nga kazanët me mjetet përkatëse; dhe transport drejt landfillit apo vend-grumbullimeve të tjera në zonë. Lezha dhe Shëngjini ofrojnë edhe shërbim fshirje/pastrimi të rrugëve/trotuareve/shesheve publike për zonat e tyre urbane. Bashkia Lezhë, si njësia me paketën më të plotë të shërbimeve, ofron më tej dhe mbledhje të diferencuar mbetjesh.

Të gjitha njësitë vendore që e ofrojnë këtë shërbim, bëjnë mbledhjen dhe transportin e mbetjeve në një rrymë të vetme. Nuk ka kazanë të veçantë për ndarjen në burim të mbetjeve (organike, të ricikluesshme, etj.) apo kazanë për grumbullimin e mbeturinave sipas përbërjes së tyre. (me përjashtim të Bashkisë Lezhë e cila ka filluar disa nisma diferencimi mbetjesh

**Tabela 30** ***Mbulimi i popullsisë me shërbime të menaxhimit të mbetjeve***

| Njësia | Lezhë | Shëngjin | Shënkoll | Kallmet | Balldre | Kolsh | Zejmen | Blinisht | Dajc | Ungrej |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Mbulimi i territorit** | 80% | 85% | 70% | 70% | 70% | 50%[63] | 70% | Mungon e dhëna | Mungon e dhëna | Nuk e ofron |
| **Mbulimi i popullsisë** | 85% | | 70% | 30% | 39% | | 70% | Mungon e dhëna | Mungon e dhëna | Nuk e ofron |

Frekuenca e ofrimit të shërbimit varion sipas njësive, zonës brenda njësisë (qendër apo periferi) dhe gjithashtu edhe sipas sezonit të vitit. P.sh. në Lezhe dhe Shëngjin mund të ofrohet shërbim edhe 2 herë brenda ditës gjatë sezonit të verës kur popullsia e njësive rritet në mënyrë të konsiderueshme. Tabela më pulisht paraqet situatën në çdo njësi.

**Tabela 31** ***Frekuenca e ofrimit të ofrimit të menaxhimit të mbetjeve në Zonë***

| Njësia | Lezhë | Shëngjin | Shënkoll | Kallmet | Balldre | Kolsh | Zejmen | Blinisht | Dajc | Ungrej |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Frekuenca | Çdo ditë **Në verë** – 2 herë në ditë | **Qyteti** - Çdo ditë **Fshatrat** -1 herë në javë | 1-2 herë në javë | 2 herë në javë | 2 herë në javë | 1 herë në 2 ose 4 muaj | 2-3 herë në javë | Mungon e dhëna | Mungon e dhëna | Nuk e ofron<br>Nuk e ofron |

[63] Këtu është llogaritur shërbimi jo formal që ofron vetë komuna lidhur me mbledhjen e mbetjeve nga vendet e hapura në territor ku ato hidhen

Në njësitë e zonës, bëhen supervizime periodike  në terren për të parë nëse kompania private po ofron shërbimin brenda parametrave të duhur të kompani. P.sh. Bashkia Lezhë bën supervizim të përditshëm dhe raporton një situacion ne fund të çdo muaji.

### 3.1.5 Bashkëpunime ndërvendore për ofrimin e shërbimit dhe tipi I marrëveshjeve

Bashkëpunimi ndërvendor perceptohet nga njësitë si një mundësi për rritjen e eficencës së kostove. Megjithatë suksesi i iniciativave të tilla varet nga vullneti i njësisë për zbatimi, nga tipologjia e saj, aplikimi i standardeve të ofrimit të shërbimit etj.

**Bashkëpunimi ndërvendor** ka nevojë për një vlerësim të thelluar  paraprak të aspekteve ligjore dhe teknike në mënyrë që interesat e NJQV-ve dhe kompanive private të përputhen për qëllime të përbashkëta siç janë ofrimi i standardeve të përshtatshme  të dhe nxitja e grumbullimit të diferencuar për të siguruar uljen e kostove të grumbullimit, evadimit dhe transportit në landfill të mbeturinave.

**Ndërkomunalja Zadrima**: Ka një bashkëpunim të strukturuar ndër-komunal për menaxhimin e mbetjeve midis komunave Bushat, Blinisht, Hajmel, Dajç dhe Vaut të Dejës. Ky është një nga pak shembujt e suksesshëm në nivel kombëtar sa i përket ofrimit të përbashkët të shërbimeve publike. Përveç shërbimeve standardes të pastrimit (mbledhje, transport, depozitim), vazhdimisht organizohen edhe fushata ndërgjegjësimi publikut në lidhje me mjedisin.  Ekziston një njësi ekonomike e cila menaxhon shërbimin me fondet e akorduara për shoqatën nga secila prej NjQV-ve anëtare. Gjithashtu ka një zyrë mjedisi dhe grupe amatorësh themeluar për të punuar intensivisht me popullsinë mbi çështjet e menaxhimit të mbeturina

**Balldreni:**  Nuk ka patur iniciativa bashkëpunimi ndërvendor deri më tani. Sidoqoftë, njësia ka vullnet politik për të patur projekte me njësitë kufizuese në të ardhmen si p.sh. grumbullim dhe transport I përbashkët, ndarje e pajisjeve të transportit, kontraktimi i tyre tek të tretë dhe themelimi i një bordi  të përbashkët. Aktualisht kapacitetet e njësisë janë të pamjaftueshme dhe ka nevojë për asistencë teknike dhe financiare. **Bashkëpunimi ndërvendor konsiderohet si alternativë sidomos me Kallmetin, Lezhën dhe Bushatin në Shkodër**.

**Kallmeti:** Deri më tani njësia nuk ka patur eksperienca të bashkëpunimit ndërvendor në fushën e mbetjeve. Gjithsesi ajo  shpreh vullnet për të bashkëpunuar me njësitë e tjera fqinje për mbledhjen, grumbullimin dhe transportin e përbashkët, përdorimin e përbashkët te pajisjeve që nevojiten për këto shërbime  ose kontraktimin i tyre nga tretë. **Një iniciativë fillestare është diskutuar  me drejtuesit e njësisë  së Balldrenit në kufi e Kallmetin**. Të dy palët mendojnë se një përpjekje e përbashkët në këtë fushë mund të ulë kostot dhe të rezultojë me e përballueshme për kapacitetet aktuale që kanë njësitë.  Sidoqoftë është I nevojshëm një studim fizibiliteti për të vendosur. Njësia ka nevojë për asistencë lidhur me aspektet financiare dhe teknike të studimit të fizibilitetit dhe skemës së organizimit për ofrimin e përbashkët të këtij shërbimi.

**Kolshi:** Deri më sot Kolshi nuk ka qenë pjesë e ndonjë plani për bashkëpunim ndërvendor. Megjithatë, njësia ka **përvoja informale bashkëpunimi ndërvendor me njësitë fqinje në fushën e ndërtimit dhe menaxhimit të sistemit të ujitjes dhe kullimit të tokës së punueshme**. Kolshi ka nevoje urgjente për organizimin e mbledhjes së mbeturinave që mund te fillojë në qendër e të shtrihet më tej në territor . **Ka një plan të kryetarit të njësisë për të siguruar shërbimin e menaxhimit të mbetjeve për fshatrat kufitarë nëpërmjet kompanive që operojnë në Lezhe dhe Shënkoll. Përveç Lezhës njësia është e gatshme të eksplorojë mundësitë për bashkëpunim edhe me njësitë Zejmen e Shënkoll për menaxhimin e përbashkët të mbledhjes së mbeturinave.** Ky bashkëpunim është sidomos i rëndësishëm për të përballuar edhe kostot e transportit të cilat parashikohen të jenë shumë të larta deri në Bushat.

**Bashkia Lezhë:** Deri tani**, Bashkia nuk e ka parë bashkëpunimin ndërvendor si një mundësi për përmirësimin e efikasitetit të kostos së shërbimit**. Megjithatë, **zyrtarët e bashkisë bien dakord se mbledhja**

**e përbashkët e mbeturinave midis Lezhës dhe Shëngjinit dhe shtrirja e grumbullimit të mbeturinave të ricikluesshme edhe në Shëngjinit** do të përfaqësonin hapa konkretë në drejtim të forcimit të bashkëpunimit ndërvendor dhe uljes së shpenzimeve operative për grumbullimin dhe transportimin. Sidoqoftë ka nevojë për të bërë paraprakisht vlerësimet e duhura teknike dhe financiare lidhur me këtë bashkëpunim potencial.

**Shëngjin:** Njësia është e gatshme të bashkëpunojë me njësi të tjera me qëllim organizimin e përbashkët të shërbimit dhe ngritjen/menaxhimin e stacioneve të ndërmjetme të mbledhjes së mbetjeve masa të cilat do të ulnin koston e transportit dhe trajtimit në landfill. **Ofrimi i shërbimit të përbashkët mund të jetë edhe më i lehtë meqenëse e njëjta kompani private ofron shërbim në Zejmen dhe në Lezhë**. Ideja e bashkëpunimit me bashkinë Lezhë ka lindur së fundmi dhe ka nevojë për analiza të mëtejshme teknike dhe financiare për të parë mundësinë e realizimit konkret.

**Shënkoll:** Për të reduktuar kostot e transportit zyrtarët e njësisë mendojnë se **ndërtimi i pikave të transferimit** si pjesë e një aktiviteti të bashkëpunimit ndërvendor do të kishte kuptim dhe do të reduktonte dukshëm shpenzimet e transportit. Janë të gatshëm për të diskutuar përpjekje për zbatimin e një projekti të mundshëm ndërvendor. Kjo do të kërkonte një palë të tretë për të moderuar procesin duke e bërë vendim bazuar në një studim fizibiliteti të projektuar mirë dhe të detajuar të fizibilitetit Zyrtarët mendojnë se bashkëpunimi ndër-NJQV-ja do të inkurajohej edhe më shumë nëse zgjidhet çështja e kufijve të komunës. **Përvojat pozitive bashkëpunimi të mëparshëm lidhen me një projekt rehabilitimi rrugësh me komunën Zejmen ku të dy komunat kanë financuar bashkërisht përpilimin e projektit dhe përgatitjen**.

**Zejmen: Përvojat pozitive bashkëpunimi të mëparshëm lidhen me një projekt rehabilitimi rrugësh me komunën Shenkol**l ku kanë financuar bashkërisht nga të dy komunat dizajni i projektit dhe përgatitja.

### 3.1.6 Si ofrohet shërbimi dhe rrjeti infrastrukturor i shërbimit disponueshëm në Zonë

Rrjeti i pikave të grumbullimit të mbeturinave në të gjithë zonën vendoset nga secila prej NJQVve me qëllim mbulimin e zonës së kompetencës së tyre me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve. Sistemi aktual i pikave të grumbullimit të mbeturinave në të gjitha njësitë e zonës së Lezhës është i standardizuar dhe përbëhet nga kazanë me rrota metalike, përgjithësisht me një kapacitet prej 1100 litra. Kazanët përdoren si për familjet ashtu dhe për bizneset private.

Nga 1 deri në 3 kazanë mbetjesh janë të vendosura zakonisht në rrugët kryesore të qyteteve, por jo domosdoshmërisht në bazë të standardeve të tilla si: distanca mes të pikave të grumbullimit ose densitetit të banimit. Kazanët në disa raste janë pronë e NJQV-ve, dhe në raste të tjera e kompanisë private që ofron shërbimet. Kostoja e mirëmbajtjes së kazanëve herë pas here përfshihet në kontratat e kompanive të pastrimit ndërsa në raste të tjera NJQV-të sigurojnë fonde të veçanta gjatë vitit. Përveç këtyre kazanëve, NJQV vendosin kazanë më të vegjël (rreth 30 litra) përgjatë rrugëve kryesore për hedhjen e mbetjeve ditore nga kalimtarët.

Për grumbullimin e mbetjeve përdoren mjete të tonazheve të ndryshme. Këto i përkasin ofruesit të shërbimeve. Përveç automjeteve për grumbullimin e mbeturinave, përdoren dhe kamionë me vinça për largimin e mbetjeve kryesisht në zonat sub-urbane dhe rurale, ku mungojnë kazanët standard. NJQV-të në Lezhë raportojnë gjendje të dobët të automjeteve, pamjaftueshmërinë e tyre dhe mungesën e investimeve për mirëmbajtjen e tyre. Kazanët e mbeturinave zbrazen zakonisht çdo ditë nga ofruesit e shërbimeve. Sipas kontratave të ata ngarkohen gjithashtu te dezinfektojnë pikat e grumbullimit dhe të pastrojnë vendin rreth kazanëve. Megjithatë, sipas asaj që raportohet nga njësitë e qeverisjes vendore, këto të fundit janë procese që kryhen rrallë.

Në nivel Rajoni ka 467 kazanë me kapacitet 1.1m$^3$ dhe 50 kazanë me kapacitet 3.3 m$^3$ nga të cilët 29% ose 152 kazanë janë në gjendje të dobët fizike. Zakonisht kazanët janë të dëmtuar për shkak të zjarreve që ndizen në to.

**Situata ne çdo njësi:**

**Bashkia Lezhë** ka 50 kazanë të kapacitetit 3.3 m$^3$ (5% të tyre të dëmtuara)dhe 161 të kapacitetit 1.1 m$^3$ (23% të dëmtuara). Bashkia disponon 3 kamionë që mbledhin mbetjet. Pjesa organike mblidhet çdo ditë ndërsa mbetjet e ricikluesshme 3 herë në javë. Nga në vlerësim që është bërë (refero ËMP Lezha…)[64] Bashkia Lezhë disponon numrin e duhur të kazanëve në raport me prodhimin e mbetjeve

**Balldre:** Nuk ka mjete në dispozicion për të ofruar këtë shërbim. Ato janë pronë e kompanisë private dhe përfshijnë një numër të kufizuar kazanësh me vëllim 1.1 m$^3$. Kompania e kontraktuar ka 100 kazanë, me një kapacitet prej 1,1 m3. Ato janë të vendosur në 70 pika e grumbullimi të vendosura kryesisht pranë banesave sesa sipas planit të menaxhimit të shërbimit. Në rastin kur organizohen aktivitete grumbullimi në vendet e pakontrolluara të hedhjes së mbeturinave, njësia u merr me qira operatorëve privatë pajisje ngarkimi/transportimi.

**Kallmet:** Mjetet që disponohen nga kompania janë 45 kazanë plastikë me vëllim 1,1m$^3$ të shpërndara në 45 pika mbledhjeje zakonisht nëpër kryqëzime apo grupime banesash duke mbuluar 70% të territorit. Ka patur një plan për rritjen e nr. të kazanëve deri në 50 në 2013 dhe aprovimin e një plani të ri shpërndarjeje të tyre. Njësia nuk ka në pronësi të saj pajisje pastrimi por kur organizohen aktivitete grumbullimi në vendet e pakontrolluara të hedhjes së mbeturinave, njësia u merr me qira operatorëve privatë pajisje ngarkimi/transportimi.

**Kolsh:** Njësia ka patur në plan blerjen e 64 kazanëve në 2013 të cilat do të vendosen në 32 pika mbledhjeje në territor sipas një plani tashmë të hartuar.

**Shëngjin:** Njësia vetë nuk disponon pajisje për mbledhjen dhe transportin e mbetjeve. Ato janë në pronësi të kompanisë private. Megjithatë kur organizohen aktivitete grumbullimi në vendet e pakontrolluara të hedhjes së mbeturinave (në zona rurale apo bregdet), njësia u merr me qira operatorëve privatë pajisje ngarkimi/transportimi. Njësia ka 100 kazanë nga të cilët 60 janë me kapacitet standard 1,1 m3 dhe 40 me kapacitet 0,5 m3. Ato janë të shpërndarë në 40 pika sidomos në qytet, përgjatë rrugës nacionale dhe qendrës Ishull Shëngjin dhe Ishull Lezhë. Gjendja e tyre fizike është shumë e dobët.

**Shënkoll:** Kompania disponon 350 kontejnerë metalike nga të cilat 250 me kapacitet 1,7 m3 dhe 100 me kapacitet 1,1 m3. Kontejnerët janë shpërndarë në 250 pika grumbullimi, të vendosura kryesisht afër grupeve të banesave në shumicën e fshatrave të komunës. Komuna nuk disponon ndonjë pajisje dhe mbledhja e mbeturinave bëhet vetëm me pajisjet në pronësi të kontraktuesit. Kompania përdor një kamion (kompaktor) të dorës së dytë prej 8 tonësh dhe një kamion tjetër 6 tonësh për deponim. Kur vetë njësia organizon aktivitete grumbullimi në vendet e pakontrolluara të hedhjes së mbeturinave, ajo u merr me qira operatorëve privatë pajisje ngarkimi/transportimi

**Zejmen:** Komuna disponon një ekskavator të vjetër të vogël i cili përdoret shpesh për pastrimin dhe grumbullimin e mbeturinave të depozituara në mënyrë informale në vende të hapura. Shërbimi kryhet nga një kamion ngjeshës me kapacitet 9 ton I cili është në pronësi të kompanisë dhe operohet nga ai. Kur vetë njësia organizon aktivitete grumbullimi në vendet e pakontrolluara të hedhjes së mbeturinave, ajo u merr me qira operatorëve privatë pajisje ngarkimi/transportimi

[64] Kazanë me kapacitet 1.1 m$^3$ = 124 kg ; koeficienti i mbushjes =75%; frekuenca e mbledhjes: 7 ditë/javë

### 3.1.7 Kontratat e Shërbimit me Kompanitë Private

Shërbimi I menaxhimit të mbeturinave ofrohet kryesisht brenda kufijve të njësive vendore. Shumica e tyre kanë kontraktuar kompani private për të siguruar shërbimin e pastrimit. Të tilla janë Lezha, Shëngjini, Kallmeti, Shënkolli, Zejmeni dhe Balldreni. Komunat Blinisht dhe Dajc e ofrojnë këtë shërbim në bashkëpunim me 3 komuna të tjera në Shkodër (Bushat, Hajmel dhe Vau I Dejës) dhe e menaxhojnë bashkërisht. Komuna Kolsh organizon vetë grumbullim të mbetjeve nga vendet e hapura informale të shpërndara nëpër territor. Komuna Ungrej nuk e ofron fare shërbimin e pastrimit.

**Tabela 32 Kontraktorët e shërbimit të pastrimit**

| Bashkia/Komuna | Shërbimet që ofrohen | Ofruesi i Shërbimit | Kompania e kontraktuar | Afatet e kontratës | Detaje të kontratës | Shuma e kontratës | Financimi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Lezhë** | Mbledhje mbetjesh në 2 rryma/transport dhe asgjësim në landfill dhe transport I pjesës së ricikluesshme | Operator Privat | "Iridiani & Kadeli shpk" | 2010-2016 | Kontratë 6-vjecare Nen I veçantë për ndarjen e mbetjeve në 2 rryma | 29 milion lekë në vit | Nga të ardhurat e bashkisë |
| **Shëngjin** | Mbledhje, Evadim dhetransport në landfill (Bushat) dhe pastrimin e qytetit | Operator Privat | " "Iridiani & Kadeli shpk" | | | | |
| **Shënkoll** | Mbledhje, Evadim dhetransport në landfill (Bushat | Operator Privat | V.A.L.E Recycling sh.p.k | 2014-2017 | | 4,67 milion pa TVSh | Me fonde të komunës |
| **Kallmet** | Mbledhje, Evadim dhetransport në landfill (Bushat | Operator Privat | V.A.L.E Recycling sh.p.k | | | | |
| **Zejmen** | Mbledhje, Evadim dhe transport në landfill (Bushat | Operator Privat | "Iridiani & Kadeli shpk" | 2014-2017 | | 1.6 milion leke në vit )pa TVSH) | Me të ardhura të komunës |
| **Ungrej** | Nuk e ofron | | - | - | - | - | |
| **Dajc** | Shërbim I bashkëofruar dhe menaxhuar nga një marrëveshje ndërvendore (5 njësi) | Komuna | Ndërkomunalja Zadrima | | | | Me fonde të komunës |
| **Blinisht** | Shërbim I bashkëofruar dhe menaxhuar nga një marrëveshje ndërvendore (5 njësi) | Komuna | Ndërkomunalja Zadrima | | | 500,000[65] | Me fonde të komunës |
| **Balldre** | Mbledhje dhetransport në landfill | Operator privat | | | | 2,2 milion Lekë | |
| **Kolsh** | Mbledhje nga vendet e hapura të hedhjes së mbetjeve (nuk dihet | Komuna | - | - | - | - | |

[65]Shuma e alokuar ne buxhet për ndërkomunalen, viti 2014

| | |
|---|---|
| | destinacioni i fundit i mbetjeve) |

Kohëzgjatja e kontratave varion nga 3 deri në 5 vjet, me të drejtë rishikimi të çmimit një herë në vit nga ana e njësive sipas sasive të rishikuara të mbeturinave.

Shqyrtimi i kontratave të pastrimit tregon se pjesën më të madhe të shumës totale e zë shërbimi i grumbullimit, evadimit dhe depozitimit të mbetjeve në Bushat. P.sh. në rastin e Kallmetit, Balldrenit, Shënkollit dhe Zejmenit ajo zë 75%[66]të vlerës totale kurse në Lezhë dhe Shëngjin ky shërbim është sa 45% e çmimit të kontratës.

**Kosto për njës**i varion sipas frekuencës së grumbullimit të mbetjeve. Kostoja mesatare për njësi në të gjithë zonën është 3.3990 Leke[67] për ton mbetjesh të mbledhura dhe evaduara. Bashkia Lezhë ka kosto më të lartë për njësi meqenëse dhe frekuenca e shërbimit është më i lartë (7 herë në javë). Edhe zonat urbane të Shëngjinit kanë të njëjtën frekuencë ndërsa të gjitha njësitë e tjera i mbledhinmbetjet më rrallë.

### 3.1.8 Financimi i shërbimit dhe Sistemi i Tarifimit

Ka norma të ndryshme tarifore[68] për kategori të ndryshme të përfituesve të shërbimit që mund të jenë familje, biznese apo institucione. Këto tarifa caktohen nga vetë njësitë dhe miratohen çdo vit nga këshilla bashkiakë/komunalë, bashkë me taksa dhe tarifa te tjera lokale. Nuk është ndërmarrë akoma asnjë studim për të caktuar tarifat e përshtatshme për klientët sipas mbetjeve që ato gjenerojnë apo sipas shërbimeve që ofrohen. Deri më tani tarifat janë caktuar duke ju referuar viteve të mëparshme. Te gjitha njësitë e zonës kanë tarifë fikse vjetore pastrimi për familje. Kjo tarifë fikse nuk reflekton as madhësinë e familjes, as mbetjet e gjeneruara nga ajo dhe as llojin e shërbimeve të ofruara si p.sh. mbledhje, transport, riciklim, trajtim etj. E rëndësishme për tu përmendur është se tarifat e pastrimit për familjarët ka vite që nuk ndryshojnë dhe ato mbeten shumë më të ulëta për të mbuluar shpenzimet e kryera për shërbimet e ofruara. Ndërkohë NJQV-të rrisin herë pas here tarifat për bizneset dhe caktojnë norma shumë më të larta për bizneset e mëdha duke u munduar të rikuperojnë në këtë mënyrë kostot e pambuluar. Bizneset tarifohen sipas madhësisë së tyre (I madh/ I vogël) dhe sektorit ku operojnë

**Balldre**: Njësia përdor një sistem të diferencuar tarifimi. Familjet tarifohen me 1000 leke/në vit, bizneset e vogla me 3000 Leke/ në vit dhe bizneset e mëdha me 10.000 Lekë në vit. Në 2013 plani I të ardhurave është 2,8 milionë, duke përfshirë mbledhjen e mbetjeve, furnizimin me ujë dhe gjelbërimin. Megjithatë janë mbledhur vetëm 21 % e të ardhurave të planifikuara. Njësia parashikon në buxhet një shumë sa çmimi I kontratës. Të ardhurat nga tarifat mbulojnë vetëm 24% të çmimit të kontratës ndërsa pjesa tjetër subvencionohet nga buxheti I njësisë. Pjesa që zë kostoja e kontratës së menaxhimit në buxhetin vjetor të njësisë është 5 % (ose 46.554.000 Leke në vitin 2012)

**Kallmet:** Tarifa për familjet është 800 lekë në vit për bizneset sa 10% e taksës mbi xhiron dhe për bizneset e mëdha 10,000 Lekë në vit. Shkalla e mbledhjes së tarifës për 2012 ishte në 30% të të ardhurave të planifikuara nga njësia. Buxheti i alokuar nga njësia për shërbimin e pastrimit është e barabartë me çmimin

[66] Azhorno sipas të gjitha kontratave
[67] Studimi i Uri-t
[68] Baza ligjore për caktimin e tarifave është si më poshtë;
• Ligji nr. 9632, datë 30 tetor 2006 "Për sistemin e taksave vendore".
• Ligji nr. 8652, datë 31 korrik 2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", dhe
• Ligji Nr 10117 datës 23 prill 2009 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30 tetor 2006 "Për sistemin e taksave vendore".

e kontratës. Të ardhurat nga tarifat mbulojnë vetëm 70% të çmimit të kontratës ndërsa pjesa tjetër është subvencionuar nga buxheti i komunës.

Për vitin 2013, buxheti i njësisë përbëhet nga granti i pakushtëzuar nga buxheti i shtetit në vlerë prej 12.513.000 lekë, ndërsa të ardhurat e veta 10.420,000 Lekë. Totali i buxhetit është 22,933.000 lekë dhe kostoja e mbledhjes së mbetjeve mbi këtë buxhet total vjetor është 0,5%.

**Bashkia Lezhë:**Sistemi i Tarifimit është i diferencuar për familjet, bizneset e vogla e të mëdha dhe institucionet. Që nga viti 2014 tarifa për familjet është grupuar. Ajo është 2200 Lekë në vit për familje dhe përfshin shërbimin e pastrimit gjelbërimit, ndriçimit, mirëmbajtjes së rrugëve dhe trotuareve. Tarifa për Bizneset variojnë sipas madhësisë së tyre, sektorit dhe zonës ku ato operojnë. Për Bizneset e vogla tarifat variojnë nga 1000 leke në vit (p.sh. për ambulantë) deri në 25000 lekë në vit (p.sh. për impiante, territore përtherjen e kafshëve). Për bizneset e mëdha ato variojnë nga 12.000 lekë në vit (p.sh.për profesione të lira si piktorë/skulptore) deri në 100.000 lekë në vit (p.sh. për çdo kantier ndërtimi, objekte banimi/shërbimi).

Bashkia për shkak të problemeve financiare nuk arrin të mbulojë të gjithë koston e shërbimit të mbeturinave. Deri ne vitet 2012 detyrimet e papaguara I janë falur nga landfill-i në Bushat. Për 2013 pjesa me e madhe e kostove janë mbuluar nga një projekt; "Depozito Mbeturinat per 1 Euro " i cili ka subvencionuar 6 euro per cdo ton mbetje nga nje cmim mesatar 7euro/ton që merr Bushati per depozitimin e mbetjeve. Për vitin 2014 detyrimet nuk janë paguar që prej 10 muajsh. Nuk ka kontratë të rregullt me Bushatin por vetem memorandume bashkëpunimi sipas nevojave.

Buxheti për pastrimin për vitin 2014 ishte 18,121,579 Lekë kurse të ardhurat nga tarifa e pastrimit, të arkëtuara në 2014, ishin 15,134,000 Lekë. Diferenca subvencionohet nga të ardhura të tjera të bashkisë. Shpenzimet totale të parashikuara të buxhetit të bashkisë në 2014 janë 322 620,000 lekë dhe çmimi i kontratësse shërbimit të menaxhimit të mbetjeve përfaqëson 9% të këtij buxheti

**Shëngjini:**Përveç kontratës me kompaninë private njësia alokon edhe një buxhet shtesë vjetor (2013) prej 4 428 000 Leke që përdoren gjatë sezonit të verës për pastrimin e zonës bregdetare. Çka e rrit buxhetin vjetor për pastrimin deri në 24 108 000 Leke/në vit. **Buxheti I Shëngjinit në 2013 është** 143 654 000 Lekë. Kostot e mbledhjes dhe transportit të mbeturinave përbëjnë 7% të këtij buxheti ndërsa bashkë me shërbimin e pastrimit shkojnë deri në 17% të buxhetit total.

**Shënkoll:** Tarifa për familjet: 1.500 leke/vit; Për Bizneset e vogla varion nga 3.000 në 5.000 Leke në vit ndërsa për të mëdhatë 10.000 Leke/vit. Shkalla e mbledhjes së tarifave në 2012 ishte 30 % për familjet dhe 60% për bizneset (krahasuar me planin). Të ardhurat totale mbulojnë aktualisht vetëm 49% të kostove vjetore dhe diferenca subvencionohet nga buxheti i njësisë ( në 2013 ishte 50.000.000 Leke)

**Zejmen:**Tarifa për familjet është 1.000 leke/vit, për Bizneset e vogla është 1.250 Leke në vit ndërsa për të mëdhatë 30.000 Leke/vit. Shkalla e mbledhjes së tarifave në 2012 ishte 0 % për familjet dhe 65% për bizneset (krahasuar me planin). Njësia mbledh vetëm 75 % të të ardhurave duke mbuluar kështu vetëm 45 % te çmimit të kontratës

**Blinisht:** Në vitin 2013, shuma e alokuar gjithsej për ndërkomunalen nga njësia Blinisht ishte 700,000 lekë ndërsa të ardhurat e mbledhura nga tarifat e pastrimit/gjelbërimit/ujë I pijshëm) ishin 200.000 lekë. Tarifimi në 2014 ishte 2500 lekë në vit për familje dhe 12000 lekë në vit për subjektet juridike. Buxheti total për vitin 2014 ishte 23,243,378 dhe buxhet i alokuar për ndërkomunalen (pastrimin) ishte 500,000 lekë. Të ardhurat e mbledhura nga tarifat e pastrimit/gjelbërimit/ujë I pijshëm) ishin 200.000 lekë

### 3.1.9 Problematikat kryesore të zonës lidhur me menaxhimin e integruar të mbetjeve

Në përgjithësi, sektorit të mbetjeve në zonë I mungojnë instrumentet e duhura të menaxhimit, investimet në teknologjitë moderne, dhe kapacitetetet dhe njerëzore. Megjithë përpjekjet për ndërhyrje në këtë sektor, ato në shumicën e rasteve kanë qene te pakoordinuara, te fragmentuara dhe jo eficente. Për këtë arsye efektet negative në mjedis janë gjithmonë të pranishme.

Problematika të tjera lidhen me; investimet e pakontrolluara të biznesit, përfshirë aktivitetin bujqësor;Shfrytëzimin e pakontrolluar të burimeve natyrore;Mos-koordinimin e qeverisjes qendrore dhe asaj vendore në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit; Mos mbledhjen dhe mos përpunimin e mbetjeve industriale si në zonat urbane dhe ato rurale;përdorimin e rrugëve, lumenjve dhe liqeneve si pika hedhjeje të mbetjeve të prodhuara nga operatorët e bizneseve familjare;mos-kontrollimin e përdorimit pa kriter të ndotësve organik të qendrueshëm; mungesën e monitorimit të shkarkuesve të mbetjeve, kërkesë e legjislacionit në fuqi (PRTR – Regjistrit të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve);

Njësitë përballen edhe me vshtirësi buxhetore dhe menaxhim të dobët financiar të shërbimit (si p.sh. sistem i papërshtatshëm tarifimi, mbledhje e pamjaftueshme e të ardhurave) Një përmbledhje e tyre jepet si më poshtë;

- Buxhet i kufizuar dhe mungesë e investimeve nga burimet e veta të NjQV-ve. Buxheti mesatar operativ për menaxhimin e mbetjeve të zonës është i ulët.
- Buxhetet e pamjaftueshme krijojnë pamundësi për të bërë investime në pajisje, mjete, kontejnerë, për përmirësimin dhe zgjerimin e shërbimeve aktuale në fushën e menaxhimit të mbetjeve.
- Sistem I pa-përshtatshëm tarifimi I cili nuk është I ngritur mbi politika të qarta që mbulojnë kostot operative të çdo shërbimi që u ofrohet konsumatorëve. Mungon një rregullore në nivel vendor/rajonal e cila do të mund të ndihmonte autoritetet të ndërtonin një sistem të drejtë dhe efektiv tarifimi në gjendje të mbulonte kostot e shërbimit. *(p.sh. aplikohen tarifa shumë të ulëta për familjet (me përjashtim të bashkisë Lezhë) dhe ngarkohen me tarifa më të larta përfitues të tjerë)*
- Nivel tejet i ulët i mbledhjes së detyrimeve nga familjet. Diferencat negative që krijohen në buxhet subvencionohen nga të ardhura të tjera të njësisë, për të mbuluar koston e shërbimit ose tarifohen më shumë përfitues të tjerë. Nuk është gjetur akoma një sistem i cili do mund të rrisë nivelin e mbledhjes së detyrimeve nga familjet (p.sh. nëpërmjet faturës së ujësjellësit kur këto të kalojnë në varësinë e drejtpërdrejtë të njësive vendore.
- Mungesë transparence, komunikimi dhe informacioni me publikun. Pavarësisht se kontratat e shërbimit parashikojnë fonde për rritjen e ndërgjegjësimit, ka mungesë të mjeteve informative në zonë për publikun lidhur me kostot e shërbimit, nivelin e tarifave e çështje të tjera lidhur me mjedisin. Këtu bëjnë përjashtim bashkia Lezhë dhe Komunat Blinisht e Dajc nëpërmjet ndërkomunales Zadrima. Lezha është përfshirë në ndërgjegjësimin në rritje drejt mbledhjes së tarifës së shërbimit, si dhe sasinë e mbetjeve të ricikluesshme përmes informacionit dhe komunikimit dhe Ndërkomunalja Zadrima ka një grup të informacioni qytetar dhe organizon aktivitete të vazhdueshme ndërgjegjësimi.
- Mungesa e planeve vendore të menaxhimit të mbetjeve (me përjashtim të bashkisë Lezhë)

## *3.2 Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimet*

ZF Lezhë furnizohet me ujë të pijshëm kryesisht nga stacioni i pompave Barbulloja ku gjenden katër pompa kryesore. Ekzistojnë dy rezervuarë me një kapacitet depozitues prej 4,000m$^3$ dhe kapacitet prodhues 400 litra/sek. Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm menaxhohet plotësisht nga Ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizimeve Lezhë.

Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm nënkupton që ndërmarrja e ujësjellësit t'i shërbejë popullsisë brenda zonave nën administrim, në shtrirje sa më të gjerë dhe me koston më efikase të mundshme. Në tabelën ----jepen të dhëna mbi banesat e banuara sipas bashkisë /komunës dhe sistemit të furnizimit me ujë. Në ZF të Lezhës ushtron veprimtarinë e vet vetëm Sh.a Ujësjellës Kanalizime Lezhë.

**Tabela Aksesi në furnizimin me ujë**

| Bashkia/Komuna | Sistemi i furnizimit me ujë | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Gjithsej** | **Rrjet ujësjellësi brenda banesës** | **Rrjet ujësjellësi jashtë banesës,por në ndërtesë** | **Rrjet ujësjellësi jashtë ndërtesës** | **Sistem i llojit tjetër** | **Pa asnjë lloj sistemi** |
| Gjithsej Total | 15,765 | 8,846 | 1,474 | 1,285 | 3,485 | 675 |
| BALLDREN I RI | 1,467 | 338 | 86 | 185 | 539 | 319 |
| BLINISHT | 835 | 630 | 85 | 74 | 28 | 18 |
| DAJÇ | 945 | 574 | 145 | 92 | 121 | 13 |
| KALLMET | 1,025 | 650 | 184 | 87 | 42 | 62 |
| KOLÇ | 1,033 | 650 | 42 | 132 | 163 | 46 |
| LEZHË | 4,062 | 3,715 | 187 | 115 | 19 | 26 |
| SHËNGJIN | 1,982 | 1,532 | 190 | 111 | 107 | 42 |
| SHËNKOLL | 2,801 | 354 | 407 | 227 | 1,772 | 41 |
| UNGREJ | 315 | 42 | 15 | 69 | 138 | 51 |
| ZEJMEN | 1,300 | 361 | 133 | 193 | 556 | 57 |

*Burimi: INSTAT, Census 2011*

Rreth 26.3 përqind e banesave të banuara në ZF të Lezhës janë jashtë rrjetit të ujësjellësit . Nga këto 4 përqind janë pa asnjë lloj sistemi; 22.1 përqind janë me sistem të llojit tjetër. Në ZF-në e Lezhës shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimit të ujërave të ndotura ofrohet nga Shoqëria Anonime Ujësjellës Kanalizime (SHAUK) Lezhë. Aksionet e kësaj shoqërie janë të shpërndara në tre NJQV, në bashkinë Lezhë (55%), komunën Shëngjin (22,8%) dhe komunën Balldren (22,2%), duke nënkuptuar dhe zonat e shërbimit dhe mbulimit të këtij shërbimi. Ndërmarrja drejtohet nga Asambleja e Aksionerëve dhe Këshilli Mbikëqyrës i cili përbëhet nga 6 anëtarë (Kryetari dhe 5 anëtarë).

Në këtë shërbim ka akses rreth 45% e popullsisë së ZF-së, ndërkohë që 35% të popullsisë banuese në komunat Dajç, Blinisht, Kallmet, Zejmen, Shënkoll dhe Ungrej nuk iu mundësohet ky shërbim.

Bazuar në të dhënat e siguruara, mbulimi me ujë të pijshëm është afërsisht 100.0 % në zonën urbane (bashkia Lezhë) dhe 35.0% në zonat rurale (Komuna Shëngjin dhe Balldren).

**Figura 12 Harta e mbulimit te UK**

Popullsia totale që furnizohet me ujë nga shoqëria është 31,753 banorë dhe mbulimi është 90.7 përqind. Ka një rritje të numrit të lidhjeve në gjysmën e dytë të vitit 2014. Në fund të vitit 2014 ishin të lidhur me rrjetin 8,108 konsumatorë ose 397 më shumë së në gjysmën e parë të vitit 2014.

**Figura 13 Impianti I trajtimit të ujërave**

Për qytetin e Lezhës dhe komunën e Shëngjinit është ndërtuar impianti i trajtimit të ujërave të zeza. Në total janë investuar nga qeveria shqiptare 8.3 milion Euro për impiantin (4.9 milionë) dhe kanalizimet (3.4 milionë) e ujërave të zeza nga zona turistike e Shëngjinit dhe Lezha drejt impiantit. Impianti është ndërtuar për ti shërbyer një popullsie prej 60.000 [69] banorësh duke përfshirë qytetin e Lezhës e Shëngjinit. Impianti është i tipit Biologjik me paratrajtim dhe është i pajisur me laborator dhe pajisje moderne për operimin dhe mirëmbajtjen. Ai ka kapacitet përpunues prej 6.000 m³/ditë



Figura 14 Lidhjet me rrjetin e ujësjellës kanalizimeve (qershor 2014)




Depot e ujit dhe stacioni i pompave ndodhen në Barbulloj. Ujësjellësi i Lezhës është me ngritje mekanike të dyfishtë dhe kjo padyshim që ndikon në koston e lartë të shërbimit. Në vitin 2014 51.5 përqind të kostove i zinte energjia elektrike, ndërsa 36.4 përqind ishin kostot e punës.

Tabela 33 *Kostot operacionale (Dhjetor 2014)*

| | Kostot operacionale | Në lekë | në % |
|---|---|---|---|
| **1** | Kosto energji elektrike sistemi furnizimit me ujë | 51,754 | 51.0 |
| **2** | Kosto energji elektrike sistemi kanalizimeve | 377 | 0.3 |
| **3** | Kosto energji elektrike të tjera (zyra, etj.) | 176 | 0.2 |
| | Kosto totale energjia elektrike | 52,307 | 51.5 |
| **4** | Kosto personeli | 35,931 | 35.4 |
| **5** | Mirëmbajtje, blerje dhe shërbime nga të tretë | 7,624 | 7.5 |
| **6** | Kosto të tjera operacionale | 4,526 | 4.5 |
| | Kostot (impianti i përpunimit të ujërave) | | |
| **1** | Shpenzime personeli | 1,046 | 1.0 |
| **2** | Materiale | 26 | |
| | **Kosto totale operacionale** | **101,460** | |

Tarifat aktuale të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura janë në fuqi që nga 14.01.2014 dhe janë të miratuara nga ERRU. SH.A. Ujësjellës Kanalizime Lezhë ofron shërbimet e veta për konsumatorët bazuar në dy tarifa, tarifat volumetrike për furnizimin me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura. Tarifat janë të përcaktuara për 3 kategori konsumatorësh: konsumator familjar, institucione buxhetore dhe ente private. 91.2 përqind e konsumatorëve janë konsumatorë familjarë 8.4 përqind janë kompani private dhe vetëm 0.4 përqind janë institucione buxhetore.

**Tabela 34 Tarifat e shërbimeve UK Lezhë**

| | Tipi i konsumatorit | Furnizimi me ujë | Largimi i ujërave të ndotura |
|---|---|---|---|
| **1** | Konsumator familjar | 58 lekë/$m^3$ | 18 lekë/$m^3$ |
| **2** | Institucione buxhetore | 135 lekë/$m^3$ | 22 lekë/$m^3$ |
| **3** | Ente private | 145 lekë/$m^3$ | 27 lekë/$m^3$ |

69.4 përqind e totalit të shitjeve realizohet me konsumatorët familjarë, 10.1 përqind institucioneve buxhetore dhe 19.4 përqind kompanive private.

Në dhjetor të v.2014 kompania kishte 8,108 konsumatorë të grupuar si në tabelën , nga të cilët 36.0 përqind faturohen aforfe. Ndërkohë ndërmarrja shet ujë me shumicë dhe për Komunën Kolsh me pikë lidhje. Tarifa e miratuar për shitjen e ujit me shumicë është 25 lekë/$m^3$.

**Tabela 35Numri i konsumatorëve (Dhjetor 2014)**

| Lloji i Furnizimit | Konsumatorë familjarë | Institucione | Kompani Private | Totali |
|---|---|---|---|---|
| **Furnizim sipas matësit** | 4,695 | 18 | 390 | 5,103 |
| **Furnizim aforfe** | 2,682 | 15 | 226 | 2,923 |
| **Me tarifë shërbimi** | 17 | | 65 | 82 |
| Totali | **7,394** | **33** | **681** | **8,108** |

*Burimi: SH.A.UK Lezhë*

**Tabela 36 Të ardhurat dhe arkëtimet UK Lezhë (viti 2014 – në mijë lekë)**

| Të ardhurat | | Arkëtimet | | Realizimi |
|---|---|---|---|---|
| **Indikatori** | Në lekë | Indikatori | Në lekë | Në % |
| **Të ardhura nga shitja e ujit** | 101,050 | Arkëtimet nga shitja | 88,905 | 72.7% |
| **Të ardhura nga kanalizimet** | 21,153 | | | |
| **Të ardhura nga punime dhe shërbime të tjera** | 5,531 | Arkëtime të tjera | 5,531 | |
| **Të ardhurat totale** | 127,734 | Arkëtimet totale | 94,436 | 73.9% |

Në janar të 2014 ERRU krahas tarifave ka miratuar dhe treguesit e performancës që duhet të arrijë ndërmarrja. Sipas treguesve të performancës të publikuar nga ERRU (2014) Lezha operon me 4.6 punonjës për 1000 lidhje. Niveli i këtij treguesi i përafrohet nivelit të vendeve të rajonit ku numri mesatar i punonjësve për 1000 lidhje nuk është më shumë se 4-5 punonjës/1000 lidhje[70]. Kohëzgjatja e furnizimit me ujë të vazhdueshëm nga SH.A.UK Lezhë ka qenë mesatarisht 20 orë në ditë dhe mbulimi me rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimeve në masën 90.7 përqind. 69.4 përqind e totalit të shitjeve realizohet me konsumatorët familjarë, 10.1 përqind me institucionet buxhetore dhe 19.4 përqind me kompanitë private.

SH.A.UK Lezhë ka arritur disa prej objektivave megjithatë duhet të punohet më shumë për uljen e humbjeve, vendosjen e matësve, rritjen e normës së arkëtimit.

**Tabela 37 Treguesit e performancës 2014[71]**

| Treguesit e Performancës | Objektivi | Realizimi i Objektivit |
|---|---|---|
| Uji pa të ardhura (humbjet) | 47.0% | 48.4% |
| Niveli i matjes | 75.0% | 63.9% |

[70] ERRU, Raporti vjetor 2014, fq.
[71] Enti rregullator, SH.A.UK Lezhë dhe http://ëëë.dpuk.gov.al/ndermarrje_info_txt.php?id=1143&idn=75

| | | |
|---|---|---|
| Kohëzgjatja e furnizimit | 20 orë/ditë | 20 orë/ditë |
| Eficenca e energjisë | 2.5këh/$m^3$ | 2.57këh/$m^3$ |
| Efikasiteti i stafit | 6 p/000/lidhje | 4.6p/000/lidhje |
| Mbulimi me ujë | 90.0% | 90.68% |
| Mbulimi me kanalizime | 90.0% | 90.68% |
| Norma e arkëtimit | 85.% | 73.0% |
| Cilësia e ujit (klor+koliform) | sipas standardeve | sipas standardeve |

Gjatësia e rrjetit shpërndarës të ujësjellësit është 63 km, nga të cilat 71.4 përqind e zë rrjeti shpërndarës. Ndërsa gjatësia e përgjithshme e rrjetit të kanalizimeve është 28 km.

**Tabela 38 Të dhëna mbi rrjetin shpërndarës UK Lezhë (2014)**

| Tubacionet e sipas materialeve | Gjatësia km | Tubacionet sipas linjave | Gjatësia km |
|---|---|---|---|
| Gjatësia totale e tubacioneve prej çeliku (km) | 56.0 | Gjatësia e linjave te rrjetit kryesor (km) | 18.0 |
| Gjatësia totale e tubacioneve prej gize (km) | 5.0 | Gjatësia e linjave te rrjetit shpërndarës (km) | 45.0 |
| Gjatësia totale e tubacioneve prej polietilen-plastike (km) | 2.0 | | |
| Gjatësia e tubacioneve prej betoni (km) | 20.6 | | |
| Gjatësia e tubacioneve prej polietilen-plastike (km) | 7.0 | | |
| Gjatësia e tubacioneve prej materialesh te tjera (km) | 0.4 | | |

Numri i incidenteve në furnizimin me ujë ka qenë 3,518 për vitin 2014 ndërsa në kanalizime ka qenë 1,884. Këto të dhëna tregojnë që SH.A.UK Lezhë trashëgon një infrastrukturë të amortizuar dhe ka kosto operative shumë të lartë, të cilat duhet të përballohen nga të ardhurat që sigurohen nga tarifat e shërbimit. Aktualisht në rrethin e Lezhës po zbatohet një projekt ku partner janë Ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizimeve dhe Bashkia Lezhë. Projekti mbulon rehabilitimin dhe zgjerimin e rrjetit ekzistues të furnizimit me ujë, instalimin e matëseve të rinj familjare, ndërtimin e tre rezervuarëve të rinj, rehabilitimin e stacionit të pompimit e disa masa të tjera.

Vlera e përgjithshme e projektit është 13.6 Milionë€, nga të cilat 80 përqind është grant I qeverisë Zvicerane (SECO) dhe 20 përqind është kredi e financuar nga Kreditanstalt Für Ëiederaufbau (KfË). Zbatimi i këtij projekti do të kontribuojë për një përdorim efektiv të burimeve të rralla të ujit, për mbrojtjen e mjedisit me një përmirësim paralel të kushteve të jetesës, punës dhe shëndetit për popullsinë. Projekti ka filluar zbatimin në fund të vitit 2014 dhe pritet të përfundoj në v.2016.

Me këto fonde po punohet për i). rehabilitimin e rrjetit të shpërndarjes me gjatësi 63 km në qytetin e Lezhës, në zonën e SMT-së si dhe në zonën frutore, ii). rehabilitimin e pusit numër 1, iii). ndërtimi i dy depove të reja të ujit me kapaciet 4000 m3 secila, iv). integrimin e sistemit të furnizimit me ujë në sistemin ekzistues, si dhe v). sigurimin e pajisjeve të mirëmbajtjes, zbulimit të rrjedhjeve dhe kalibrimit. Këto ndërhyrje do të sigurojnë rritjen e numrit të orëve të furnizimit me ujë të popullsisë, nga 12-16 orë në ditë aktualisht, në 24 orë në ditë brenda vitit 2018[72].

Disa komuna kanë ndërtuar ujësjellësit e tyre me financime nga FZHR dhe nga të ardhurat e tyre. Komuna Kolsh blen nje pjese te ujit nga nga SH.A.UK Lezhë dhe e shpërndan në rrjetin e saj.

**Konkluzione:**

[72] Plani Strategjik për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Komunitetit të Lezhës, 2013–2030 fq. 42

- infrastruktura e amortizuar dhe kostot operative shumë të larta, të cilat duhet të përballohen nga të ardhurat që sigurohen nga tarifat e shërbimit;
- nevoja për rritjen e kohëzgjatjes së furnizimit me ujë të vazhdueshëm; dhe

nevoja për adresimin e rritjes potenciale të kostos së këtij shërbimi si pasojë e rritjes së çmimit të energjisë me 9%

## *3.3 Rrugët dhe transporti publik*

Rrjeti rrugor që përshkon ZF të Lezhës klasifikohet në tre kategori:

- Rrugë nacionale-përgjegjës për mirëmbajtjen dhe investimin në to është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Gjatësia e segmenteve të rrugëve nacionale që përshkojnë ZF të Lezhës është 130,45 km. Për vitin 2015 po investohet në segmentin Milot-Lezhë (riveshje –sistemim - asfaltim) me gjatësi 15,3 km dhe vlerë investimi 379.385.748 leke (me TVSh).

- Rrugë rajonale-këto rrugë administrohen nga Ndërmarrja e Rrugëve Rurale, e cila është në varësi të qarkut Lezhë. Kjo ndërmarrje administron të gjithë fondin e rrugëve rurale në nivel qarku ose 400 km. Nga këto vetëm 1/5 përshkojnë ZF të Lezhës

- Rrugë komunale-të cilat janë në varësi të komunave. Fondi I këtyre rrugëve është 282,5 km dhe ato duhet të mirëmbahen nga ana e komunave. Investimet përgjithësisht janë financuar nga FZHR përmes granteve konkurruese ose nga të ardhurat e veta.

**Figura15: Harta e rrjetit rrugor në qarkun Lezhë *(Burimi: MCV)***




Investimet e kryera në infrastrukturë në dhjetëvjeçarin e fundit në këtë zonë kanë përmirësuar një pjesë të madhe të rrugëve dhe kanë ndikuar ndjeshëm në kohën e udhëtimit nga njësitë administrative në qendrën e Zonës Funksionale.

Afro 57 përqind e rrjetit rrugor të ZF është rrugë komunale. Pjesa më e madhe e rrugëve rurale janë rrugë të kategorisë së parë (të asfaltuara).

Njësitë administrative rurale ndodhen në distancë të favorshme që mundëson akses të lehtë me qendrën urbane të propozuar të kësaj zone funksionale. Me përjashtim të komunës Ungrej që gjendet rreth 20 km larg, dhe ka kohën më të gjatë të udhëtimit (82 minuta) për shkak të terrenit malor dhe gjendjes së keqe të rrugës të gjithë komunat e tjera, të ndihmuara dhe nga infrastruktura rrugore, mund të arrijnë qendrën e zonës funksionale (Lezhën) për 10-20 minuta. (tabela 1). Qendra e zonës funksionale (Lezha) ndodhet në distancë të shkurtër nga porti i Shëngjinit dhe plazhet kryesore (Shëngjini, Kune dhe Vain)[73].

[73]Distanca e Lezhës nga porti i Shëngjinit është vetëm 6 km. Afërsia me plazhet; Lezhë-Shëngjin 6 km; Lezhë-Kune rreth 8 km; Lezhë - Vain 3 km

**Tabela 39:** Rrjeti rrugor në ZF Lezhë

| NJQV | Rrugë nacionale (km) | Rrugë rajonale (km) | Rrugë komunale (km) | Koha e udhëtimit në qendrën e ZF (min) |
|---|---|---|---|---|
| Ungrej | | | 48 | 82 |
| Blinisht | | 12 | 32 | 16 |
| Dajç | 7.2 | 5 | 26 | 18 |
| Kallmet | 15.95 | 39 | 24 | 13 |
| Kolç | | | 11 | 10 |
| Zejmen | 5 | | 25 | 13 |
| Balldren i Ri | 53.3 | 2 | 41.5 | 10 |
| Shëngjin | 23,4 | 2 | 45 | 9 |
| Shënkoll | 25,6 | 20 | 30 | 14 |
| Lezhë(B) | | | | |
| Total | **130,45** | **80** | **282,5** | |

*Burimi: Të dhëna administrative dhe Google maps*

Rrjeti i rrugëve rurale është 80 km, nga të cilat 79 përqind janë rrugë të kategorisë së parë (asfalt). Buxheti i Ndërmarrjes së Rrugëve Rurale miratohet nga qarku dhe përbëhet vetëm nga dy zëra: shpenzime për personelin dhe shpenzime të tjera korrente. Buxheti për shpenzimet korrente është dyfishuar në v.2014, ndërkohë që rritja për 2015 është vetëm 1.4%.

**Figura 16Buxheti për periudhën 2013-2015(në mijë lekë)**




Investimet në infrastrukturën rrugore në rrethin e Lezhës kanë qenë të kënaqshme në dekadën e fundit. Për periudhën 2005-2013 janë financuar nga FSHZH 12 projekte dhe në total janë rikonstruktuar 71.17 km rrugë rurale. Vlera e investimit për të gjitha projektet ka qenë2,020,319,765 lekë. (shih tabelën në aneksin 2) Përgjithësisht rrugët rurale janë në gjendje të mirë, por nevojiten investime në drejtim të sinjalistikës. Sinjalistika sipas ekspertëve të ndërmarrjes ka mangësi dhe për këtë nevojiten investime.

**Tabela 40Rrjeti i Rrugëve Rurale**

| Nr. | NJQV | Segmenti rrugëve (km) | Kategoritë e rrugëve | | | Shënime | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Kat.I Asfalt | Kat.III Kalldrëm | Kat.IV Cakull | | |
| **1** | K/Kallmet | 11 | 11 | | | Rruga Varrez Qyt-Kallm.vogë | 11 km |
| **2** | K/Blinisht | 25 | 25 | | | Rruga Kallm.vog-Krajë<br>Rruga Gjadër-Blinisht<br>Rruga Troshen-Qëndër | 11 km<br>12 km<br>2 km |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **3** | K/Ungrej | 15 | | | 15 | Rruga Kallm.vog-Ungrej | 15 km |
| **4** | K/Shënkoll | 15 | 15 | | | Rruga Ish SMT-Shënkoll<br>Rruga Superstrad-Tale | 10 km<br>5 km |
| **5** | K/Zejmen | 5 | 5 | | | Rruga Zejmen-Superstrad | 5 km |
| **6** | K/Shëngjin | 2 | 2 | | | Rruga Fabr.Letre-Shëngjin | 2 km |
| **7** | K/Balldre | 2 | - | - | 2 | Rruga Bend-Bisht Jugë | 2 km |
| **8** | K/Dajc | 5 | 5 | | | Rruga Gjadër-Grash | 5 km |

Gjatë viteve2012- 2013 është investuar në disa komuna në rrugët komunale me fonde të buxhetit të shtetit dhe fonde të vet NJQV-e. Mundësitë financiare të komunave për të financuar në rrjetin rrugor janë shumë të vogla. Në shumë raste financimi i projekteve shtrihet në disa vite financiare dhe kjo i bën investimet joefektive (për projektet konkrete shih tabelën në aneksin 2).

**Figura 17Investime në infrastrukturë rrugore (në mijë lekë)**




**Transporti**

Eshtë një aktivitet që ka nevojë për formalizim dhe riorganizin të mëtejshëm në qark. Ai karakterizohet nga problematika të ndryshme duke filluar nga informaliteti në sektor, menaxhim dhe strukturim jo I përshtatshëm, mungesë koordinimi në masa midis autoriteteve të ndryshme përgjegjëse, mosrespektimi I rregullave nga operatorët privatë etj.

Në ZF të Lezhës ky transport organizohet nga subjektet private tëlicencuara për furgonë taksi (8+1) dhe taksi (4+1). Shërbimi është shumë i copëzuar brenda ZF, dhe për rrjedhojë rezulton në një shërbim me kosto të lartë për ofruesin, dhe me një cilësi të ulët për përdoruesit e tij.

Aktualisht shërbimi transportit ofrohet nga subjekte private tëlicencuara nga NJQV. Në vitin 2012 numri i automjeteve të regjistruara për pasagjerë (taksi 4+1 dhe 8+1) nga bashkia Lezhë ishte 27. Bashkia aktualisht jep licencat për operatorët privatë dhe monitoron zbatimin e orarit dhe mbulimin e linjave. Linjat kategorizohen në linja ndërqytetëse (midis qendrave urbane) dhe rrethqytetëse (fshatqytet). Te parat aprovohen nga Ministria e Transporteve kurse të dytat nga Qarku. Në Lezhë ka 7 linja transporti midis qarqeve, 2 linja brenda qarkut ndërkohë që Laçi vetë administrohet dhe nuk është në kontrollin e Bashkisë. Ka 10 linja të miratuara rrethqytetëse nga të cilat vetëm 4 janë operative. Pjesa tjetër ose administrohet nga njësitë ose ekzistojnë si aktivitete informale Sipas rregullores njësia duhet të lëshojë një liçencë për cdo linjë transporti dhe çertifikata për çdo mjet. Aktualisht njësitë nuk e respektojnë këtë gjë dhe shumë prej tyre lëshojnë liçenca për cdo mjet kundrejt një tarife të caktuar. Koordinimi me njësitë për ofrimin e shërbimit të transportit thuajse mungon (zakonisht ka disa vende specifike që shërbejnë si stacione por oraret nuk respektohen).

Me bashkimin në një zonë funksionale bashkia Lezhë do të marrë përsipër edhe licencimin dhe mbikëqyrjen e të gjithë subjekteve që ofrojnë shërbimin e transportit publik, si edhe të hartojë një plan për ofrimin e shërbimit të transporti publik. Kjo do të duhet të përfshijë edhe disa linja ndërurbane mes Lezhës dhe

komunave përreth. Një studim i hollësishëm do të nevojitet për kapacitetin e linjave dhe efektivitetin e kostos së tyre. Një nga hapat më të shpejtëështë dizenjimi i një vendqëndrimi për autobusët dhe mjetet e tjera të transportit publik në një nga nyjet në hyrje tëqytetit të Lezhës, ku ka një sërë hapësirash të ish-ndërmarrjeve publike të cilat nuk janë aktualisht në shfrytëzim.

Ka një projekt ide që është diskutuar edhe në nivel Ministrie, për krijimin e nje autoriteti rajonal për transportin në nivel qarku ku operatorët privatë të jenë aksionerë sipas % aktuale që ato zënë në treg. Projekti nuk ka gjetur mbështetje nga këta të fundit

**Konkluzione**

- Koordinim dhe mbeshtetje ne hartimin e nje Plani Transporti Publik Rajonal, me prioritet zonat turistike
- nevoja për një studim të hollësishëm për kapacitetin e linjave dhe efektivitetin e kostos së tyre; dhe
- nevoja për projektimin dhe ndërtimin e një vend-qëndrimi për autobusët dhe mjetet e tjera të transportit public në një nga nyjet në hyrje të qytetit të Lezhës.

# 4. Struktura organizative

Struktura aktuale e Bashkisë Lezhë numëron rreth 150 punonjës, buxheti vjetor i Bashkisë prezantohet në shumën 300 milionë lekë, shpenzimet për personelin përbëjnë 13% të totalit të buxhetit . Kjo strukturë është e orientuar drejt shërbimeve funksionale të njësisë vendore dhe përbëhet nga një zv/kryetar roli i të cilit është thjesht politik pasi nuk ka struktura varësie apo sektorë/funksione për të cilat përgjigjët përpara kryetarit.

Ndërkohë është Kryetari i Bashkisë i cili ka në varësi direkte 9 Drejtori të cilat më tej kanë në varësi drejtori e sektorë specifikë, ajo që bie në sy është ngarkesa e varësisë direkte të Kryetarit i cili ndjek dhe funksionet e deleguara të cilat varësi direkte e tij sic janë gjendja civile apo QKR.

Në kushtet e ndryshimeve ligjore dhe detyrimeve qe rrjedhin nga aplikimi i reformës territoriale, konceptimit të zonave funksionale dhe përfshirjes si pjesë e bashkisë Lezhë të njësive vendore dhe shërbimeve që ato ofrojnë për komunitetin del nevoja e rishikimit të strukturës organizative në Bashkisë Lezhë me fokus përmbushjen e nevojave të komunitetit dhe garantimin e ushtrimit të funksioneve të njësisë vendore deri në nivelin më të ulët të qeverisjes.

Gjithashtu struktura duhet të japë një ide të qartë të varësisë dhe përgjegjësive të gjithëseicilit dhe të garantojë komunikimin horizontal dhe vertikal, kontrollin, si dhe të lehtësojë kryetarin nga strukturat e shumta direkte dhe ta ndihmojë në vendimarrje.

Bashkia Lezhë është pjesë e zonës funksionale të Lezhës, qëndra e bashkisë është Lezha dhe ka në përbërje të saj njësitë: *Lezhë, Shëngjin, Zejmen, Shënkoll, Balldren, Kallmet, Blinisht Dajç, Ungrej dhe Kolsh.* Njësia e re vendore do të duhet ti shërbejë tashmë një numri më të madh popullsie e shpërndarë në zona urbane dhe rurale si dhe do ti duhet të përshtasë strukturën e saj organizative për të manaxhuar më mirë këto territore.

Për tu përballur me mirë me nevojat dhe për ti përktyer ato në shërbime konkrete për komunitetitn kërkohet domosdoshmërisht harmonizimi I strukturave organizative me funksionet e njësive vendore, në këtë kuadër një rëndësi primare që në ditët e para të qeverisjes së njësisë merr ristrukturimi i tyre për tu përshatur me shërbimet që këto të fundit ofrojnë për komunitetin.

**Ristrukturimi duhet të synojë;**

Krijimin e një strukture organizative që ti përshtatet nevojave të komunitetit dhe të jetë në harmonizim të plotë me funksionet e njësisë vendore si dhe të garantojë:

- Rritja e cilësine e shërbimeve duke krijuar një administratë në shërbim të qytetarëve, të shpejtë në ofrimin e shërbimeve dhe të saktë në përmbushjen e cdo përgjegjësie të ngarkuar.
- Përmbushja e objektivave të përcaktuara me ligj;
- Rritja e eficencës së përdorimit të burimeve financiare duke mënjanuar dublimet e funksioneve dhe përgjegjësive dhe reduktuar kostot e tepërta administrative.
- Përshkrime të sakta pune dhe regullore funksionimi.
- Gjithashtu ky ristrukturim duhet të mbështetet në ligjin për Nëpunësin civil dhe të gjitha aktet nënligjore në zbatim të tij.

**<u>Më konkretisht:</u>**

1. Struktura që propozohet duhet të shprehë qartë ndarjen e funksioneve të njësisë vendore si një e vetme dhe do jetë e orientuar në shtyllat e mëposhtme:

a) Shtylla planifikuese dhe ajo e politikave të zhvillimit të njësisië vendore.
b) Shtylla regullatore që në vetvete do të përfshirë kontrollin mbi territorin, planifikimin urban dhe territorin, inspektoriatet e terrenit sic është ai I ndërtimit.
c) Shtylla që menaxhon shërbimet publike dhe i ndjek ato në terren. Kjo shtyllë përfundon atë cka hartohet dhe konsolidohet në shtyllën planifikuese.
d) Shtylla kontrolluese;

2. Pozicionet politike do të mbahen nga dy zv/Kryetarë të cilët do kenë struktura dhe përgjegjësi direktë lidhur me:

a) Për funksionet e Planifikimit strategjik
b) Auditit, si një strukturë që kontrollon të gjitha departamentet dhe institucionet e varësisë.
c) Marrëdhëniet me publikun
d) Marrëdhëniet me njësitë vendore pjesë e qytetit të Lezhës, nëpërmjet ngritjes për herë të parë të "zyrës së administratorëve lokalë" që do ketë për qëllim kordinimin me njësitë vendore *Shëngjin, Zejmen, Shënkoll, Balldren, Kallmet, Blinisht Dajç, Ungrej dhe Kolsh të cilat do të përfaqësohen me strukturat e tyre nëpërmjet administratorëve lokalë.*

3. Administratori i qytetit. Propozojmë krijimin e një pozicionit të ri (Adnimistratori i Qytetit (city manager) i cili do jetë përgjegjës për drejtimin dhe koordinimin e punës së administratës së njësisë vendore duke përfshirë dhe strukturat e administratorëve vendore (vetëm për cështjet të funksionimit dhe financimit) të orientuar sipas shtyllave.

a) Shtylla planifikuese dhe ajo e politikave të zhvillimit të njësisië vendore.
b) Shtylla regullatore që në vetvete do të përfshirë kontrollin mbi territorin, planifikimin urban dhe territorin, inspektoriatet e terrenit sic është ai I ndërtimit.
c) Shtylla që menaxhon shërbimet publike dhe i ndjek ato në terren. Kjo shtyllë përfundon atë cka hartohet dhe konsolidohet në shtyllën planifikuese.

4. Struktura e policisë bashkiake, inspektoriati urban dhe Administratorët lokalë do të kenë varësi dyfish si nga Kryetari i Bashkisë në lidhje me ushtrimin e funksioneve të tyre, vendimarrjes dhe varësi administrative nga Administratori i përgjithshëm.

5. Njësitë e Administratorëve lokalë do jenë bërthama që do të drejtohen nga administratorët dhe një staf I limituar, pranë këtyre strukturave do të funksionojnë dhe OSHEE.

6. Në vijim propozohet krijimi i drejtorive administruar nga drejtorë, pozicion i cili sipas statusit të nëpunësit civil mban jo vetëm përgjegjësi në koordinimin dhe administrimin e punëve në drejtori por dhe monitoron detyrat e kryera nga cdo sektor në varësi. Këto drejtori do jenë kryesisht:

   - Drejtoria për kujdesin social
   - Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik,
   - Drejtoria e Transportit
   - Drejtoria e Rrjeteve inxhinierike dhe ajo e Planifikimit Urban
   - Drejtoria e Zhvillimit Urbanistik (dhe zhvillimi rajonal)
   - Drejtoria e Kontrollit te Territorit
   - Drejtoria e Manaxhimit të shërbimeve
   - Drejtoria e Mjedisit
   - Drejtoria e Promovimit të Qytetit
   - Strehimi
   - Struktura mbështetëse (financa, shërbimet mbështetëse burimet njerëzore, juridike etj)
   - Drejtoria e teknologjisë dhe informacionit

# 5. *Projektet e propozuara*

## 5.1 Tregu bujqësor

### 1. Të dhëna të përgjithshme

| | |
|---|---|
| **Titulli i projektit** | *Studimi I nevojave për investime për ndërtimin e Dhomave Frigoriferike dhe Qendrave të Grumbullimit e Magazinimit te produkteve bujqesore dhe blegtorale ne Zonen funksionale te Lezhes dhe zbatimi I tyre* |
| **Tipi i projektit** | *Zhvillim ekonomik* |
| **Vendndodhja e projektit** | *Dajc, Blinisht, Kallmet, Ungrej, Balldre, Zejmen, Kolsh, Shen Koll, Lezhe, Shëngjin.* |
| **Buxheti total i paravlerësuar** | *200.000 Euro* |

1. **Sfondi dhe analiza e problemit.** Një analizë e shkurtër e situatës që doni të ndryshoni duke shpjeguar nevojën për ketë projekt; a është projekti i harmonizuar me analizat e kryera gjatë përgatitjes së FAP[74]?

Megjithë potencialin e lartë për zhvillim bujqësor dhe blegtoral që ka Zona Funskionale Lezhë, infrastruktura territoriale dhe logjistike nuk krijon mundësi të mjaftueshme. Zonës i mungojnë qendra të konsoliduara të grumbullimit, ruajtjes dhe ftohjes së produkteve bujqësore dhe blegtorale (drithërave, frutave, perimeve, agrumeve, qumeshtit e mishit). Jo vetëm që ato mungojnë, por Zona nuk disponon as nje studim të elaboruar se ku mund të ngrihen këto pika. Prodhimet ose i shiten direkt konsumatorit final (psh fermerë lokalë që shesin në buzë të rrugëve në pamundësi për të siguruar treg shitjeje në një mënyrë tjetër), ose prodhimet mblidhen, ruhen dhe transportohen më së shumti në kushte të papërshtatshme. Shkëmbimet tregtare midis prodhuesve dhe përpunuesve nuk janë të formalizuara. Ato nuk realizohen në mënyrën me eficiente dhe efektive të mundshme, sipas një plani të studiuar mire, në përputhje me nevojat e bizneseve dhe kërkesës së tregut. *(psh kosto të larta transporti për operatorët si pasoje e fragmentarizimit të lartë të tegjeve)*.

### 2. Objektivi/at specifikë të projektit

Objektivi I përgjithsëm I projektit është të kontribuojë në zhvillimin ekonomik të zonës nëpërmjet mbeshtetjes së një prej sektorëve prioritarë të saj si bujqësia dhe blegtoria.

Objektivat specifikë janë;

- Krijimi I kushte paraprake për nje aktivitet ekonomik eficient dhe efektiv të bizneseve bujqesore, blegtorale, dhe agro-industriale sipas një planitë përshtatur me logjistikën në dispozicion, aksesin më të mirë, potencialin dhe nevojat e operatorëve ekonomikë në sektor).
- Mbledhja dhe ruajtja e produkteve bujqësore në kushte të përshtatshme higjeno-sanitare nëpërmjet konsolidimit të infrastrukturës bujqësore dhe blegtorale

[74]FAP- akronimi në Anglisht i programit të Zonës Funksionale (Functional Area Programme).

### 3. Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit

Nga ky projekt pritet të përfitojnë të gjitha njësitë vendore të Zonës funksionale (10); përfshirë ato të cilat tipikisht janë të specializuara në bujqësi e blegtori. Edhe edhe ato që nuk janë të tilla, si psh Lezha apo Shëngjini, do shërbejnë si qendra logjistike në rrjet për t'i dhënë akses prodhimeve në tregjet kombëtare dhe më tej. Numri i popullsisë përfituese është ajo banuese në të gjithë territorin e Zonës; 102,792 banorë (sipas regjistrit civil 2011) ose 65,633 (sipas Census 2011). Pikat e grumbullimit , magazinimit dhe ftohjes jo domosdoshmërisht do të ngrihen në cdo njësi por do jenë të grupuara sipas kërkesës dhe suportit logjistik përreth.

Treguesit kryesorë të këtij projekti janë:

- Mbështetje e futjes së sistemeve të cilësisë dhe sigurisë ushqimore si dhe pakësim i humbjeve pas vjeljes dhe përmirësim i teknikave dhe kapaciteteve ruajtëse;
- Përmirësim i trajtimit dhe menaxhimit të mbetjeve nga sektori bujqësor;
- Përmirësim i magazinimit dhe tregtimit të produkteve të frutave dhe perimeve.

### 4. Aktivitetet e projektit

***E rëndësishme:*** *Një vlerësim për kohëzgjatjen e projektit dhe aktivitetet kryesore të mundshme.*

Projekti I cili do të përfshijë studim dhe zbatim investimesh planifikohet të zgjasë 2,5 vite. Aktivitetet janë:

1. Studim i fizibilitetit të zonës:

   - Studim / analiza e tregut - përfshin vlerësim i mundësive të tregut në terma të produkteve, cmimeve, logjistikës / kanaleve të tregut, tregtimit / promovimit; (koha e nevojshme: 1 muaj; kosto: 4 – 5 mijë euro)
   - Identifikimi i fermerëve / grupimeve të fermerëve që mund të përfshihen në skemat e furnizimit të kontraktuar dhe intensifikimit të prodhimit (takime, grupe pune , evente te tjera, vizitë studimore); (koha e nevojshme: 3 muaj; kosto: 8 – 10 mijë euro)
   - Identifikimi i vendodhjes dhe projektimi i investimeve fizike – përcaktimi i specifikimeve teknike të infrastrukturës; (koha e nevojshme: 2 muaj; kosto: 10 – 15 mijë euro)
   - Studime plotësuese – përfshin mbështetjen ligjore për realizimin e investimeve (krijimit të strukturave menaxhuese) dhe analiza financiare e kostove dhe përfitimeve; (koha e nevojshme: 2 muaj; kosto: 8 – 10 mijë euro)

2. Punime dhe paisja me teknologji mbështetëse e pikave të mbledhjes dhe përpunimit pjesor së produkteve (me qëllim tregtimin)[75]:

   - Ndërtimi / rehabilitimi i infrast rukturës fizike – në varësi të gjetjeve të studimit të fizibilitetit; (Për 1 njësi / koha e nevojshme: 9 muaj; kosto: 60 -70 mijë euro)
   - Paisja me teknologji mbështetëse - në varësi të gjetjeve të studimit të fizibilitetit; (Për 1 njësi / koha e nevojshme: 3 muaj; kosto: 40 -60 mijë euro)
   - Asistenca teknike për zbatimin e *"EUREP GAP / GLOBAL GAP"* dhe *"QUALITY CONTROL"* (koha e nevojshme: gjatë zbatimit të projektit – 18 muaj; kosto: 20 – 25 mijë euro (mbulohet nga përfituesi))

3. Marketim dhe promovim i iniciativës dhe produkteve:

[75] Merkato e Qafzotaj financim i FAO/Italian Cooperation FAO GCP/ALB/005/ITA – kosto: 120.000 EURO

- Pjesëmarrje në panaire dhe takime “B2B” (koha e nevojshme: 2- 3 takime gjatë vitit të parë të zbatimit; kosto: 6 – 7 mijë euro)
- Përgatitje dhe shpërndarje e materialeve promovuese (koha e nevojshme: gjatë vitit të parë të zbatimit; kosto: 2 – 3 mijë euro)

## 5. Pjekuria e projektit

Projekti përfshin hartimin e një studimi fizibiliteti për Zonën Funksionale Lezhë lidhur me nevojat për investime në ngritjen e pikave të grumbullimit, magazinimit dhe ftohjes së prodhimeve bujqësore e blegtorale . Ai do nisë me një studim fizibiliteti I cili mungon për këtë sektor dhe më pas do zhvillohet më tej nëpërmjet zbatimit të disa investimeve prioritare (ngritjes së këtyre pikave) dhe themelimin e e strukturës institucionale që do ta menaxhojë këtë rrjet. Nëse studimi nuk hartohet paraprakisht, investimet do jetë e vështirë të orientohen aty ku duhet. Gjithashtu nëse mbrapa nuk ka një strukturë institucionale për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e tij do jetë e vështirë që kjo nismë të jetë koherente.

## 6. Burimet e financimit dhe partnerët e zbatimit

Burimet e financimit mund të jenë të diversifikuara; fonde publike dhe private, nga buxheti Bashkisë së madhe, fondet e BE-se IPARD, etj.

Aktor i përshtatshëm për zbatimin e projektit mund të jetë Drejtoria Rajonale e Bujqësisë në bashkëpunim me Bashkinë e madhe dhe Shoqata Fermerësh në zonë.

## 7. Kostot e projektit

Projekti mendohet të kushtojë 158.000 – 205.000 Euro

- Studim i fizibilitetit: 30 – 40 mijë euro;
- Punime dhe paisja me teknologji mbështetëse: 120 – 155 mijë euro;
- Marketim dhe promovim i iniciativës dhe produkteve: 8 – 10 mijë euro.

## 5.2 Turizmi digjital

### 1. Të dhëna të përgjithshme

| | |
|---|---|
| **Titulli i projektit** | *Krijimi i një platformë dixhitale për promovimin e destinacioneve turistike në Rajonin Lezhë* |
| **Tipi i projektit** | *Zhvillim ekonomik* |
| **Vendndodhja e projektit** | *Qarku Lezhë* |
| **Buxheti total i paravlerësuar** | *50.000 Euro* |

### 2. Sfondi dhe analiza e problemit.

Rajoni aktualisht nuk e projekton potencialin e plotë (rajonal) turistik nëpërmjet mekanizmave informues dhe promovues. Të dhënat dhe informacioni turistik është në pronësi të individëve që drejtojnë OJF –të apo agjenci private turistike. Vizibiliteti është shumë i ulët. Rajoni në përgjithësi, dhe ZF në vecanti nuk disponojnë një inventar të plotë të aseteve turistike (natyrore, monumente, objekte kulti etj.) Ky projekt është një pikë e dobishme fillestare që do të centralizojë dhe organizojë informacionin kyç dhe mesazhet promocionale në një portal të vetëm, të identifikueshëm lehtësisht në rrjetin botëror Ëeb, i mbështetur nga një shërbim i thjeshtë që është sigurimi i informacionit të mëtejshëm dhe kontaktet. Gjithashtu, Puna parapërgatitore për këtë projekt do inicionte një inventarizim paraparak të aseteve të rajonit. Projekti do kontribuonte edhe ne forcimin e aftesive të burimeve njerëzore që do përfhishen në të.

### 3. Objektivi/at specifikë të projektit

**Përmirësimi i marketingut** turistik të rajonit dhe **zgjerimi I cilësisë së shërbimeve turistike**
**Informimi** dhe rrjetëzimi i partnerëve rajonalë
**Identifikimi dhe Promovimi** i produkteve turistike, itinerareve e burimeve të tjera.
**Përmirësimi i konkurrueshmërisë së rajonit** nëpërmjet përmirësimit të konkurrueshmërisë së SME-ve që operojnë në sektorin e turizmit

### 4. Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit

- **Zhvillimi i** kapaciteteve për zbatimin e praktikave të marketimit
- **Zhvillimi** i kapaciteteve për menaxhimin e platformës
- **Rritja** e vizibilitetit të burimeve, produkteve turistike dhe operatorëve të turizmit

### 5. Aktivitetet e projektit

Projekti I cili do të përfshijë studim dhe zbatim investimesh planifikohet të zgjasë 1 vit.

Aktivitetet janë;
- **Themelimi** I partneriteti rajonal i udhëhequr nga qarku
- **Ngritja** e grupeve tematike të punës
- **Përcaktimi** përmbajtjes dhe paraqitjes
- **Dizenjimi i platformës** për turizmin rajonal

- Krijimi i bazës së të dhënave që duhet të promovohet përmes platformës dixhitale
- Mirëmbajtja dhe Përditësimi (ngritje kapacitetesh me aktorët që do të përfshihen)
- **Caktimi** i mënyrës së operimit
- **Negocimi** i lidhjeve me rrjete/faqe Ëeb të tjera / promovimi i platformës tek operatorët turistikë lokalë
- **Prokurimi** i shërbimeve

**6. Pjekuria e projektit (5-6 lines)**

Projekti është pjesë e Strategjisë së Turizmit të Qarkut Lezhë dhe gjithashtu dhe pjesë e bazës se projekteve të ideuara nga Programi RDP. AI mund të fillojë menjëherë meqenëse është I thjeshtë për t'u zbatuar. Projekti inicion një proces të rëndësishëm paraprak të inventarizimt të aseteve të tij si parakusht për të ndërtuar më pas dhe platformën promovuese. Është me rëndësi për sektorin turistik I cili është edhe prioritet për Zonën. Nëse mbrapa nuk ka një strukturë institucionale të konsoliduar me përgjegjësi të qarta për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e tij, do jetë e vështirë që kjo nismë të jetë koherente.

**7. Burimet e financimit dhe partnerët e zbatimit (maks. 3-4 rreshta)**

Burimet e financimit mund të jenë të diversifikuara; fonde publike dhe private, Këshilli I Qarkut, buxheti I Bashkisë së madhe, programe të ndryshme të BE-se ( psh IPA), grante si DLDP, etj.

Aktor I përshtatshëm për zbatimin e ketij projekti është Këshilli I Qarkut në bashkëpunim me agjencine rajonale të zhvillimit Lezhë (LERDA), OJQ etj

**8. Kostot e projektit (maks. 3-4 rreshta)**

Burime Njerëzore – (20.000 Euro)
Platforma + Baza e Të dhënave + Mirëmbajtje për 2 vjet – (20.000 Euro)
Trajnime, Materiale promovuese, te tjera.. (10.000 Euro)

## 5.3 Ndërtimi i thertores

1. **Të dhëna të përgjithshme**

| | |
|---|---|
| **Titulli i projektit** | *Studimi I nevojave për investime për ndërtimin e një thertoreje në Zonën funksionale të Lezhës dhe ngritja e saj* |
| **Tipi i projektit** | *Zhvillim ekonomik* |
| **Vendndodhja e projektit** | *Dajc, Blinisht, Kallmet, Ungrej, Balldre, Zejmen, Kolsh, Shen Koll, Lezhe, Shëngjin.* |
| **Buxheti total i paravlerësuar** | *400.000 Euro*[76] |

2. **Sfondi dhe analiza e problemit.**

Therrja e kafsheve në Zonën Funksionale Lezhë është e fragmentarizuar dhe ne nje mase te konsiderueshme kryhet ne ferme per konsum individual apo per tregun jo formal, ose kryhet në pika therje të cilat nuk zbatohjnë kërkesat e higjenës dhe ato mjedisore sipas legjislacionit në fuqi. Pikat e therjes kanë teknologji të vjeteruara dhe kapacitet të limituar therjesh.

Zbatimi korrekt i kontrollit zyrtar, për këto pika therjeje, nga institucionet publike përgjegjëse, do të sillte në kolapsin e këtij shërbimi në këtë zonë.

3. **Objektivi/at specifikë të projektit (maks. 4-5 rreshta)**

Objektivi i përgjithsëm i projektit është të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, të standardeve të higjenës dhe ato mjedisore të zonës nëpërmjet mbeshtetjes së një prej sektorëve prioritarë të saj si përpunimi i produkteve ushqimore me origjinë shatzore.

Objektivat specifikë janë;

- Të mbështesë futjen e sistemeve të cilësisë dhe sigurisë ushqimore në procesin e therjes së kafshëve për ushqim.
- Të përmirësoj trajtimin dhe menaxhimin e mbetjeve dhe nën produkteve me origjinë shtazore.

4. **Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit(maks. 5-6 rreshta)**

Nga ky projekt pritet të përfitojnë të gjitha njësitë vendore të Zonës funksionale (10); përfshirë ato të cilat tipikisht janë të specializuara në blegtori. Numri I popullsisë përfituese është ajo banuese në të gjithë territorin e Zonës; 102,792 banorë (sipas regjistrit civil 2011) ose 65,633 (sipas Census 2011). Thertorja do të ngrihet në një njësi e cila siguron akses për transportin e kafshëve nga të gjitha njësitë vendore të Zonës funksionale dhe do të përzgjidhet sipas kërkesës dhe suportit logjistik përreth saj.
Parashikimi i shperndarjes te kapacitetit te therrtores eshte sipas tabeles së meposhtme duke u bazuar ne llogaritjet e volumeve te aktivitetit për Zonën Funksionale sipas therrjes te derrave, vicave dhe qengjave.

Kapaciteti planifikuar i therrtores

| Pershkrimi | Kapaciteti ne dite | Dite pune ne vit | Kapaciteti ne vit |
|---|---|---|---|

[76] Ky buxhet nuk merr parasysh koston per funksionimin e thertores perfshire burimet njerezore te nevojshme

| | | | |
|---|---|---|---|
| Therrje vicash | 80 | 100 | 8,000 |
| Therrje derrash | 240 | 90 | 21,600 |
| Therrje qingjash | 300 | 80 | 24,000 |

**5. Aktivitetet e projektit (maks. 5-6 rreshta)**

Projekti I cili do të përfshijë studim dhe zbatim investimesh planifikohet të zgjasë 2 vjet. Aktivitetet janë:

4. Studim i fizibilitetit të zonës:

- Studim / analiza e tregut - përfshin vlerësim i mundësive të tregut në terma të shpërndarjes së produktit, cmimeve, logjistikës / kanaleve të tregut, tregëtimit / promovimit; (koha e nevojshme: 1 muaj; kosto: 5 mijë euro)
- Identifikimi i vendodhjes dhe projektimi i investimeve fizike – përcaktimi i specifikimeve teknike të infrastrukturës; (koha e nevojshme: 2 muaj; kosto: 20 mijë euro)
- Studime plotësuese – përfshin mbështetjen ligjore për realizimin e investimeve (krijimi i struktures menaxhuese) dhe analiza financiare e kostove dhe përfitimeve; (koha e nevojshme: 1 muaj; kosto: 5 mijë euro)

5. Punime dhe paisja me teknologji mbështetëse e thertores:

- Ndërtimi / rehabilitimi i infrastrukturës fizike – në varësi të gjetjeve të studimit të fizibilitetit; (koha e nevojshme: 16 muaj; kosto: 150 mijë euro)
- Paisja me teknologjinë e nevojshme përfshirë impiantin e trajtimit të mbetjeve- në varësi të gjetjeve të studimit të fizibilitetit; (koha e nevojshme: 12 muaj; kosto: 200 mijë euro)
- Asistenca teknike për zbatimin e *"HACCP"* (koha e nevojshme: 6 muaj; kosto: 20 mijë euro)

**6. Pjekuria e projektit (5-6 lines)**

Projekti përfshin hartimin e një studimi fizibiliteti për Zonën Funksionale Lezhë lidhur me nevojën për investim në ngritjen e një thertoreje. Projekti duhet të nisë me një studim fizibiliteti i cili mungon për këtë sektor dhe më pas do zhvillohet më tej nëpërmjet zbatimit të investimit dhe krijimit të strukturës institucionale që do ta menaxhojë  këtë thertore. Nëse studimi nuk hartohet paraprakisht, do hasen vështirësi në përcaktimin e vendndodhjes së duhur të thertores për të ofruar këtë shërbim për të gjithë territorin e Zonës Funksionale.

**7. Burimet e financimit dhe partnerët e zbatimit (maks. 3-4 rreshta)**

Burimet e financimit mund të jenë të diversifikuara; fonde  publike dhe private, nga buxheti Bashkisë së madhe, fondet e BE-se IPARD, etj.

Aktor i përshtatshëm për zbatimin e projektit mund të jetë Drejtoria Rajonale e Bujqësisë në bashkëpunim me Bashkinë e madhe.

**8. Kostot  e projektit (maks. 3-4 rreshta)**

Projekti mendohet të kushtojë 400.000 Euro

- Studim i fizibilitetit: 30 mijë euro;
- Punime dhe paisja me teknologji mbështetëse: 370 mijë euro;

## 5.4 Mbështetja për vreshtarinë dhe verën autoktone Kallmet

2. **Të dhëna të përgjithshme**

| | |
|---|---|
| **Titulli i projektit** | *Mbështetja e sektorit të vreshtarisë dhe vitikulturës dhe markës autoktone të verës Kallmet* |
| **Tipi i projektit** | ***Zhvillim ekonomik*** |
| **Vendndodhja e projektit** | *Sipas Tabelës 1* |
| **Buxheti total i paravlerësuar** | *400,000 euro* |

8. **Sfondi dhe analiza e problemit.** Një analizë e shkurtër e situatës që doni të ndryshoni duke shpjeguar nevojën për ketë projekt; a është projekti i harmonizuar me analizat e kryera gjatë përgatitjes së FAP[77]? **(maks. 10 rreshta)**

*Vreshtaria dhe prodhimi I verës janë një nga aktivitetet kryesore ekonomike për një pjesë të mirë të njësive të zonës funskionale, në vecanti zona e Zadrimës, përfshirë edhe njësitë e Kallmetit dhe fshatin e Kasnjetit të cilat kanë një traditë relativisht të gjatë në këtë sektor. Kjo zonë njihet edhe për varietetin autokton të rrushit Kallmet.*

*Në zonë ka disa prodhues të verës Kallmet, por madhësia mesatare e vreshtave është e vogël. Gjithashtu, fermerët nuk i kanë gjithmonë njohuritë teknike të përshtatshme për kujdesin e vreshtave që të sigurojnë cilësinë, moskontaminimin (i.e. përdorimi I pesticideve); si edhe rendiment të mirë të vreshtave. Si rezultat, cilësia e verës së prodhuar ka luhatje të mëdha nga viti në vit, përtej luhatjeve si rezultat i faktorëve natyrorë të zakonshëm.*

*Mbështetja e këtij sektori është e një rëndësie të ndjeshme duke konsideruar edhe potencialin e trashëguar të njohurive dhe reputacionit të mirë të markës së verës prodhuar në këtë zonë, si dhe sipërfaqeve potenciale për zhvillimin e mëtejshëm të këtij aktiviteti.*

***Tabela 1[78]: Territori ku do të zhvillohet projekti:***

| ZF Lezhë Njësitë vendore | Sipërfaqja e Vreshtave (Ha) | Nr. i fermave me vreshta | Nr. i fermave me vreshta me sipërfaqe ≥0.1 Ha | Zona Kadastrale | Kodi i Zonës Kadastrale |
|---|---|---|---|---|---|
| Zejmen | 19.80 | 66 | 21 | Zejmen | 3901 |
| | | | | Tresh | 3641 |
| | | | | Prull | 3063 |
| | | | | Berzan | 1168 |
| | | | | Pllan | 2995 |
| | | | | Markatomaj | 2604 |
| | | | | Spiten | 3502 |
| Shenkoll | 20.30 | 139 | 50 | Shënkoll | 3351 |
| | | | | Rilë | 3181 |
| | | | | Tale 1 | 3559 |
| | | | | Tale 2 | 3968 |
| | | | | Barbullojë | 1099 |
| | | | | Grykë Lumi | 1879 |
| | | | | Gajush | 1685 |

[77] FAP- akronimi në Anglisht i programit të Zonës Funksionale (Functional Area Programme).
[78] Të dhëna të marra nga Projekti *"EuropeAid/124908/C/SER/AL - Creation of a Vineyard Cadastre – Albania"*

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Balldren | 20.00 | 94 | 28 | Balldren | 1086 |
| | | | | Kakarriq | 2029 |
| | | | | Gocaj | 1783 |
| | | | | Balldren i Ri | 1087 |
| | | | | Torovice | 3615 |
| | | | | Malecaj | 2562 |
| Kallmet | 42.00 | 245 | 45 | Kallmet i Vogël | 2054 |
| | | | | Merqi | 2660 |
| | | | | | |
| | | | | | |
| Dajc | 34.00 | 172 | 42 | Dajç | 1434 |
| | | | | Gjadër | 1716 |
| | | | | Gramsh | 1843 |
| | | | | Mabë | 2544 |
| | | | | Dragush | 1533 |
| | | | | Kotërr | 2246 |
| | | | | Zojs | 3948 |
| Blinisht | 46.00 | 272 | 72 | Blinisht | 1220 |
| | | | | Troshan | 3650 |
| | | | | Fishtë | 1624 |
| | | | | Krajnë | 2263 |
| | | | | Piraj | 2964 |
| | | | | Baqël | 1096 |
| | | | | Kodhel | 2187 |
| **Total** | **182.10** | **988** | **258** | **-** | **-** |

### 9. Objektivi/at specifikë të projektit (maks. 4-5 rreshta)

*Objektivi i projektit është rritja e prodhimit dhe e cilësisë së markës autoktone duke zgjeruar aksesin në tregjet kombëtare dhe ato të huaja.*

*Objektivat specifikë të projektit janë:*

- *Ngritja dhe funksionimi i kadastrës së vreshtave për ZF (e cilësuar si zonë me tregues gjeografik të përcaktuar);*
- *Funksionimi brenda standardeve, të kantinave të miratuara të verës për këtë zonë si dhe përdorimi i praktikave të duhura oenologjike;*
- *Formalizimi i sektorit të prodhimit të verës në ZF, përmes strukturimit të marrëdhënieve ndërmjet prodhuesve të vreshtave dhe kantinave të verës dhe krijimit të "clusterit" përkatës;*
- *Promovimi i vlerave tradicionale të ZF, përmes promovimit të Markës autoktone të verës, regjistrimin dhe mbrojtjen e treguesve gjeografike, dhe regjistrimin dhe mbrojtjen e origjinës.*

### 10. Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit (maks. 5-6 rreshta)

Përfituesit direktë të projektit janë fermerët e ZF. Aktualisht në ZF lezhë ka rreth 190 HA të mbjellë me vreshta dhe dy kantina kryesore të prodhimit të verës (Kallmet, Gjok Gjini). Të gjitha fermat në zonën e Lezhës përdorin plehërim (ndër to një përqindje shumë e ulët pleh kimik) dhe rreth 55% e fermave përdorin pesticide. Në total, projekti ka potencialin t'I shërbejë në mënyrë direkte rreth 988 fermave me vreshta në gjashtë njësi përbërëse të ZF-së (popullsia 12,900 banorë ose 20% e ZF-së). Megjithatë, ndërhyrja synon zgjerimin e sektorit të vreshtarisë dhe rritjen e vleres së shtuar të produkteve.

Rezultate të pritshme:

- Rritje e sipërfaqes së kultivuar me vreshta në rreth 400 HA për nje periudhë pesëvjecare;
- Përdorimi i fidanëve të kontrolluar dhe autoktonë për të siguruar cilësinë e produkteve, regjistrimin dhe mbrojtjen e treguesve gjeografike, dhe regjistrimin dhe mbrojtjen e origjinës;
- Rritje e rendimentit dhe cilësisë së produktit bazë nëpërmjet bashkëpunimit të fermerëve dhe trajnimit të tyre;
- Regjistrimi dhe njohja e Markës së Verës Kallmet dhe depërtimi në tregjet kombëtare dhe të huaja.

**11. Aktivitetet e projektit (maks. 5-6 rreshta)**

Projekti i cili do të përfshijë mbështetje teknike dhe zbatim investimesh planifikohet të zgjasë 20 muaj, dhe aktivitetet e parashikuara janë:

6. Studim i fizibilitetit të zonës dhe krijimi i kadastrës:

- Studim i statusit / krijim i kadastrës së vreshtave në ZF – që përfshin i) identifikimin e parcelave të vreshtave[79] dhe ii) përshkrimin e parcelës së vreshtave[80]; (koha e nevojshme: 6 muaj; kosto: 35 – 40 mijë euro)
- Studim / analiza e mundësisë - përfshin vlerësimin e: mundësive prodhuese të fermave, mundësive distiluese të kantinave, cmimeve, logjistikës / kanaleve të tregut, tregtimit / promovimit; (koha e nevojshme: 1 muaj; kosto: 10 – 15 mijë euro)
- Identifikimi i fermerëve / grupimeve të fermerëve që mund të përfshihen në *"Cluster"* dhe intensifikimit të prodhimit (takime, grupe pune , evente te tjera, vizitë studimore); (koha e nevojshme: 3 muaj; kosto: 5 - 10 mijë euro)
- Identifikimi i vendodhjes dhe projektimi i investimeve fizike – përcaktimi i specifikimeve teknike të infrastrukturës ndihmëse të vreshtave; (koha e nevojshme: 2 muaj; kosto: 10 – 15 mijë euro)
- Studime plotësuese – përfshin mbështetjen ligjore për realizimin e investimeve (krijimit të *"Cluster"*) dhe analiza financiare e kostove dhe përfitimeve; (koha e nevojshme: 2 muaj; kosto: 15 - 20 mijë euro)

7. Punime në infrastrukturën ndihmëse të vreshtave:

- Ndërtimi / rehabilitimi i infrastrukturës fizike (ujitje/kullim/infrastrukture ndihmese për grumbullimin/ – në varësi të gjetjeve të studimit të fizibilitetit; (koha e nevojshme: 12 muaj; kosto: 100 - 150 mijë euro)
- Mbështetje me fidanë cilësorë autoktonë dhe materiale të tjera për prodhim të tilla si produkte organike të mbrojtjes së bimëve; (koha e nevojshme: 8 muaj; kosto: 50 – 80 mijë euro)
- Asistenca teknike për zbatimin e praktikave të mira të kultivimit dhe oenologjike (koha e nevojshme: 8 muaj; kosto: 20 – 25 mijë euro)

8. Marketim dhe promovim i iniciativës dhe produkteve:

- Pjesëmarrje në panaire dhe takime "B2B" (koha e nevojshme: 4 - 5 takime gjatë fazës së dytë të zbatimit; kosto: 20 - 30 mijë euro)

[79] Identifikimi është procesi për të gjetur çdo parcelë të vreshtave në hartat bazë të referencës. Një hap i parë ku prodhuesit deklarojnë identifikimin kadastral të vreshtit të tyre në pronësi e cila verifikohet nga lokacioni në hartat kadastrale dhe ortofoto. **Kjo procedurë nënkupton se hartat kadastra rurale vihen në dispozicion të këtij projekti nga MBZHRAU**.

[80] Përshkrimi i vreshtit konsiston në plotësimin e një formulari regjistrimi që përmban të dhëna për vreshtin (dmth. të dhëna kadastrale, identifikimin e hardhisë-bimës që rritet, zona, varietetit të rrushit, sistemit të kultivim etj.)

- Përgatitje dhe shpërndarje e materialeve promovuese (koha e nevojshme: gjatë fazës së dytë të zbatimit; kosto: 10 - 15 mijë euro)

**12. Pjekuria e projektit (5-6 lines)**

Projekti nuk paraprihet nga ndonjë studim fizibiliteti dhe është ende në fazë koncepti. Një variant i këtij projekti është konceptuar që me RDP-në, e cila këshillon edhe aktivitete për njohjen e markave. Përllogaritja e kostove është e përafërt; kostot rriten në përpjesëtim me thellësinë e ndërhyrjeve. Një nevojë e domosdoshme për realizimin e këtij projekti është vënia në dispozicion të tij të hartave kadastra rurale nga MBZHRAU.

**13. Burimet e financimit dhe partnerët e zbatimit (maks. 3-4 rreshta)**

Aktorët kryesorë zbatues janë Drejtoria Rajonale e Bujqësisë; Bashkia Lezhe (ZF). Kantinat e verës dhe fermeret e zonës mund të kenë interest të drejtpërdrejtë në projekt si përfitues të drejtpërdrejtë.

Burimet e financimit mund të jenë buxheti i shtetit dhe i bashkisë; si edhe skema IPARD (në këtë rast aplikantët duhet të jenë kantinat e prodhimit të verës dhe fermeret).

**14. Kostot e projektit (maks. 3-4 rreshta)**

- Studim i fizibilitetit të zonës dhe krijimi i kadastrës: 75,000 – 100,000 euro
- Punime në infrastrukturën ndihmëse të vreshtave: 170,000 – 255,000 euro
- Marketim dhe promovim i iniciativës dhe produkteve: 30,000 – 45,000 euro

***Kostot totale të projektit: 275 - 400 mijë euro***

## 5.5 Itinerari ciklistik përgjatë Drinit të Vjetër

1. **Të dhëna të përgjithshme**

| | |
|---|---|
| **Titulli i projektit** | *Projektimi i një itinerari ciklistik përgjatë Drinit të Vjetër, duke lidhur Zadrimën - Lezhë- Shëngjin (vazhdim i itenerarit te bicikletave/projekti Dajcit B.Bunes "Living the River")* |
| **Tipi i projektit** | *Zhvillim Ekonomik* |
| **Vendndodhja e projektit** | *Balldre, Dajc, Blinisht , Kallmet, Lezhe, Shëngjin* |
| **Buxheti total i paravlerësuar** | *300.000 Euro* |

2. **Sfondi dhe analiza e problemit.** Një analizë e shkurtër e situatës që doni të ndryshoni duke shpjeguar nevojën për ketë projekt; a është projekti i harmonizuar me analizat e kryera gjatë përgatitjes së FAP[81]? **(maks. 10 rreshta)**

ZF Lezhë karakterizohet nga mungesa e një qasjeje të koordinuar dhe të integruar të ofertës turistike; koncepte dhe produkte turistike *(turizem agro/eko/natyre/deti)* jo mjaftueshmërisht të zhvilluara; vizibilitet/integrim i ulët në iteneraret turistike kombëtare/ndërkombëtare; inventarizim i dobët i resurseve të veta turistike dhe mirëmbajtje/menaxhim i dobët i tyre; mungesa infrastrukturore të në mbështetje të turizmit *(rrugë, sinjalistikë, argjinatura lumenjsh etj);* pamundësi e shfrytëzimit të plotë e racional të pasurisë ujore; menaxhim i dobët i faktorëve që do dëmtonin qëndrushmërinë e turizmit në zonë *(psh ndertime pa leje, kaosi hidraulik në zonën e lumit, varfërimi i biodiversitetit, degradimi i zonave të mbrojtura Kune-Vain, dëmtimi formacioneve e drurëve pyjor dhe përkeqësimi i habitateve, erozioni etj.)* Projekti i itinerarit ciklistik përgjatë Drinit të Vjetër do të kontribuojë në; konceptimin e një produkti turistik të diversifikua *(turizëm eko/agro/natyrë/det);* në mobilizimin e aktorëve lokale për adresimin e rreziqeve të sipërpërmendura; organizmin e një rrjeti të larmishëm operatorësh turistikë qe do duan të integrohen; dhe rritjen e vizibilitetit të ZF në ofertën ndër/kombëtare turistike.

**Objektivi/at specifikë të projektit (maks. 4-5 rreshta)**

Disa nga objektivat e projektit janë;

- **Ofrimi i një produkti turistik të konsoliduar, përmirësuar, të larmishëm dhe të integruar** në rrjete ndër/kombëtare
- **Mobilizimi, ndërgjegjësimi dhe rrjetëzimi i partnerëve** lokalë/rajonalë publikë e privatë në sektorin e turizmit dhe problematikat e tij
- **Përmirësimi i konkurrueshmërisë së rajonit** nëpërmjet përmirësimit të konkurrueshmërisë së SME-ve që operojnë në sektorin e turizmit/bujqësisë

15. **Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit(maks. 5-6 rreshta)**

- **Zhvillimi i** kapaciteteve lokalë (publike e private) në planifikim e zhvillim turistik
- **Rritja** e vizibilitetit të burimeve, produkteve turistike dhe operatorëve të turizmit përgjatë shtigjeve
- **Intensifikim i bashkëpunimit ndër lokal/rajonal (mes njësive Lezhë dhe Shkodër)**

[81]FAP- akronimi në Anglisht i programit të Zonës Funksionale (Functional Area Programme).

- **Adresimi paraparak i risqeve** që ndikojnë turizmin e qëndrushëm në zonë

**16. Aktivitetet e projektit (maks. 5-6 rreshta)**

Disa nga aktivitetet e projektit I cili planifikohet të zgjasë 2 vite janë;

- Themelimi I partneriteti rajonal mes aktorëve lokalë
- Identifikimi i itinerarit në terren dhe përmirësimi i kushteve fizike të infrastrukturës rrugore
- sistemimi I sinjalistikës
- Lidhja/integrimi me projektin/pistën ciklistike të ngjashme në Shkodër (Living the River Buna)
- aktivitete promovuese/marketimi/informimi e ndërgjegjësimi

**17. Pjekuria e projektit (5-6 lines)**

Projekti është pjesë e bazës se projekteve të ideuara nga Programi RDP për Lezhën dhe vazdimësi e një projekti të ngjashëm në Shkodër - Dajc. Në këtë të fundit programi RDP ka financuar tashmë projektin Living the River Buna në kuadër të të cilit është zhvilluar nje product turistik I konsoliduar dhe integruar (disa shtigje ciklistike, parkingje falas, ndalesa në vende të caktuara me interes natyror/kulturor/historic, pika promovimi dhe shitjeje prod bujqësore/blegtorale /artizanale karakteristike të tonave përreth). Projekti mund të përfitojë nga eksperienca e mëparshme dhe të zbatohet më me lehtësi në Lezhë duke ndjekur modelin e Shkodrës. Projekti inicion një proces të rëndësishëm paraprak të adresimit të problematikave madhore përgjatë lumit dhe zonave përreth nga ana aktorëve lokalë. Është menduar të konceptohet një strukturë institucionale e konsoliduar, gjithëpërfshisrëse dhe me përgjegjësi të qarta për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e projektit. Ajo do jetë përgjegjëse edhe për monitimin vazhdueshëm (edhe pas zbatimit të proj) të situatës, faktorëve që rrezikojnë qëndrueshmërinë e tij dhe ndërgjegjësimin e komunitetit për mirëmbajtjen e tij.

**18. Burimet e financimit dhe partnerët e zbatimit (maks. 3-4 rreshta)**

Burimet e financimit mund të jenë të diversifikuara; fonde lokale publike ose/dhe private, programe të ndryshme të BE-se ( psh IPA), grante si DLDP, etj.

Aktor I përshtatshëm për zbatimin e ketij projekti është Bashkia e Madhe, njësitë lokale përbërëse në bashkëpunim me OJF të zonës.

**19. Kostot e projektit (maks. 3-4 rreshta)**

- Identifikimi i itinerarit në terren dhe përmirësimi i kushteve fizike të infrastrukturës rrugore (150.000)
- sistemimi I sinjalistikës (100.000)
- aktivitete promovuese/marketimi/informimi e ndërgjegjësimi (50.000 Euro)

## 5.6 Planifikimi në turizëm

1. **Të dhëna të përgjithshme**

| | |
|---|---|
| **Titulli i projektit** | *Hartimi I instrumenteve të planifikimit të territorit në zonën turistike bregdetare* |
| **Tipi i projektit** | ***Zhvillim ekonomik**/Turizëm/shërbime publike* |
| **Vendndodhja e projektit** | *Lezhë, Shëngjin, Shënkoll* |
| **Buxheti total i paravlerësuar** | *105,000 euro* |

1. **Sfondi dhe analiza e problemit.** Një analizë e shkurtër e situatës që doni të ndryshoni duke shpjeguar nevojën për ketë projekt; a është projekti i harmonizuar me analizat e kryera gjatë përgatitjes së FAP[82]? **(maks. 10 rreshta)**

*Turizmi është një nga sektorët prioritarë të zhvillimit të ZF Lezhë, e cila përfshin disa destinacione të turizmit bregdetar me relevancë kombëtare në territorin e Shëngjin dhe Shënkollit. Potenciali turistik I këtyre zonave nuk është realizuar ende, në mungesë të infrastrukturës së përshtatshme pritëse, përfshirë struktura hoteliere, rrjete shërbimi të integruara dhe infrastrukturë transporti e sinjalistikë të përshtatshme. Shëngjini ka një masterplan të miratuar nga autoritetet kompetente dhe Shënkolli ka tashmë një plan në proces; por gjykohet se është e nevojshme që e gjithë zona të studiohet në kompleksitet si zonë bregdetare dhe në kontekstin e flukseve të pritshme e zhvillimit të sektorëve mbështetës.*

*Pjesa më e madhe e turistëve në zonë janë ditorë, cka bën që të ardhurat e gjeneruara në nivel vendor të jenë modeste në krahasim me potencialin, ndërkohë që barra mbi shërbimet lokale është pothuajse e njëjtë. Ndërkohë që në Shëngjin janë zhvilluar pak hotele dhe shtëpi pritëse, Shënkolli mbetet ende I pazhvilluar dhe I orientuar më shumë drejt bujqësisë pavarësisht vijës bregdetare të bukur që ka. Trysnia e zhvillimit pritet të vijë shumë shpejt drejt kësaj zone, pas zhvillimit të Velipojës në veri dhe Lalzit në jug. Është përgjegjësi e sektorit publik t'i paraprijë këtij zhvillimi nëpërmjet hartimit të instrumenteve të përshtatshme të planifikimit vendor të cilat do të orientojnë zhvillimin drejt një modeli të qëndrueshëm.*

2. **Objektivi/at specifikë të projektit (maks. 4-5 rreshta)**

***Objektivi i projektit është orientimi I zhvillimit të turizmit drejt një modeli të qëndrueshëm që i jep frymëmarrje sektorit privat dhe krijon hapësira e shërbime urbane moderne***

*Objektivat specifikë të projektit janë:*

- *Zhvillimi i turizmit sipas një vizioni të konsoliduar duke siguruar një platformë të qëndrueshme për garantimin e investimeve në këtë sektor;*
- *Arritja e standardeve të larta të jetesës dhe atyre social-kulturore për banorët e njësive të zonës funksionale dhe turistëve potencialë;*
- *Rritja e qëndrueshmërisë ekonomike të zonës si pasojë e diversifikimit të aktivitetit ekonomik efektiv;*

[82] FAP- akronimi në Anglisht i programit të Zonës Funksionale (Functional Area Programme).

3. **Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit (maks. 5-6 rreshta)**

*Rezultatet e pritshme janë:*

- *Krijohen instrumentet për lehtësimin e investimeve madhore në sektorin e turizmit*
- *Rritet vlera e shtuar e sektorit të turizmit në ekonomi si rezultat i ndryshimit të strukturës së brendshme të industrisë*

*Popullsia përfituese direkte është popullsia e Shëngjinit dhe e Shënkollit, rreth 33% e popullsisë totale të zonës, të cilët do të përfitojnë nëpërmjet:*

- *Rritjes së investimeve në zonë*
- *Modeli i turizmit të qëndrueshëm*
- *Punësim*
- *Shërbime më të mira publike*
- *Planifikimi i mirë i infrastrukturës vendore*
- *Rritje e të ardhurave nga turizmi*
- *Fuqizim i sektorëve mbështetës të turizmit (bujqësia, agroindustria, guida turistike etj).*

*Përfitues të tjerë janë edhe popullsia e gjithë ZF të Lezhës dhe komuniteti I biznesit.*

4. **Aktivitetet e projektit (maks. 5-6 rreshta)**

Projekti parashikohet të zgjasë rreth 18 muaj. Aktivitetet përfshijnë:

9. Studim i potencialit turistik të zonës dhe krijimi i platformës së politikave për zhvillimin e tij:

- Studim i potencialit turistik në njësitë e ZF – që përfshin: hartimin e projekt planit të zhvillimit të bregdetit dhe instrumenteve të kontrollit të përdorimit të tokës, hartimin e planit të përdorimit (koncesioneve) të plazheve, analizën e kostove për respektimin e standardeve të larta ekologjike, dhe vlerësimi afat-gjatë i potencialit të turizmit; (koha e nevojshme: 6 muaj; kosto: 20 mijë euro)
- Zhvillimi i një ofertë turistike e përfshirë në një destinacion turistik; (koha e nevojshme: 3 muaj; kosto: 10 mijë euro)

10. Investime në sistemin e menaxhimit të të dhënave :

- Krijimi dhe mbajtja e sistemit elektronik të grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave statistikore. Është i nevojshëm organizimi i mbledhjes dhe analizës së të dhënave statistikore sipas standardeve ndërkombëtare, përmes zbatimit të sistemit të të dhënave për numërimin e turistëve (Tourism Satellite Accounts–TSA). (koha e nevojshme: 8 muaj; kosto: 35 mijë euro)

11. Mbështetje e sektorit privat, marketim dhe promovim i iniciativës:

- Asistence për rritjen e nivelit të cilësisë në të gjitha strukturat akomoduese, si dhe përshtatjen me kriteret e kategorizimit sipas standardeve ndërkombëtare të cilësisë; (koha e nevojshme: 1 muaj; kosto: 5 mijë euro)

- Aktivitete promocionale në kërkim të rritjes së tregjeve dhe lobim për futjen e “markave” të njohura hoteliere ndërkombëtare; (koha e nevojshme: 1 muaj; kosto: 15 mijë euro)
- Edukimi i stafit drejtues dhe punonjësve në sektorin e turizmit; (koha e nevojshme: 1 muaj; kosto: 10 mijë euro)
- Përgatitje e projekteve në fushat e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale; (koha e nevojshme: 1 muaj; kosto: 5 mijë euro)
- Përgatitje e projekteve të restaurimit që adresojnë edhe cështjet e mbrojtjes së peizazhit dhe planeve të zhvillimit urban. (koha e nevojshme: 1 muaj; kosto: 5 mijë euro)

**5. Pjekuria e projektit (5-6 lines)**

Projekti është i gatshëm për t’u filluar. Në vetvete është një projekt përgatitës për zhvillimin e ardhshëm.

**6. Burimet e financimit dhe partnerët e zbatimit (maks. 3-4 rreshta)**

Aktori më I përshtatshëm për financimin e projektit është Bashkia Lezhë dhe/ose Ministria e Zhvillimit Urban. Aktorë zbatues përfshijnë edhe Agjencinë e Planifikimit të Territorit dhe Agjencinë e Bregdetit

**7. Kostot e projektit (maks. 3-4 rreshta)**

*Ky projekt pritet të kushtojë rreth 105 mijë euro bazuar në kontrata të ngjashme për hartimin e instrumenteve të planifikimit. Nuk ka sens të ndahet në kosto të veçanta për aktivitetet.*

## 5.7 Stacioni i transferimit të mbetjeve Lezhë

### 3. Të dhëna të përgjithshme

| | |
|---|---|
| **Titulli i projektit** | *Rritja e cilësisë së menaxhimit të mbetjeve dhe shtrirja e tij në një territor më të gjerë në ZF Lezhë* |
| **Tipi i projektit** | ***Shërbime publike*** |
| **Vendndodhja e projektit** | *ZF Lezhë* |
| **Buxheti total i paravlerësuar** | *1,16 milionë euro* |

20. **Sfondi dhe analiza e problemit.** Një analizë e shkurtër e situatës që doni të ndryshoni duke shpjeguar nevojën për ketë projekt; a është projekti i harmonizuar me analizat e kryera gjatë përgatitjes së FAP[83]? **(maks. 10 rreshta)**

Bashkia Lezhë dhe një pjesë e komunave të tjera përbërëse të ZF Lezhë ofrojnë shërbimin e pastrimit në nivele të ngjashme. Bashkia Lezhë (aktuale) ka aktualisht edhe një plan të menaxhimit të mbetjeve, ndërkohë që ky I fundit duhet të shtrihet edhe për zonat Është e nevojshme të bëhet shtrirja e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve dhe shtrirja e tij në një territor më të gjerë të qarkut Lezhë. Një plan i menaxhimit të mbetjeve për qarkun Lezhë është përgatitur gjithashtu me mbështetje IPA, ku parashikohen procedurat për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve; inventari i venddepozitimeve ekzistuese dhe gjendjes e nevojave për rehabilitim; si edhe mekanizmat e nevojshëm për rritjen e të ardhurave, ku veçohet nevoja për vazhdimin e mbledhjes së diferencuar të mbetjeve në zonën e Lezhës, si edhe një sistem grumbullimi në nivel qarku duke krijuar qendra transferimi për të ulur kostot.

### 21. Objektivi/at specifikë të projektit (maks. 4-5 rreshta)

*Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbetjeve në zonën e Lezhës, inkurajimi i mbledhjes së diferencuar dhe ndërtimi i një stacioni transferimi për uljen e kostove.*

*Përmirësimi i situatës mjedisore në zonën e Lezhës dhe respektimi i standardeve ligjore për menaxhimin e mbetjeve*

*Mbështetje për sektorin e turizmit*

### 22. Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit (maks. 5-6 rreshta)

*Përfituesit direktë të projektit është e gjithë popullsia banuese e ZF Lezhë (66536 banorë); si edhe vizitorët e shumtë gjatë periudhës së verës. Në mënyrë indirekte, projekti favorizon bizneset e Lezhës dhe sidomos ato të lidhura me turizmin.*

*Bashkia Lezhë është njëkohësisht zbatuese/partnere dhe përfituese e projektit.*

[83] FAP- akronimi në Anglisht i programit të Zonës Funksionale (Functional Area Programme).

**23. Aktivitetet e projektit (maks. 5-6 rreshta)**

Kohëzgjatja e projektit është 5 vjet dhe përfshin:

- Krijimin e të dhënave bazë për menaxhimin e integruar të mbetjeve për rrethin Lezhë (ekzistojnë për bashkinë Lezhë)
- Zgjerimi i planit vendor të menaxhimit të mbetjeve
- Shtrirja e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve përtej kufijve të sotëm të bashkisë Lezhë
- Studimi i fizibilitetit për stacionin e transferimit Lezhë
- Ndërtimi i stacionit të transferimit Lezhë
- Fushatë ndërgjegjësimi

**24. Pjekuria e projektit (5-6 lines)**

*Projekti është pjesërisht i pjekur. Koncept ideja vjen si rezultat i studimeve dhe planeve për menaxhimin e mbetjeve në rajonin e Lezhës (Lezhë/Shëngjin nga dldp; qarku Lezhë nga IPA), të cilat synojnë drejt mbledhjes së diferencuar dhe riciklimit si edhe nevojën për një stacion transferimi të mbetjeve për të ulur kostot për transport deri në landfill.*

*Projekti përfshin ndërtimin e një stacioni transferimi, i cili duhet të paraprihet me një studim fizibiliteti. Në varësi të rezultateve të studimit të fizibilitetit mund të ketë nevojë edhe për ndërtimin e rrugëve të aksesit.*

**25. Burimet e financimit dhe partnerët e zbatimit (maks. 3-4 rreshta)**

Financuesit e mundshëm të projektit janë buxheti i shtetit (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës) dhe IPA, për shkak të sensitivitetit të çështjeve mjedisore për EU. Bashkia mund të bashkëfinancojë nëpërjet përmirësimit të strukturës së të ardhurave dhe për fushatat e ndërgjegjësimit.

**26. Kostot e projektit (maks. 3-4 rreshta)**

- *Baza e të dhënave për mbetjet – 30 000 euro*
- *Zgjerimi i planit vendor të menaxhimit të mbetjeve – 30 000 euro*
- *Përmirësimi dhe shtrirja e shërbimit jashtë kufijve të bashkisë Lezhë/blerje pajisjesh, automjetesh – 200 000 euro*
- *Studimi i fizibilitetit për stacionin e transferimit Lezhë – 100 000 euro*

*Ndërtimi i stacionit të transferimit – 800 000 eur*

## 5.8 Mbështetja e sektorit të artizanatit si mudnësi për punësim dhe ekstension të turizmit

**4. Të dhëna të përgjithshme**

| | |
|---|---|
| **Titulli i projektit** | *Mbështetja e sektorit të artizanatit në ZF Lezhë* |
| **Tipi i projektit** | ***Zhvillim ekonomik*** |
| **Vendndodhja e projektit** | *ZF Lezhë/Zadrimë, Balldren* |
| **Buxheti total i paravlerësuar** | *50,000 euro* |

27. **Sfondi dhe analiza e problemit.** Një analizë e shkurtër e situatës që doni të ndryshoni duke shpjeguar nevojën për ketë projekt; a është projekti i harmonizuar me analizat e kryera gjatë përgatitjes së FAP[84]? **(maks. 10 rreshta)**

Familjet e zonës së Zadrimës dhe të rrethit të Lezhës kanë një traditë të gjatë në prodhimin e produkteve të artizanatit dhe dekorimit për përdorim vetjak por edhe për tregtim. Megjithatë, me kalimin e kohës tradita e dikurshme e prodhimit të veshjeve, qilimave, tekstileve të ndryshme apo drurit po fillon të vanitet pasi nuk ka mekanizma për të kaluar zanatin nga një brez te tjetri. Mbështetja e sektorit të artizanatit ka potencialin për të rritur të ardhurat; për të promovuar turizmin kulturor dhe për rritjen e punësimit.

**28. Objektivi/at specifikë të projektit (maks. 4-5 rreshta)**

*Objektivi kryesor i projektit është rigjallërimi I sektorit të artizanatit dhe krijimi I mundësive të reja për punësim dhe mbështetje të turizmit.*

**29. Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit (maks. 5-6 rreshta)**

Projekti mund të ketë përfitues direktë në 3 – 5 njësi të zonës së Lezhës. Numri I përfituesve direktë përcaktohet në varësi të madhësisë dhe llojit të ndërhyrjes. SI fillim këshillohet të fillohet trajnimi dhe promovimi I produkteve të artizanatit me një grup të rinjsh rreth 30 – 50 vetë. Mundësitë janë më të kufizuara në fillim të projektit duke pasur parasysh edhe nevojën për të gjetur mjeshtër artizanë me përvojë dhe të përkushtuar. Zhvillimi I sektorit të artizanatit mund të japë përfitime indirekte duke shtuar larminë e produktit turistik të zonës përtej diellit/rërës dhe turizmit kulturor/fetar.

**30. Aktivitetet e projektit (maks. 5-6 rreshta)**

***<u>Projekti mund të zgjasë për 6 muaj – 1 vit.</u>***

Aktivitetet përfshijnë:

- *Identifikimi i dizenjove autentike nga rrethi i Lezhës me qëllim që të promovohen asetet kulturore të zonës*
- *Trajnim formal dhe praktik i 30 – 50 të rinjve në artizanat (kryesisht tekstile). Trajnimi duhet të përmbajë edhe elemente të marketingut dhe aftësive të të bërit biznes*

[84] FAP- akronimi në Anglisht i programit të Zonës Funksionale (Functional Area Programme).

- *Mbështetja e të rinjve të trajnuar për krijimin e një shoqate/biznesi social; biznes plan dhe pajisjet dhe lëndën e parë fillestare për fillimin e punës. Mbështetja mund të shoqërohet edhe me asistencë për marketimin nëpërmjet krijimit të aksesit dhe lidhjeve me tregun (p.sh katalog i prodhimeve; hotelet kryesore, etj.)*

**31. Pjekuria e projektit (5-6 lines)**

*Nuk ka projekt të gatshëm. Planifikimi dhe zbatimi I aktiviteteve është relativisht I lehtë dhe nuk kërkon përgatitje të mëdha paraprake. Parakusht për fillimin e projektit është identifikimi dhe përzgjedhja nga aktorët lokalë I mjeshtërve artizanë të cilët e ushtrojnë aktivitetin edhe në ditët e sotme.*

**32. Burimet e financimit dhe partnerët e zbatimit (maks. 3-4 rreshta)**

Financues potencialë të projektit janë bashkia, buxheti I shtetit përmes skemave ndihmuese të punësimit dhe vetëpunësimit (SHKP); donatorë

Bashkia dhe/ose këshilli i qarkut duhet të ketë autorësinë e projektit, pa të cilin qëndrueshmëria e projektit mbetet e dobët. Përfshirja e aktorëve nga sektori privat (në segmente të tjera të zinxhirit të vlerës) mund të krijojë potenciale për efekt multiplikator të ndërhyrjes.

**33. Kostot e projektit (maks. 3-4 rreshta)**

1. *Identifikimi i produkteve tipike të artizanatit dhe i mjeshtërve artizanë – 10,000 euro*
2. *(Opsionale) Design/përshtatja e produkteve tipike me tendencat e kohës – modernizimi dhe marketimi i produkteve – 30,000 euro*
3. *Trajnimi i deri në 50 të rinjve për një periudhë 6 mujore – 15,000 euro*
4. *Krijimi i biznesit social dhe mbështetja për start-up – 25,000 euro*

## 5.9 Mbështetje për kultivimin e Ullirit dhe promovim i markës autoktone

5. **Të dhëna të përgjithshme**

| | |
|---|---|
| **Titulli i projektit** | *Mbështetja e kultivimit të Ullirit dhe rritja e sipërfaqeve të mbjella me këtë kulturë* |
| **Tipi i projektit** | ***Zhvillim ekonomik*** |
| **Vendndodhja e projektit** | *Balldren - Kallmet* |
| **Buxheti total i paravlerësuar** | *355,000 euro* |

34. **Sfondi dhe analiza e problemit.** Një analizë e shkurtër e situatës që doni të ndryshoni duke shpjeguar nevojën për ketë projekt; a është projekti i harmonizuar me analizat e kryera gjatë përgatitjes së FAP[85]? **(maks. 10 rreshta)**

*Prodhimi i ullirit dhe nënprodukteve të tij si një nga aktivitetet e subvencionuara ndjeshëm gjatë viteve të fundit, ka njohur një rritje edhe në raport me aktivitetet e tjera bujqësore të zhvilluara në ZF, dhe në vecanti në zonën e Balldrenit dhe Kallmetit të cilat kanë një traditë relativisht të gjatë në këtë sektor. Zona është e pasur në ullinj dhe sipërfaqja dhe nr. i rrënjëve të mbjella po rritet vit pas viti duke arritur në 55% të prodhimit në nivel qarku. Sipërfaqja në total e zonës e mbjellë me ullinj aktualisht është rreth 426 HA, ndërsa ajo në prodhim është 275 HA.*

*Pjesa më e madhe e pemëve të ullirit në prodhimin, janë shpërndarë për fermerët në bazë të Ligjit nr. 7501/2001, duke çuar kështu në një nivel të lartë të fragmentimit në sektorin, i cili ka penguar arritjen e ekonomive të shkallës për prodhimin e ullinjve me çmime konkuruese. Si rezultat i drejtpërdrejtë i këtij fragmentimit, edhe ullinjtë në prodhim nuk janë shërbim siç duhet; shumica e fermerëve nuk kryejnë ujitjen në formën e duhur, kontrollin e sëmundjeve apo shërbime të tjera. Metoda kryesore e mbledhjes së ullirit mbetet me mjete manuale ndaj produktiviteti nuk është rritur në të njëjtin ritëm me sipërfaqet mbjella dhe është ende më i ulët në krahasim me prodhuesit e tjerë të Mesdheut.*

35. **Objektivi/at specifikë të projektit (maks. 4-5 rreshta)**

*Objektivi i projektit është zgjerimi i mundësive të përdorimit të tokës për prodhimin e ullirit përmes rritjes së efektivitetit të kësaj veprimtarie.*

*Objektivat specifikë të projektit janë:*

- *Konsolidimi i sektorit të prodhimit të ullirit dhe nënprodukteve të tij përmes strukturimit të marrëdhënieve ndërmjet prodhuesve të ullirit dhe fabrikave të vajit apo prodhuesve të nënprodukteve të tjera, si dhe krijimit të "clusterit" përkatës;;*
- *Promovimi i vlerave tradicionale të ZF, përmes promovimit të Markës autoktone të vajit të ullirit, regjistrimin dhe mbrojtjen e treguesve gjeografike, dhe regjistrimin dhe mbrojtjen e origjinës.*

36. **Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit (maks. 5-6 rreshta)**

Përfituesit direktë të projektit janë fermerët e njësive të Balldren - Kallmet në ZF. Aktualisht në ZF lezhë ka rreth 190 HA të mbjellë me vreshta. Të gjitha fermat në zonën e Lezhës përdorin mbledhje me menyra

[85] FAP- akronimi në Anglisht i programit të Zonës Funksionale (Functional Area Programme).

manuale duke ulur ndjeshëm efektivitetin dhe cilësinë e produktit. Në total, projekti ka potencialin t'I shërbejë në mënyrë direkte në dy njësi përbërëse të ZF-së (popullsia 10,260 banorë ose 15.6% e ZF-së).

Rezultate të pritshme:

- Rritje e shfrytëzimit sipërfaqes së kultivuar me ulli në rreth 200 HA për një periudhë dyvjecare;
- Përdorimi i fidanëve të kontrolluar dhe autoktonë për të siguruar cilësinë e produkteve, regjistrimin dhe mbrojtjen e treguesve gjeografike, dhe regjistrimin dhe mbrojtjen e origjinës;
- Rritje e rendimentit dhe cilësisë së produktit bazë nëpërmjet bashkëpunimit të fermerëve dhe trajnimit të tyre;

**37. Aktivitetet e projektit (maks. 5-6 rreshta)**

Projekti i cili do të përfshijë mbështetje teknike dhe zbatim investimesh planifikohet të zgjasë 20 muaj, dhe aktivitetet e parashikuara janë:

12. Studim i fizibilitetit të zonës:

- Identifikimi i fermerëve / grupimeve të fermerëve që mund të përfshihen në *"Cluster"* dhe intensifikimit të prodhimit (takime, grupe pune , evente te tjera, vizitë studimore); (koha e nevojshme: 3 muaj; kosto: 5 - 10 mijë euro)
- Identifikimi i vendodhjes dhe projektimi i investimeve fizike – përcaktimi i specifikimeve teknike të fidanishtes dhe infrastrukturës ndihmëse të ullishtave; (koha e nevojshme: 2 muaj; kosto: 10 – 15 mijë euro)
- Studime plotësuese – përfshin mbështetjen ligjore për realizimin e investimeve (krijimit të *"Cluster"*) dhe analiza financiare e kostove dhe përfitimeve; (koha e nevojshme: 2 muaj; kosto: 5 - 10 mijë euro)

13. Punime në infrastrukturën ndihmëse:

- Ndërtimi / rehabilitimi i infrastrukturës fizike (ujitje/kullim/infrastrukture ndihmese për grumbullimin/ – në varësi të gjetjeve të studimit të fizibilitetit; (koha e nevojshme: 12 muaj; kosto: 50 - 100 mijë euro)
- Krijimi i një fidanishteje të tipit serë për rritjen e fidanëve cilësorë dhe autoktonë për rreth 100.000 fidanë me një sipërfaqe prej 1000 $m^2$; (koha e nevojshme: 12 muaj; kosto: 80 - 100 mijë euro)
- Mbështetje me fidanë cilësorë autoktonë dhe materiale të tjera për prodhim të tilla si produkte organike të mbrojtjes së bimëve; (koha e nevojshme: 8 muaj; kosto: 50 – 80 mijë euro)
- Asistenca teknike për zbatimin e praktikave të mira të kultivimit dhe mbrojtjes së ullishtave nga miza e ullirit (koha e nevojshme: 8 muaj; kosto: 10 – 15 mijë euro)

14. Marketim dhe promovim i iniciativës dhe produkteve:

- Pjesëmarrje në panaire dhe takime "B2B" (koha e nevojshme: 4 - 5 takime gjatë fazës së dytë të zbatimit; kosto: 10 - 15 mijë euro)
- Përgatitje dhe shpërndarje e materialeve promovuese (koha e nevojshme: gjatë fazës së dytë të zbatimit; kosto: 5 - 10 mijë euro)

**38. Pjekuria e projektit (5-6 lines)**

Projekti nuk paraprihet nga ndonjë studim fizibiliteti dhe është ende në fazë koncepti. Përllogaritja e kostove është e përafërt ndaj kostot rriten në përpjesëtim me thellësinë e ndërhyrjeve. Një nevojë e domosdoshme për realizimin e këtij projekti është mbështetja nga MBZHRAU.

**39. Burimet e financimit dhe partnerët e zbatimit (maks. 3-4 rreshta)**

Aktorët kryesorë zbatues janë Drejtoria Rajonale e Bujqësisë; Bashkia Lezhe (ZF).
Burimet e financimit mund të jenë buxheti i shtetit dhe i bashkisë; si edhe skema IPARD (në këtë rast aplikantët duhet të jenë kantinat e prodhimit të verës dhe fermeret).

**40. Kostot e projektit (maks. 3-4 rreshta)**

- Studim i fizibilitetit të zonës: 20,000 – 35,000 euro
- Punime në infrastrukturën ndihmëse: 190,000 – 295,000 euro
- Marketim dhe promovim i iniciativës dhe produkteve: 15,000 – 25,000 euro

***Kostot totale të projektit: 225 - 355 mijë euro***

## 5.10 Ndërtimi I terminalit të transportit ndërurban në hyrje të Lezhës

**6. Të dhëna të përgjithshme**

| | |
|---|---|
| **Titulli i projektit** | *Terminali I transportit ndërurban Lezhë* |
| **Tipi i projektit** | ***Shërbime vendore*** |
| **Vendndodhja e projektit** | *Lezhë* |
| **Buxheti total i paravlerësuar** | *300 000 euro* |

41. **Sfondi dhe analiza e problemit.** Një analizë e shkurtër e situatës që doni të ndryshoni duke shpjeguar nevojën për ketë projekt; a është projekti i harmonizuar me analizat e kryera gjatë përgatitjes së FAP[86]? **(maks. 10 rreshta)**

Ky project synon dizenjimin e një sistemi eficient dhe efektiv të transportit publik duke përdorur autobusët dhe furgonër dhe infrastrukturën lidhëse me rrejtin rrugor (vendndalimet intermodale dhe sistemin e informacionit të pasagjerëve). Shërbimet e transportit publik do të lidhin Lezhën me qendrat kryesore të Tiranës, Durrësit dhe Shkodrës; si edhe me rajonin e Lezhës e në veçanti me destinacionet kryesore turistike (Shëngjin, Shënkoll, Velipojë).

Bashkia Lezhë ka identifikuar tashmë një terren të përshtatshëm për ndërtimin e terminalit të transportit publik, në hyrje të Lezhës, I cili mundëson akses të lehtë nga të gjitha pikat kyce të rrjetit rrugor. Terreni është në pronësi shtetërore, çka ul kostot e projektit.

**42. Objektivi/at specifikë të projektit (maks. 4-5 rreshta)**

Projekti synon:

- Konceptimin e një sistemi të besueshëm ndërurban kryesisht nëpërmjet autobusëve (dhe furgonëve)
- Njohjen e potencialit dhe promovimin e transportit publik nëpërmjet pikave të transferimit në terminal; sistemit të informacionit për pasagjerët
- Prëgatitjen e projektit (skicave) paraprake për vendndodhjen dhe skemën e stacionit terminal.

**43. Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit (maks. 5-6 rreshta)**

- *Popullsia e ZF (66536 banorë); bizneset e zonës; në vecanti sektori I turizmit*
- *Lehtësim I trafikut në nyjet kryesore të qytetit të Lezhës*

**44. Aktivitetet e projektit (maks. 5-6 rreshta)**

- Përshkrimi analitik i shërbimeve aktuale të transportit publik, përfshirë identifikimin e kërkesës

[86] FAP- akronimi në Anglisht i programit të Zonës Funksionale (Functional Area Programme).

- Identifikimin e pritshmërive të përdoruesve, nëpërmjet parametrave që influencojnë zgjedhjet e tyre
- Projeksione për të ardhmen për kërkesën për transport publik dhe konkurrencën nga metoda të tjera, duke pasur parasysh edhe planet për infrastrukturën
- Një propozim për terminalin, dizajnin dhe kapacitetin

**45. Pjekuria e projektit (5-6 lines)**

*Projekti është në vetvete një studim fizibiliteti, I cili do të ofrojë edhe një koncept paraprak për terminalin, që mund të përdoret për termat e references të ndërtimit të projektit.*

**46. Burimet e financimit dhe partnerët e zbatimit (maks. 3-4 rreshta)**

Aktori më I përshtatshëm për zbatimin e projekti është Bashkia Lezhë dhe/ose në bashkëpunim me donator.

**47. Kostot e projektit (maks. 3-4 rreshta)**

*Bazuar në kosto të projekteve të ngjashme, ky Project mund të ketë kosto rreh 250 000 – 300 000 euro.*

## 5.11 Ristrukturimi i Bashkisë Lezhë

1. **Të dhëna të përgjithshme**

| | |
|---|---|
| **Titulli i projektit** | *Ofrimi I asistences për hartimin e strukturës organizative për ZF Lezhë* |
| **Tipi i projektit** | *Administrata Vendore* |
| **Vendndodhja e projektit** | *Zona funksionale Dajc, Blinisht, Kallmet, Ungrej, Balldre, Zejmen, Kolsh, Shen Koll, Lezhe, Shëngjin* |
| **Buxheti total i paravlerësuar** | *30,000 Euro* |

1. **Sfondi dhe analiza e problemit.** Një analizë e shkurtër e situatës që doni të ndryshoni duke shpjeguar nevojën për ketë projekt; a është projekti i harmonizuar me analizat e kryera gjatë përgatitjes së FAP[87]? **(maks. 10 rreshta)**

Koncepti i zonës funksionale ishte në themel të reformës territoriale që u krye në Shqipëri gjatë vitit 2014 dhe që ka përcaktuar njësi të reja vendore më të mëdha dhe ka krijuar pritshmëri për një zhvillim më koherent dhe përdorim më eficient të burimeve të sektori publik, por edhe të shfrytëzimit të energjive të sektorit privat.

Në këtë kuadër njësitë vendore të reja që dalin pas kësaj reforme do të përballen me shumë sfida për komunitetet lokale që ata do të drejtojnë. Për tu përballur me mirë me nevojat dhe për ti përktyer ato në shërbime konkrete për komunitetitn kërkohet domosdoshmërisht harmonizimi I strukturave organizative me funksionet e njësive vendore, në këtë kuadër një rëndësi primare që në ditët e para të qeverisjes së njësisë merr ristrukturimi i tyre për tu përshatur me shërbimet që këto të fundit ofrojnë për komunitetin.

**2. Objektivi/at specifikë të projektit (maks. 4-5 rreshta)**

Objektivi i përgjithshëm i projektit është krijimi i një strukture organizative që ti përshtatet nevojave të komunitetit dhe të jetë në harmonizim të plotë me funksioniet e njësisë vendore dhe zonës funksionale.

<u>Objektivat specifikë janë;</u>

- Rritja e cilësine e shërbimeve duke krijuar një administratë në shërbim të qytetarëve, të shpejtë në ofrimin e shërbimeve dhe të saktë në përmbushjen e cdo përgjegjësie të ngarkuar.
- Përmbushja e objektivave të përcaktuara me ligj;
- Rritja e eficencës së përdorimit të burimeve financiare duke mënjanuar dublimet e funksioneve dhe përgjegjësive dhe reduktuar kostot e tepërta administrative.
- Përshkrime të sakta pune dhe regullore funksionimi.

**3. Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projekti t(maks. 5-6 rreshta)**

Nga ky projekt pritet të përfitojnë të gjitha njësitë vendore pjesë e Zonës funksionale dhe komunitetet e tyre. Projekti do të sigurojë:

- Ngritja e kapaciteteve të njësive vendore;
- Performancë e përmirësuar e strukturës vendore
- ndarje funksionale dhe vlerësimi përgjegjësish sektoriale
- eficencë në menaxhimin e burimeve financiare;

[87]FAP- akronimi në Anglisht i programit të Zonës Funksionale (Functional Area Programme).

**4. Aktivitetet e projektit (maks. 5-6 rreshta)**

Projekti do të strukturohet në faza të cilat do të përfshijënë një vlerësim paraprak të situatës menjehere pas kompozimit të njësisë së re vendore. Projekti parashikohet të zgjasë jo më shumë se 3 muaj dhe do të finalizohet me miratimin e strukturës dhe paketës regullatore pranë këshillit të njësisë.

Aktivitetet e projekti përfshijnë kryesisht;

- Vlerësimi i situatës aktuale të njësisë vendore dhe legjislacionit. Takime intensive me strukturat aktuale për të kuptuar pozicionin dhe rolin e tyre.
- Ngritja e grupit të punës me përbërje nga njësia vendore dhe ekspertë lokalë i cili duhet të drejtohet nga zv/kryetari i njësisë;
- Përcaktimi i detyrave të grupit dhe angazhimit të gjithëseicilit;
- Rekomandimet e para dhe hartimi i draftit të parë të strukturës organizative shoqëruar me efektet financiare (për cdo strukturë dhe pozicion);
- Finalizimi i strukturës organizative;
- Hartimi i projekt regullores me përshkrime e punës për cdo punonjës;
- Miratimi pranë Kryetarit
- Përgatitja e p/vendimit të strukturës, regullores shoqëruar me efektin ekonomik për tu prezantuar në KB.
- Miratimi.
- Vleresimi i kontratave ligjore qe trashegohen nga sherbimet dhe planifikimi i strutkures se re per organizimin e sherbimeve.

**5. Pjekuria e projektit (5-6 lines)**

Projekti është në harmoni me studimin e zonës funksionale Lezhë. AI mund të fillojë menjëherë pas konsolidimit të strukturave të reja vendore si një kërkesë imediate e njësive për të ushtruar funksionet e tyre dhe është I thjeshtë për t'u zbatuar si nga njësia vendore ashtu dhe ekspertët.

Projekti inicion një proces të rëndësishëm që lidhet me zhvillimin e mëtejshëm të njësisë vendore dhe është një kërkesë emergjente e tyre.

**6. Burimet e financimit dhe partnerët e zbatimit (maks. 3-4 rreshta)**

Për vetë kërkesën imediate dhe afatet kohore të reduktuara ky projeckt mund të mbështet me grante nga donator të ndryshëm si DLDP, etj. Projekti nuk kërkon financime të mëdha pasi është asistencë teknike e vendosur pranë njësisë vendore.

Projekti do të zhvillohet tërësisht pranë njësive vendore (zona funksionare)

**7. Kostot e projektit (maks. 3-4 rreshta)**

Buxheti I projektit detajohet në shpenzime për burimet njerëzore (konsulenca, shpenzime transporti, bazë materiale , trainime etj.

Struktura organizative – 12,000 euro
Vleresimi i struktures se sherbimeve dhe pasojave ligjore per ndryshimin e kontratave – 15,000 euro
Takime dhe kosto logjistike te tjera – 3,000 euro

## 5.12 Rritja e aksesit në Velë

1. **Të dhëna të përgjithshme**

| | |
|---|---|
| **Titulli i projektit** | *Permirsimi i aksesit rrugor Lezhë - Velë për gjenerimin e aktiviteteve turistike të një spektri të gjerë, duke ndikuar direkt dhe në zhvillimin potencial të 7 fshatrave të zonës Malesisë së Lezhës.* |
| **Tipi i projektit** | *Zhvillim Ekonomik* |
| **Vendndodhja e projektit** | *Kolsh (7 fshatra), Lezhë* |
| **Buxheti total i paravlerësuar** | *500,000 Euro* |

1. **Sfondi dhe analiza e problemit.** Një analizë e shkurtër e situatës që doni të ndryshoni duke shpjeguar nevojën për ketë projekt; a është projekti i harmonizuar me analizat e kryera gjatë përgatitjes së FAP[88]? **(maks. 10 rreshta)**

Mosvenia në eficencë e potencialeve turistike malore me një trashegimi të pasur vlerash është një nga problematikat e ZF Lezhë. Mali i madheshtor i Velës me lartësi dominuese në Lezhë (lartësi 1172 m mbi nivelin e detit) me pejsazh tërheqës gelqeror e i pasur me shpella karstike, i mbuluar me bore në periudhën e ftohtë, me brez pyjor me pishë të zezë (pyll natyral) në bazën e tij e bimësi të pasur medicinale, variacioni pejsazhist tërheqës, klima me theks alpin, burimet e ujore të pakrahasueshme, objektet më rendesi historike si shkolla e kisha, toponomia e pasur, kultivaret autokton te misrit gushtak të kultivuar nga komuniteti i fshatit të Velës si dhe i hardhise tajka, mbarshtimi i dhisë mbetën vlera të pamenaxhuara nga kendveshtrimi turistike veçanërisht nga mungesa e një aksesi rrugor. Qarkullojne gojedhena se ne Majen e Velës janë gjurmet (shenja ndryshku) ku janë lidhur anijet ne epoka të hereshme gjë që nxit kureshtaret për ta vizituar.

Projekti i përmirsimit të aksesit rrugor Lezhë - Velë do të kontribuojë në:

Pershirjen e produkteve turistike që ofron zona në inteneraret e paketat turistike, lidhjen me rrjetin e operatorë turistikë, rritjen e vizibilitetit të ZF në ofertën ndër/kombëtare turistike, gjenerimin e agroturizmit e aktivitetit bujqësor e blegtoral në tërësi në zonën e Malesisë së Lezhës si një mundesi potenciale zhvillimi, rikthimi i banoreve të larguar për kultivimin e tokave të lëna pas dore prej vitesh, përmirsimi i sherbimeve të komunitetit.

**Objektivi/at specifikë të projektit (maks. 4-5 rreshta)**

Disa nga objektivat e projektit janë;

- **Vënia në efiçencë e potencialeve turistike që ofron zona e Velës, gjallërimi i aktiviteteve që lidhen me keto asete. Rritja e vizibilitetit të produkteve turistike në nivel ndër/kombetar.**
- **Gjenerimi i aktiviteve bujqësore e blegtorale ne fshatrat e Malesisë së Lezhës, si një mundësi potenciale zhvillimi, orientimi nga agroturizmi. Rikthimi i të larguarve për venien në kulturë të tokave të abandonuara.**
- **Lehtesimi e përmirsimi sherbimeve të komunitetit që lidhen me transportin, aksesimit të shkollave, sherbimit të vorrezave, evadimi i mbetjeve, etj.**
- **Ruajtja e mjedisit natyror, shpallja e pejsazhit të Velës pejsazh i mbrojtur.**

[88]FAP- akronimi në Anglisht i programit të Zonës Funksionale (Functional Area Programme).

2. **Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit(maks. 5-6 rreshta)**

- **Përmirsimi i infrastrukturës rrugore Lezhës - Velë, gjallërimi i aktiviteteve turistike të shumllojshme që lidhen me asetet e zonës së Velës. Kapacitete lokale (publike e private) që e adresojnë e zhvillojnë interesin për investime ne ketë zonë.**
- **Venia ne prodhim e mjaft tokave të abandonuara, rritja e prodhimit dhe e perfitimeve ekonomike të komunitetit.**
- **Rritja e interesit të komunitetit për ndalimin e degradimit mjedisor në shumë aspekte.**
- **Përmrsimi i cilesisë së jetesës nëpërmjet përformimit të sherbimeve në një nivel më të lartë.**

3. **Aktivitetet e projektit (maks. 5-6 rreshta)**

Disa nga aktivitetet e projektit i cili planifikohet të zgjasë 2 vite janë;

- Projektimi për përmirsimin e aksesit rrugor Lezhë - Velë, 10 km e gjatë, e realizimi deri ne asfaltimin e pajisjen me të gjithë elementet që kërkon një rrugë automobilistike.
- Organizimi i aktiviteteve turistike si fillim me të rinjët e shkollave të mesme si ngjitje malore, shetitje, ski ne debore etj.
- Nxitja e eksplorimeve speleologjike dhe e aksesimit për turistet nëpermjet publikimeve, rrjeteve ne internet.
- Identifikimi i intinerareve të ngjitjes malore për në majen e Velës dhe realizimi i një sinjalistike për turet ngjitese.
- Aktivitete promovuese/marketimi/informimi e ndërgjegjësimi. (Organizimi i ëorkshopeve e trajnimeve me përfaqësues të komunitetit për të arritur ne produkte turistike si bujtina, shetitja me kuaj, agroturizmi, aktivitete ndergjegjesuese për mbrojtjen e mjedisit).
- Realizmi i të gjitha praktikave për propozimin e shpalljen e zonës së Velës, pejsazh i mbrojtur natyror.

4. **Pjekuria e projektit (5-6 lines)**

Projekti është produkt i shumë përpjekjeve e kontributeve të deritanishme për zhvilimin e zonës. Organizata Ëordvizion ka bere disa përmirsime në infrastrukturë që adresojnë problemin e ngritur në kete projekt. Shoqata mjedisore EIRLA ka realizuar projekte për evidentimin e vlerave natyrore e ndergjegjesimin e komunitetit për mbrojtjen e tyre, ka ndihmuar në përmirsimin e aksesit ndermjet fshatrave. Kisha katolike ka vendosur në majën e Malit te Velës shtatoren e Zojës, pasi disponon edhe vend pelegrinazhi.

Projekti inicion një proçes të rëndësishëm jo vetëm për zonën por në aspektin turistik shumë me gjerë, që ka të bëje me adresimin e problematikave madhore që lidhen me vënien në efiçëncë të aseteve të zonës, për ta rivenë ketë zonë në vemendjen e interesin e aktorëve lokalë dhe për aktivizuar potencialet zhvillimore të saj.

5. **Burimet e financimit dhe partnerët e zbatimit (maks. 3-4 rreshta)**

Burimet e financimit mund të jenë të diversifikuara; fonde lokale publike ose/dhe private, programe të ndryshme të BE-se ( psh IPA), grante si DLDP, etj.

Aktor I përshtatshëm për zbatimin e ketij projekti është Bashkia e Madhe, njësia lokale në bashkëpunim me OJF të zonës.

**6. Kostot e projektit (maks. 3-4 rreshta)**

- Projektimi e realizimi i infrastrukturës rrugore rreth 10 km e gjatë Lezhë (Grykë Manati) - Velë (500, 000 Euro)
- Aktivitete promovuese/marketimi/informimi e ndërgjegjësimi (30.000 Euro)

## 5.13 Ngritja e qendrës rinore

1. **Të dhëna të përgjithshme**

| | |
|---|---|
| **Titulli i projektit** | *Ngritja e Qendrës rinore* |
| **Tipi i projektit** | *Rinia dhe Sportet* |
| **Vendndodhja e projektit** | *Zona funksionale Dajc, Blinisht, Kallmet, Ungrej, Balldre, Zejmen, Kolsh, Shen Koll, Lezhe, Shëngjin* |
| **Buxheti total i paravlerësuar** | *50,000 Euro* |

1. **Sfondi dhe analiza e problemit.** Një analizë e shkurtër e situatës që doni të ndryshoni duke shpjeguar nevojën për ketë projekt; a është projekti i harmonizuar me analizat e kryera gjatë përgatitjes së FAP[89]? **(maks. 10 rreshta)**

Koncepti i zonës funksionale ishte në themel të reformës territoriale që u krye në Shqipëri gjatë vitit 2014 dhe që ka përcaktuar njësi të reja vendore më të mëdha dhe ka krijuar pritshmëri për një zhvillim më koherent dhe përdorim më eficient të burimeve të sektori publik, por edhe të shfrytëzimit të energjive të sektorit privat.

Të dhënat e Drejtorisë Rajonale Arsimore Lezhë tregojnë se në vitin 2014 në ZF zhvillojnë veprimtarinë e, 13 shkolla të arsimit të mesëm të përgjithshëm dhe 1 shkolle arsimit profesional. Numri i përgjithshëm i nxënësve është përkatësisht; 9020 në sistemin 9 vjeçar, 2724 në arsimin e mesëm dhe 559 në atë të mesëm profesional.

Në qytetin e Lezhës ofrohet edukim profesional nga shkolla **"Kolin Gjoka", e cila është** hapur për here të parë në shtator 2003. Shkolla i formon nxënësit në pesë profile kryesore: (ekonomi-biznes, administrim zyre, TIK, anglisht-frëngjisht dhe drejtimi pedagogjik). *53.9 përqind e nxënësve janë femra, megjithatë nga tabela mund të konstatohen lehtë stereotipet gjinore në shkollat profesionale. Kështu në degën TIK vetëm 13.9 përqind e nxënësve janë femra, ndërkohë që në pedagogji 94.6 përqind janë femra.*

Pjesëmarrja e të rinjve në vendimmarrje ende vazhdon të jetë një çështje e titullarëve të institucioneve si në nivelin qëndror ashtu edhe në atë vendor dhe jo detyrim ligjor ose administrativ për ta, duke bërë që herë të merret mendimi i të rinjve dhe herë të nënvlerësohet krejtësisht.

Aktualisht pushteti lokal po sensibilizohet në riaktivizimin e shërbimeve me bazë komunitare në përfitim të grupeve të ndryshme shoqërore, duke përdoruar asetet bashkiake për këto shërbime të cilat ju vijnë në ndihmë komuniteteve të tyre.

2. **Objektivi/at specifikë të projektit (maks. 4-5 rreshta)**

Objektivi i përgjithshëm i projektit është fuqizimi i grupeve lokale të veprimit të të rinjve në nëpërmjet ngitjes së strukturave të qëndrueshme për ofrimin e shërbimeve miqësore për ta si dhe nxitjes për t'u bërë pjesë e inisiativave komunitare me karakter edukativ e sensibilizues.

<u>Objektivat specifikë janë;</u>

[89]FAP- akronimi në Anglisht i programit të Zonës Funksionale (Functional Area Programme).

- Ngritja dhe jetësimi i 1 qëndre rinore duke ofruar shërbime miqësore për të rinjtë.
- Krijimi i dy grupeve lokale të veprimit me qëllim rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrje në bashkitë respektive.
- Promovimi i pjesëmarrjes së të rinjve në inisiativa konkrete që ndihmojnë bashkinë dhe komunitetin nëpërmjet organizimit të aktiviteteve me bazë komunitare.
- Nxitja e strukturave të pushtetit lokal, për ngritjen dhe fuqizimin e shërbimeve për të rinjtë si dhe përfshirjen e tyre në vendimarrje.

**3. Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projekti t(maks. 5-6 rreshta)**

Nga ky projekt pritet të përfitojnë të gjitha njësitë vendore pjesë e Zonës funksionale dhe komunitetet e tyre. Projekti do të sigurojë:

- Ngritja e Qëndrës Rinore:
- Përgatitja e një dokumenti për vlerësimin e situatës së të rinjve në këtë zonë
- Ngritja e shërbimeve miqësore për të rinjtë;
- Informimi i publikut kryesisht të rinjtë.
- 60 të rinj përfitues nga shërbimet në çdo qëndër
- Përcaktimi i kalendarit të aktiviteteve për qendrën.
- Organizimi i aktiviteteve me impakt në komunitet.

**4. Pjekuria e projektit (5-6 lines)**

Projekti është në harmoni me studimin e zonës funksionale Lezhë. AI mund të fillojë menjëherë pas konsolidimit të strukturave të reja vendore dhe sigurisht që do ndihmojë në përfshirjen e të rinjve.

Ky projekt do te krijojë lidhjet mes të rinjve, dhe komunitetit, i cili me anë të të rinjve në të ardhmen do të vazhdojë të marrë informacion për projekte të ndryshme të pushtetit lokal në këtë kuadër. Grupet e veprimit të të rinjve që do të krijohen do të vazhdojnë të shkëmbejnë informacion mes tyre, duke kthyer qëndrat sociale në një strukturë aktive në qytet. Qëndra rinore do të shërbejë si një pikë takime dhe aktivitetesh për njësinë vendore duke u mbështetur financiarisht nga njësia vendore por dhe me donacione.

**5. Burimet e financimit dhe partnerët e zbatimit (maks. 3-4 rreshta)**

Për vetë kërkesën imediate dhe afatet kohore të reduktuara ky projeckt mund të mbështet me grante nga donatore të ndryshëm si DLDP, por dhe nga buxheti I bashkisë e cila do të kontribuojë me ndërtesen ku do të akomodohet qëndra rinore.

Projekti do të zbatohet në bashkinë Lezhë dhe parashikon një hark kohor prej 9 muaj sipas një shtrirje të aktiviteteve në kohë.

**6. Kostot e projektit (maks. 3-4 rreshta)**

Kosto totale e projektit parashikohet në masën 50,000 euro dhe përfshin ndërhyrjet për punimet civile dhe mobilimin.

## 5.14 Festivali i Verës

- **Të dhëna të përgjithshme**

| | |
|---|---|
| **Titulli i projektit** | *"Dita e Verës (Ëine Day)"* |
| **Tipi iprojektit** | Aktivitete/ Evente kulturore/turistike |
| **Vendndodhja e projektit** | *ZF Lezhe/ Kallmet, Blinisht, Dajc, Hajmel, Bushat dhe Vau Dejes.* |
| **Buxheti total iparavlerësuar** | *15 000 € /vit* |

- **Sfondi dhe analiza e problemit.** Një analizë e shkurtër e situatës që doni të ndryshoni duke shpjeguar nevojën për ketë projekt; a është projekti i harmonizuar me analizat e kryera gjatë përgatitjes së FAP? **(maks. 10 rreshta)**

Kallmeti dhe Zadrima shquhet per prodhimet bujqesore kjo e favorizuar edhe nga pozita gjeografike, relievi kodrinor dhe fushore dhe pershkimi I ketiij territori nga lumi Drin. Nje nga prodhimet bujqesore per te cilet shquhet Kallmeti dhe Zadrima jane varietetet autoktone te rrushit dhe produkti kryesor I te cilit eshte vera. Prodhimi i veres ne menyre artizanale eshte lene pas disi pas dore kjo per arsye te ndertimit te disa kantina te Veres ne kete zone por edhe per arsye te emigrimit te krahut te punes. Gjate viteve 2007-2013 ne saje te subvencioneve ne bujqesi nga qeveria por edhe kthimit te shume emigranteve ka filluar mbjellja e vreshtave ne zonen e Kallmetit dhe Zadrimes duke rikthyer traditen e kultivimit varieteteve autoktone te rrushit dhe prodhimit te veres. Rikthimi i kesaj tradite por edhe te nje vetpunesimi te banoreve sjell nevojen e promovimit te ketyre produkteve dhe nxitjes se fermereve te tjere ne kultivimin e produkteve autoktone te rrushit dhe prodhimit te veres si nje menyre e zhvillimit ekonomik te qendrueshem te zones.

- **Objektivi/at specifikë të projektit (maks. 4-5 rreshta)**

*Objektivi kryesor I projekti eshte nxitja fermeve te zones ne kultivimin e varieteteve autoktone te rrushit dhe prodhimit te veres si dhe promovimi I produkteve te tyre si nje menyre e qendrueshme e zhvillimit te zones.*

- **Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit(maks. 5-6 rreshta)**

Nga realizimi I ketij projekti perfitojne fermeret e 3 njesive te zones se Lezhes dhe 3 te Bashkise Vau Dejes. Perfitues direkt te projektit jane 7 kantinat e ketyre njesive si dhe 50 ferme qe merren me prodhimin e veres ne menyre tradicionale. Fermeret do ndihmohem me fletepalosje informative rreth prodhimit te veres ne menyre tradicionale, ne krijimi te lidhjeve me kantinat e Veres ne menyre qe te sigurohet nje treg per produktet bujqesore te tyre si dhe publikimin e produkteve te tyre ne panairi e "Dites se Veres". Zhvillimi

i ketiij projekti do te ndikoje direkt ne perfitimet e fermereve pjesmarres ne aktivitet si dhe ne krijimi e nje aktiviteti te pervitshem, pjese e kalendareve te aktiviteve te Bashkise se Lezhes.

- **Aktivitetet e projektit(maks. 5-6 rreshta)**

  - *Hartimin e fletepalosjeve me informacione rreth varieteteve te rrushit dhe verave autoktone te Kallmetit dhe Zadrimes (cilesite, harta shtrirjes se vreshtave, sasia e vreshtave, vizioni per 10 vitet e ardhshme, menyre artizanale e prodhimit te veres dhe kapacitet e prodhimit te kantinave ekzistuese.)*
  - *Dita e Veres (Cdo Shtator)*
    - *Prezantim i varieteteve autoktone te rrushit dhe veres nga vajzat me veshje tradicionale te zones.*
    - *Prodhimi i veres ne menyre tradicionale (duke u shtypur me kembe) nga te rinjt me veshje tradiconale te zones.*
    - *Panair i prodhimeve te rrushit.*
    - *Konkurs i produkteve te veres nga juri profesioniste somelieresh dhe perfaqesues te Drejtorise se Bujqesise dhe ministrise se Bujqesise dhe Ushqimit*
    - *Ceremoni e ndarjes se cmimeve*
    - *Koncert me grupet artistike te zones.*
    - *Buffet (prodhime tradicionale te zones)*
    - *I gjithe aktiviteti do te shoqerohet me muzike live*

- **Pjekuria e projektit (5-6 lines)**

*KOncepti per projektin eshte I gatshem dhe planifikimi dhe zbatimi I aktiviteteve eshte I lehte kjo ne saje te pervojave te ngjashme te komunes Kallmet dhe njesive te tjera pjesmarrese. Ky project lidhet edhe me projektet e tjera ne sektorin e bujqesise te parashikuara per ZF Lezhe.*

- **Burimet e financimitdhepartnerët e zbatimit (maks. 3-4 rreshta)**

Financues potencial te projektit jane Bashkia dhe donatoret.

Bashkia do te kete autoresine e projektit, kjo e parashikuar dhe e miratuar edhe ne PBA-ne e saj si nje menyre per te siguruar qendrueshmerine e saj edhe per vitet ne vazhdim. Gjithashtu do te synohet edhe sigurimi I mbeshtetjes se subjekteve ekonomik te fushes sic jane Kantinat e Veres si perfitues te drejtperdrejt te projektit.

- **Kostot e projektit(maks. 3-4 rreshta)**

- *Identifikimi i fermereve dhe kantinave te veres pjesmarres ne aktivitet ----- 2000 €*
- *Hartimi dhe printimi i 500 brushurave informuese* --- 1000 *€*
- *Panairi i "Dites se Veres" (Transport+tavolina+tendat etj) 5000 €*
- *Cmimet e Konkursit te Veres.----- 1000 €*
- *Koncerti dhe grupet artistike ----- 2000 €*
- *Buffet ----- 1000 €*
- *Media + Banderola + Njoftimet 1500 €*
- *KOsto personeli 1500 euro*

## *Aneks 1: Të dhëna mbi arsimin*

**Tabela 41 Statistika mbi arsimin në ZF (2014-2015)**

| Nr. | Emërtimi | Rrethi Lezhë | |
|---|---|---|---|
| | | **Publike** | **Private** |
| 1 | **Institucione** | **114** | **14** |
| **1.a** | Kopshte | 47 | 8 |
| **1.b** | Shkolla 9-vjeçare | 55 | 4 |
| **1.c** | Shkolla të Mesme të Përgjithshme | 11 | 2 |
| **1.d** | Shkolla të Mesme Profesionale | 1 | 0 |
| 2 | **Numri i klasave** | **476** | **75** |
| **2.a** | Kopshte | 81 | 20 |
| **2.b** | Shkolla 9-vjeçare | 394 | 42 |
| **2.c** | Shkolla të Mesme | 113 | 13 |
| 3 | **Numri i nxënësve** | **13806** | **1642** |
| **3.a** | Kopshte | 1893 | 452 |
| **3.b** | Shkolla 9-vjeçare | 8164 | 856 |
| **3.c** | Shkolla të Mesme të Përgjithshme | 3190 | 334 |
| **3.d** | Shkolla të Mesme Profesionale | 559 | 0 |

**Tabela 42 Punonjës në sektorin e arsimit (2014-2015)**

| Nr. | Emërtimi | Rrethi Lezhë | |
|---|---|---|---|
| | | **Publike** | **Private** |
| 1 | **Numri punonjësve** | **896** | **129** |
| **1.a** | Edukatorë Kopshti | 93 | 23 |
| **1.b** | Mësues shkolla 9-vjeçare | 527 | 51 |
| **1.c** | Mësues shkolla të Mesme | 196 | 28 |
| **1.d** | Punonjës ndihmës | 80 | 27 |

*Burimi: Drejtoria Rajonale e Arsimit, https://app.box.com/s/ekvyrucijkh874ffa5iq*

**Tabela 43 Numri i nxënësve sipas klasave dhe programeve të veçanta**

| | 2014-2015 | I | II | III | IV | V | VI | VII | VIII | IX | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | Shansi i dytë | 29 | 19 | 16 | 27 | 13 | 14 | 12 | 7 | 10 | 147 |
| **2** | Romë | 7 | 13 | 5 | 4 | 9 | 14 | 6 | 4 | 0 | 62 |
| **3** | Egjiptian | 28 | 24 | 18 | 24 | 18 | 17 | 14 | 17 | 17 | 177 |
| **5** | Ardhur nga jashtë shtetit | 2 | 5 | 5 | 5 | 4 | 6 | 3 | 3 | 3 | 36 |
| **6** | Me AK në shkolla normale | 8 | 10 | 4 | 5 | 6 | 10 | 5 | 5 | 4 | 57 |
| **6.1** | AK fizike | 3 | 6 | 2 | 2 | 3 | 5 | 3 | 3 | 3 | 30 |
| **6.2** | AK Mendore | 5 | 4 | 2 | 3 | 3 | 5 | 2 | 2 | 1 | 27 |
| | | | | | | | | | | | |

*Burimi: Drejtoria Rajonale e Arsimit, https://app.box.com/s/mgxapurq5q95te1qfh0p*

## Aneks 2: Të dhëna mbi infrastrukturën rrugore dhe ujësjellësit

**Tabela 44 Rrugët e Financuara nga FSHZH në ZF Lezhë (2005-2013)**

| Nr. | NJQV | Emërtimi i Objektit | Popullsia Përfituese | Gjatësia e Investimit në KM | Vlera e Investimit (në lekë) |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Balldre | Asfaltim I rrugës së fshatit Koljakaj | 310 | 6.06 | 13,928,400 |
| 2 | Ungrej | Ndërtim rruge Rrazë-Kalivac | 600 | 3.10 | 13,951,320 |
| 3 | Kallmet | Rikonstruksion rruga Superstradë-Kallmet | 5,500 | 1.09 | 10,430,436 |
| 4 | Kallmet | Rehabilitimi i rrugës Lezhë-Kallmet | 6,892 | 12.80 | 339,133,507 |
| 5 | Kallmet | Rikonstruksioni i rrugës Kallmet-Nënshat | 9,032 | 8.74 | 211,357,259 |
| 6 | Shenkoll | Rikonstruksioni I rrugës lidhëse Lezhë-Rrilë-Shënkoll | 6,125 | 8.00 | 292,186,407 |
| 7 | Bashkia Lezhë | Rikonstruksioni I rrugës Lezhë-Kala-Lagje Sheher | 27,224 | 2.70 | 194,780,460 |
| 8 | Shenkoll | Rikonstruksion I rrugës Shën Koll-Tale-Hidrovor | 6,027 | 6.20 | 135,864,284 |
| 9 | Dajc, Blinisht | Rikonstruksioni I rrugës Kodhel-Dajc-Blinisht | 3,138 | 7.50 | 217,412,376 |
| 10 | Shëngjin | Rikonstruksioni I rrugës Shëngjin-Kune | 11,487 | 5.30 | 251,880,444 |
| 11 | Kallmet,Ungrej | Rikonstruksioni i rrugës Kallmet i Vogël-Ungrej | 4,177 | 7.60 | 265,562,179 |
| 12 | Bashkia Lezhë | Rikonstruksioni i rrugës Kodër Marlekai | 8,000 | 2.10 | 73,832,693 |

**Tabela 45**Investimet sipas burimeve të financimit në rrjetin rrugor (2012) ***(në mijë lekë)***

| | Projekti | Investitori | Shpenzimet |
|---|---|---|---|
| | **Investime nga buxheti i Shtetit** | | |
| 1 | Ndërtim Ujësjellësi në fshatin Fishtë | Komuna Blinisht | 3,920 |
| 2 | Ndërtim Ujësjellësi në fshatin Shënkoll | Komuna Shënkoll&FZHSH | 10,000 |
| 3 | Ndërtim Ujësjellë fshati Tresh | Komuna Zejmen | 1,680 |
| 4 | Ndërtim Ujësjellë fshati Spiten | Komuna Zejmen | 975 |
| 5 | Ndërtim Ujësjellë fshati Lagja Fidane | Komuna Zejmen | 2,590 |
| 6 | Ndërtim i rrugësKalasë Lezhe | FZHSH | 17,460 |
| 7 | Ndërtim i rrugës lagjja Gurra-Spital | Bashkia Lezhë | 40,425 |
| 8 | Rikonstruksion I shëtitores qytetit Shëngjin | Komuna Shëngjin | 15,252 |
| 9 | Asfaltim i rrugës Stom fshati I. Shëngjin | Komuna Shëngjin | 21,193 |
| 10 | Asfaltim rruga fshatit Fishte | Komuna Blinisht | 3,250 |
| 11 | Asfaltimi rrugës Pllanë-Superstradë (faza2) | Komuna Zejmen | 8.050 |
| 12 | Rik.asfaltimi rrugës Tresh-Superstradë | Komuna Zejmen | 7,467 |
| 13 | Rik.Rruge Kallmet-Kisha Shën Eufemisë | Komuna Kallmet | 23.334 |
| | **Investime nga të ardhurat** | | |
| 1 | Rik.rruge lidhëse dhe shëtitoresShëngjin (garanci) | Komuna Shëngjin | 116 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **2** | Rik rrugës Gj.Ivani I. ShëngjinShëngjin (garanci) | Komuna Shëngjin | 153 |
| **3** | Rik. Rrugësh fshati I. Shëngjin | Komuna Shëngjin | 1,005 |
| **4** | Asfaltimi rrugësI. Shëngjin-Hidrovor | Komuna Shëngjin | 2,170 |
| **5** | Rikon. rruge Zemra e Katundit I. Shëngjin (garanci) | Komuna Shëngjin | 245 |
| **6** | Te tjera investime ne rruge & garanci | Komuna Shëngjin | 47 |
| **7** | Rik rrugës Zef Martini (garanci) | Komuna Shëngjin | 81 |
| **8** | Ndërtim vepra arti rrugës Rras-Kalivaç | Komuna Ungrej | 2,500 |
| **9** | Ndërtim ure me dy kalime | Komuna Kolsh | 450 |
| **10** | Hapje rrugësh pyjore | Komuna Kolsh | 479 |
| **11** | Rip rrugësh komunale | Komuna Kolsh | 477 |
| **12** | Rehabilitim i rrugës Mabe-Dragushe | Komuna Dajc | 1,500 |

**Tabela 46 Investimet sipas burimeve të financimit në rrjetin rrugor (2013) (në mijë lekë)**

| | Projekti | Investitori | Shpenzimet |
|---|---|---|---|
| | **Investime nga buxheti i Shtetit** | | 46,658 |
| **1** | Rikonstruksioni rrugës Barbulloje | FZHR & K. Kolsh | 7,727 |
| **2** | Rikonstruksioni Shëtitores qyteti Shëngjin | Komuna Shëngjin | 15,252 |
| **3** | Asfaltim i rrugës Balldre-Torovice | Komuna &FZHR | 22.800 |
| **4** | Asfaltim rruga Tresh garanci punimesh | Komuna Zejmen | 879 |
| | **Investime nga të ardhurat** | | 22,113 |
| **1** | Sistemim rruge lagjen N.Tereza | Bashkia Lezhë | 6,902 |
| **2** | Rik.rruge i Shëngjin-Stom | Komuna Shëngjin | 6,739 |
| **3** | Rik.rruges kashte Kuqe fsh.I.Lezhe | Komuna Shëngjin | 703 |
| **4** | Rikonstruksion i rrugësShkollës Mesme | Komuna Kallmet | 2,629 |
| **5** | Ndërtim vepra arti rruga Rras-Kalivaç | Komuna Ungrej | 4,000 |
| | Rikonstruksione dhe sistemim rrugësh | Komuna Balldre | 1,140 |

## Aneks 3 Detyrimet e NJQV-ve lidhur me menaxhimin e mbetjeve

- Ligji nr. 8652/2000 " Mbi organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor", ne nenin 10/f te tij përcakton: Funksionet e komunes dhe bashkise jane: grumbullimi, largimi dhe përpunimi i mbeturinave;
- Neni 15 percakton: Njësitë e qeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga fondet e transferuara nga pushteti qendror dhe fondet që u vijnë drejtpërdrejt atyre nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare ;
- Neni 16 "Komuna dhe bashkia vendosin vetë për nivelin, mënyrën e mbledhjes dhe të administrimit të tarifave vendore, në përputhje me politikat dhe parimet e përgjithshme kombëtare...." ;
- Neni 72 "Duke filluar nga 1 janari 2001, komunat dhe bashkitë janë tërësisht përgjegjëse për kryerjen e funksioneve të veta të mëposhtme: e) grumbullimin, largimin dhe përpunimin e mbeturinave" ;
- Neni 73 "Duke filluar nga 1 janari 2001, komunat, bashkitë dhe qarqet kanë autonomi të plotë për vendosjen e tarifave vendore për kategoritë e mëposhtme: a) tarifa për shërbimet publike (ketu përfshihet edhe menaxhimi i mbetjeve);
- Keshillat e qarqeve ne bashkepunim me njesite vendore percaktojne siperfaqet se ku do te ndertohet landfilli, grumbullimin e mjeteve jashte perdorimit dhe mbetjeve inerte.
- Sipas nenit 12 te ligjit nr.10463/2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve", cdo qark harton planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që ka nën juridiksion, në përputhje me Planin Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe cdo njësi e qeverisjes vendore apo grup njësish të qeverisjes vendore harton planin vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që ka nën juridiksion, në përputhje me planin kombëtar dhe planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve;
- Sipas pikes 4, te VKM 608/17.09.2014, eshte percaktuar qe "Afati për grumbullimin në mënyrë të diferencuar të mbetjeve bio, nga njësitë e qeverisjes vendore, është:

  a) për bashkitë qendër qarku, brenda vitit 2017;

  b) për bashkitë e tjera, brenda vitit 2018"

- Sipas kreut IV, te VKM 418/25.06.2014 "1. Bashkitë e kategorisë së parë, në përputhje me përcaktimin e nenit 3 të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009, "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar, përcaktojnë, brenda datës 31 dhjetor 2016, masat e përshtatshme për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve të paktën për rrymat e mbetjeve të mëposhtme:

  a) Letër/karton;

  b) Metal;

  c) Plastikë;

  ç) Qelq.

- Njësitë e tjera te qeverisjes vendore, brenda 31 dhjetorit 2018, marrin masat e përshtatshme për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, të paktën për rrymat e mbetjeve të përcaktuara

## Annex 4. Struktura organizative e bashkise Lezhe